

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7858 E diel 21 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga JORGJI KOTE

Dhe kur Merkel humbet nënën...



Më 18 prill iu dha lamtumira e fundit Herlind Kasner, nënës së kancelares Merkel, me një ceremoni të thjeshtë kishtare në Templin, qytet i vogël ku e ndjera banonte ...
Vijon në faqen 21

Opinion

Ditës

Nga SULEJMAN MATO

Tërheqja në politikë, si strategji lufte



Si qytetar i ndërgjegjshëm i këtij Svendi, e ndjej për detyrë të prononcohem rreth situatës politike që kalon vendi im. Do ketë ca miq të mi, që sigurisht ...
Vijon në faqen 22



Debati për persekutorët e diktaturës

Visar Zhiti: Akuza për bashkëpunëtor, po nëpërkëmbet vuajtja njerëzore

"Sulmet që na bëhen sot nga ata që kanë mbajtur uniformat e diktaturës së dikurshme janë të rrezikshme, pra të dënueshme"

Nga FATMIRA NIKOLLI

Xhelatët dhe viktimat e komunizmit janë vënë sërish përballë në demokraci, në një "luftë" ku po trajtohen si të barabartë e ku ndonëse kanë kaluar 30 vite nga rënia e regjimit, askush prej atyre që mbajtën poste drejtuese nuk u penalizua ...
Në faqen 12

PRONARET QE MARRIN PARATE ME URDHER TE PERMBARIMIT

KOMPENSIMI/ EKZEKUTOHEN VENDIMET E GJYKATAVE PER VITET 2014-2019

Fitojnë gjyqin me Agjencinë e Trajtimit të Pronave, kush janë pronarët në Tiranë e në rrethe që marrin lekët nga qeveria. 95 dosjet me përfituesit direktë dhe trashëgimtarët e tyre



(Në foto) Toka (foto ilustruese)

MBLIDHEN FIRMAT

Rudina Hajdari e Patozi krijojnë partinë e re "Bindja Demokratike"

Në faqen 3

"30 QERSHORI"

Balla, Bashës: 7 vite burg për ata që pengojnë mbajtjen e zgjedhjeve

Në faqen 2

SKANDALI

Grabitja e 5.7 mln eurove në Rinas, hetuesit: Morën pjesë 12 persona

Në faqen 8

BIZNESMENET

Sauditët që do të investojnë te ne: 'Prestige Resort', një vend fantastik

Në faqen 6

LISTA E KADASTRES



Emrat, tapitë për 200 familje, kush merr truallin në Tiranë e rrethe

Në faqen 10-11

MILANO Rrëfimi i priftit polak Marcin Czerminski për Ballkanin e vitit 1892

Shqiptarët "e panjohur" të Kroacisë në shekullin XIX

Familja e Sami Frashërit nuk donte që eshtrat e tij të vinin në Shqipëri

NGA MARCIN CZERMIŃSKI

Disa kilometra mbas Zarrës fillonte fshati, që në të vërtetë ishte një varg shtëpish të ndërtuara në të dyja anët e rrugës, në një distancë nga njëra-tjetra çerek milje tonën, ashtu siç më siguruan. Borgo Erizzo.



siç quhet që nga themelimi i saj, fillimisht të lë përshlypje të mira: shtëpi të rregullta, me kopshte me lule dhe me perime; njerëz me pamje të bukur dhe të shëndetshëm dhe, nga sa mund të kuptosh nga veshja, jetojnë të kamur. Sigurisht që vizitën ...
Suplement

Suplement

ZGJEDHJET DEBATI

Kreu i grupit: PS-ja do të çlirojë bashkitë që janë qeverisur nga PD-ja dhe LSI-ja

Balla, Bashës: 7 vite burg për ata që pengojnë zgjedhjet

"Në pranga, kush prek kutitë e votimit"

Mazhoranca e majtë paralajmëroi dje opozitën me burg, nëse do të tentojnë të pengojnë zhvillimin e zgjedhjeve në 30 qershor. Nga Elbasani, sekretari i përgjithshëm i PS-së, Taulant Balla, paralajmëroi opozitën dhe mbështetësit e saj me burg, nëse do të tentojnë të pengojnë zgjedhësit të shkojnë në votim apo të dëmtojnë qendrat e votimit. "Ta harrojë Monika, Luli e Saliu që të mund ta pengojnë popullin. Nuk e bëjnë dot, është vepër penale. Dënohet me deri në 7 vite burg kushdo që pengon zgjedhësit të shkojnë në votim, kushdo që tenton të dhunojë, goftë derën e qendrës së votimit", u shpreh z. Balla. Ai shprehu sigurinë e plotë se PS-ja në zgjedhjet vendore do të fitojë edhe ato bashki, të cilat deri më sot janë qeverisur nga PD dhe LSI, duke e cilësuar si opozitë pa alternativë. "Shqiptarët dinë ta bëjnë fare mirë dallimin mes bashkive ku qeverisin socialistët dhe qeverive ku deri më 30 qershor qeverisin përfaqësuesit e Lulit dhe Monikës", theksoi kreu i grupit parlamentar të PS-së. Edhe për mungesën e votës së emigrantëve, PS-ja bën faktore PD-në. "Ne nuk kemi arritur ende t'u garantojmë votën aty ku jetojnë emigrantëve për shkak refuzimit të Partisë Demokratike rrugore, siç quhet tashmë, për të miratuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor", u shpreh Taulant Balla. Gjithashtu, drejtuesit e PS-së u kanë dhënë porosi strukturave që të ketë një komunikim korrekt dhe të vazhdueshëm me mediat si dhe në portalin "Bashkitë që Duam".

PREZANTIMI
Kryetari i grupit parlamentar në Partinë Socialiste, Taulant Balla, konfirmoi Nuri Belbën si kandidat për bashkinë e Prrenjastit për zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Me një reagim në "Facebook", Balla e cilësoi Belban si kandidat më të mirë



Sekretari i përgjithshëm i PS-së, Taulant Balla, dhe në Prrenjast

"Kryeministri po tenton të kthejë gjithçka në hi"

Paloka paralajmëron Ramën: Ndize, pastaj e shohim a do të sundosh

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka, adresoi dje akuza të forta në drejtim të kryeministrit Edi Rama. Ai shkruan në "Facebook" se Rama nuk e ka problem që t'i vendosë zjarrin gjithçkaje dhe më pas të sundojë, por shton se një gjë e tillë nuk ka për të ndodhur. "Rama nuk e ka problem t'i vërë zjarrin e të kthejë gjithçka në hi, mjaft që të jetë i sigurt se



dhe më të ndershëm, që PS-ja mund t'u ofrojë banorëve të kësaj zone. Më në fund, më 30 qershor, pas 4 vitesh kemi mundësinë të ndryshojmë fytyrën e Bashkisë së Prrenjastit. Kemi shansin t'u ofrojmë qytetarëve të Prrenjastit shërbimin e duhur, korrektesinë dhe mbi të gjitha ndershmërinë. Në një takim të ngushtë me drejtuesit e Partisë Socialiste Prrenjast ishim të gjithë në një mendje se kandidati ynë më i mirë është deputeti Nuri Belba -faqja zyrtare, i cili për 4 vitet e ardhshme,

në krye të Bashkisë së Prrenjastit do të punojë shumë, jo vetëm për t'u shërbyer qytetarëve, por edhe për të ndrequr gabimet e 4 viteve të kaluara. Nuri Belba është një kandidat shumë i mirë për Bashkinë e Prrenjastit. Kemi një shans të artë për të vendosur një njeri, që gjithë jetën është karakterizuar nga ndershmëria", tha z. Balla. Por sipas tij, tashmë është koha gjithashtu të kërkojmë ndjesë përpara qytetarëve për atë gabim trashanik, që e la Bashkinë e Prrenjastit në duart e LSI. "Një drejtues

mbi hirin do sundojë ai! Ndize! Të shohim a do sundosh mbi hirin apo shqiptarët do pshurri mbi hirin tënd", shprehet z. Paloka. Opozita pas dëgjës së mandateve ka zbritur në rrugë me aksion kundër qeverisë me protesta, ndërsa ka vendosur kushte për pjesëmarrjen në zgjedhje, pasi në të kundërt, siç paralajmëroi Lulzim Basha, do të bllokoi procesin në 30 qershor.

bashkie që zhgënjeu besimin e banorëve, po të kemi parasysh numrin e madh të fondëve që ka marrë bashkia dhe cilësinë tmerrësisht të dobët të punëve. Më 30 qershor do të mbahen zgjedhjet vendore dhe ta harrojë Monika, Luli, Saliu që mund të pengojnë popullin e Prrenjastit të shkojë të votojë. Është vepër penale, dënohet me 7 vite burg kushdo që pengon zgjedhësit të votojnë, kushdo që dhuron goftë edhe derën e qendrës së votimit", deklaroi sekretari i përgjithshëm i PS-së.

PARALAJMËRIMI

"Më 30 qershor zgjedhjet do të zhvillohen. Ta harrojë Monika, Luli e Saliu se mund të pengojnë popullin të shkojë të votojë. Nuk e bëjnë dot. Është vepër penale, dënohet deri në 7 vite burg kushdo që pengon zgjedhësit të shkojnë në votim, kushdo që tenton të dhunojë goftë derën e qendrës së votimit e për të mos thënë pastaj, larg goftë, të guxojë të ngrejë dorën mbi kutinë e votimit për ta dëmtuar atë, sepse dënimi është shumë i rreptë", u shpreh Balla.



Opozita e re në Kuvend

SHKURT

"Rinasi", Berisha: Paratë e grabitjes së shekullit u gjetën

Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi dje deklaratën e ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj, për grabitjen në aeroportin e Rinasis. Berisha shprehet se sipas Lleshaj, paratë janë djegur. Për ish-kryeministrin, ky është një pranim i vjedhjes shtetërore elektorale të kryeministrit Rama. "Paratë e grabitjes se shekullit u gjetën! Pranohet vjedhja shtetërore elektorale nga Edvin Kristaq Hajni! Miq, mbrëmë nëpërmjet Vasal Kimikut, Edvini bëri deklaratën që nuk ia rrokte kujt mendja njeriu në botë. Ai tha se paratë janë djegur, me fjalë të tjera: i grabitëm për t'u ngrohur dhe nuk i morëm për të blerë vota..!", shprehet z. Berisha. Edhe nënkryetari i LSI-së, Petrit Vasili, "sulmoi" ashpër kreun e qeverisë, Edi Ramën dhe ministrin e Brendshëm, Sandër Lleshaj. Duke përdorur etiketim si "karikaturë", "gjeneral papagall", Vasili e cilësoi Lleshajin si një "kukul e vetofruar" të kryeministrit Rama. Ai tha se vendi është shkatërruar nga kriminaliteti, varfëria ekstreme dhe ka bërë përgjegjës kryesor Ramën.

Vizat me Holandën, Shehu: Si rrufe në një depo karburanti

Ish-deputeti i PD-së, Tritan Shehu, shprehet se, "ven dimi i Parlamentit holandez për vendosjen e vizave për qytetarët shqiptarë është një rrufe në një depo karburanti, ku kriminaliteti është i koncentruar". Shehu thekson se largimi i qeverisë "Rama" është zgjidhje për situatën e krijuar. Sipas tij, qeveria holandeze ndodhet në pozitë të vështirë, pasi parlamenti i saj ka folur me 2/3 e votave dhe se kjo shumicë e cilësuar e bën të vështirë frenimin e procesit që ka filluar. Përkundrejt zërave që anatemojnë PD-së se synon pengimin e hapjes së negociatave, Shehu shprehet se ky hap do ta bënte monitorimin e Shqipërisë nga BE më të fortë. Shehu e konsideron fantashkencë, kërkimin e hapjes së negociatave të Shqipërisë në BE, ndërkohë që flitet për rivendosje vizash për qytetarët shqiptarë. Komentet Shehu i bëri nga studio e emisionit "Politika Online" në "Gazeta Shqiptare" dhe "BalkanWeb".



Nis mbledhja e 3 mijë firmave, të martën regjistrimi në gjykatë dhe KQZ

Hajdari e Patozi krijojnë parti të re, Bindja Demokratike

PD: Duhet të jesh i moralshëm, më pas politikan

Valentina Madani

Brenda së djathtës krijohet një parti e re politike, e cila pritet të garojë në 30 qershor. Rudina Hajdari dhe Astrit Patozi janë themeluesit e partisë së fundit politike, që do të regjistrohet në fillim të javës së ardhshme dhe do të mbajë emrin Bindja Demokratike. Pak ditë pasi paralajmëroi se do të marrë pjesë në zgjedhjet e 30 qershorit, vajza e liderit të dhjetorit, Azem Hajdari, e cila u fut në politikë nga Lulzim Basha në zgjedhjet e 2017-ës ka vendosur që të jetë lidere e një partie të re politike, që synon të afrojë afër vetes ish-funksionarë të larguar nga Partia Demokratike. Pjesë e partisë më të re politike do të jetë ish-nënkryetari i PD-së, Astrit Patozi, i cili publikisht ka shprehur mbështetjen për Rudina Hajdarin. Patozi, i pyetur dje nga mediat as nuk e pohoi dhe as e nuk e mohoi lajmin për përfshirjen e tij në këtë forcë politike. Mësohet se nismëtarët e Partisë Bindja Demokratike kanë nisur mbledhjen e 3 mijë firmave që nevojiten për t'u regjistruar një forcë politike, ndërsa javën e ardhshme do t'i drejtohen gjykatës dhe KQZ-së për t'u regjistruar si subjekt garues.

MBLEDHJA

Deputetja Rudina Hajdari mbledhi dje grupin parlamentar të krijuar nga deputetët e rinj, nga ku u vendos për krijimin e partisë së re dhe regjistrimin në zgjedhjet lokale. Pikërisht në këtë mbledhje u vendos edhe krijimi i Partisë Bindja Demokratike. Partia do të regjistrohet të martën në KQZ dhe në gjykatë. Burimet bëjnë me dije se mes deputetëve ka pasur diskutime në grup, duke qenë se disa prej tyre nuk kanë qenë dakord për regjistrimin në zgjedhje, me argumentin se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u bërë gati për fushatë elektorale për zgjedhjet e 30 qershorit. Por siç duket, afatet kohore e venë në sfidë Rudi-



Deputetja Rudina Hajdari

ENKELEJD ALIBEAJ

"Në parim mund të them shumë mirë që pas viteve '90 u arrit mundësia që kushdo që mendon se mund të formojë parti, mund të garojë. Në planin politik, emrat që ju sapo thatë deri dje ishin njerëz të zgjedhur prej demokratëve. Para se të jesh politikan, duhet të jesh i moralshëm. U ke thënë njerëzve se do jesh përfaqësues i tyre, por morali i përfaqësimit politik mundon në këtë rast", tha Alibeaj.

mundësia që kushdo që mendon se mund të formojë parti, mund të garojë. Në planin politik, emrat që ju sapo thatë, deri dje ishin njerëz të zgjedhur prej demokratëve. Para se të jesh politikan, duhet të jesh i moralshëm. U ke thënë njerëzve se do jesh përfaqësues i tyre, por morali i përfaqësimit politik mundon në këtë rast", tha Alibeaj. I pyetur nëse PD-ja nxjerr mësim nga krijimi i një partie të re, Alibeaj u shpreh se Partia Demokratike e mirëpret pluralizmin. "Gjithmonë ka pasur situata të tilla, ka pasur mësim të nxjerra. A nuk është mirë që partitë të mos funksionojë si garnizone të mbyllura? Më mirë kështu dhe këtu nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Edhe nga e majta do ishte mirë të kishte parti të tilla, por ky është një defekt i madh i tyre, ku një rene-gati që del kundër 'i pritëri koka'", deklaroi z.Alibeaj.

MBËSHËTETJA

Pjesë e partisë së re janë bërë disa prej figurave që kanë qenë pjesë e rëndësishme e PD-së. Vetëm pak ditë më parë, Astrit Patozi doli hapur në mbështetje të Rudina Hajdarit dhe mes tyre pati edhe një takim në një prej lokaleve të Tiranës. Madje, mësohet se Patozi e Hajdari kanë zhvilluar këto ditë takime intensive për t'i dhënë formë këtij projekti.

"PD nëse nuk hyn në zgjedhje, do të shkrihet"

Murrizi: Me Hajdarin duam ndryshim të sistemit zgjedhor

Deputeti Myslim Murrizi, i ftuar dje në emisionin "Kjo javë" në "News 24" tha se tashtë është pjesë e grupit parlamentar demokrat. Murrizi u shpreh se zonja Hajdari është kryetare e grupit parlamentar demokrat dhe se ky grup kërkon ndryshim të sistemit zgjedhor: "Jam pjesë e grupit parlamentar demokrat. Ky grup parlamentar udhëhiqet nga zonja Rudina Hajdari. Kemi kërkuar që ditën e parë në atë parlament ndryshim të sistemit zgjedhor. Duam ndryshim të këtij sistemi zgjedhor sa më shpejt të jetë e mundur. Do të ndryshojë se s'bën. Sistemi aktual bën që deputetët të jenë të varur nga kryetari i partisë. Ata kthehen në kërmij të kryetarit, në lëpirës të kryetarit. Kjo gjë duhet të marrë fund. Nuk duhet më që përfaqësuesit e popullit të jenë ca lëpirës të kryetarëve, por të jenë realisht me popullin", tha Murrizi. I pyetur se çfarë mendon për PD-së dhe sulmet e opozitës, Murrizi u shpreh se ai e ka në dorë vetë nëse bëhet pjesë e Partisë Demokratike apo jo, por shtoi se është demokrat. Murrizi shprehu bindjen e plotë se nëse Partia Demokratike nuk hyn në zgjedhje, atëherë do të shkojë drejt shkrires, por ai beson se PD-ja do të hyjë në zgjedhjet e 30 qershorit.

SHKURT

Ish-zv.kryeministria padit Ramën, kërkon Avokaturën e Shtetit

Ish-zv.kryeministria teknike e PD-së gjatë marrëveshjes Rama-Basha padit në gjykatë qeverinë shqiptare. Ledina Mandia, e cila për disa muaj mbajti numrin dy të qeverisë shqiptare pas kryeministrit Edi Rama, e ka çuar këtë të fundit në gjykatë, duke kërkuar që të rikthehet sërish avokate e përgjithshme e shtetit. Mandia rezultoi se është liruara nga detyra me urdhrin 156, datë 7 tetor 2013 duke u zëvendësuar nga një tjetër emër, por pas thuasje 6 vite i është drejtuar gjykatës për të përfituar pagat dhe zhbërjen e këtij urdhri. Kjo çështje është regjistruar më 29 mars në Gjykatën Administrative me paditëse Ledina Mandian dhe të paditur kryeministrin Rama dhe Avokaturën e Shtetit.

TENTATIVA

Astrit Patozi pati një tentativë për krijimin e një partie të re, duke zhvilluar madje takime me demokratë dhe të pakënaqur në disa qytete. Kjo është partia e parë që krijohet nga përçarja e demokratëve nga drejtimi i Lulzim Bashës.

na Hajdarin për t'u regjistruar për zgjedhjet lokale, pasi të martën skadon afati kohor për regjistrimin e subjekteve. Partia e re ka tashtë mbështetjen e deputetëve të rinj të dalë nga lista e Partisë Demokratike, që refuzuan thirrjen e lidërshtipit demokrat për të mos i marrë mandatet. Me regjistrimin në KQZ, ajo do të përzgjedhë edhe kandidatët që do të garojnë për kryetarë në të 61 bashkitë e vendit.

PARALAJMËRIMI

Dy ditë më parë Rudina Hajdari paralajmëroi se do të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit, e madje u hap edhe një debat se në siglën e kujt partie. Ndërkohë, mësohet se pjesë e partisë së re janë bërë disa prej figurave që kanë qenë pjesë e rëndësishme e Partisë Demokratike. Vetëm pak ditë më parë, Astrit Patozi doli hapur në mbështetje të Rudina Hajdarit dhe mes tyre pati edhe një takim në një prej lokaleve të Tiranës. Madje, mësohet se Patozi e Hajdari kanë zhvilluar këto ditë takime intensive

për t'i dhënë formë këtij projekti. Patozi e përshëndeti menjëherë iniciativën e Hajdarit për të qenë alternativë në zgjedhjet lokale dhe po ashtu, edhe betejën për të ndryshuar sistemin zgjedhor. Sipas burimeve, janë ftuar edhe të tjerë të larguar dhe të pakënaqur nga PD-ja. Kujtojmë se që në fillim të vitit të kaluar, Patozi pati një tentativë për krijimin e një partie të re, duke zhvilluar madje takime me demokratë dhe të pakënaqur në disa qytete. Kjo është partia e parë që krijohet nga përçarja e demokratëve nga drejtimi i Lulzim Bashës.

REAGIMI

Ish-deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj, i ftuar dje në emisionin "Kjo javë" në "News 24" foli për krijimin e partisë së re Bindja Demokratike, teksa u shpreh se krijimi i të tilla partive politike janë brenda logjikës demokratike. Ai shtoi se në këtë rast mungon morali politik. "Asnjë lloj koment. Në parim mund të them shumë mirë që pas viteve '90 u arrit

REGJISTRIMI AFATET

Valentina Madani

Opozita ka paralajmëruar bojkotin e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit, nëse nuk largohet Edi Rama nga qeveria, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve fillon numërimin mbrapsht për përfundimin e afateve ligjore. Dita e sotme është afati i fundit ligjor për PD-në dhe LSI-në që të marrin pjesë në zgjedhjet lokale. Por, për shkak se 21 prilli është ditë e diel dhe e hëna korrespondon me pushim zyrtar, regjistrimi i subjekteve zgjedhore mund të shtyhet deri në datën 23 prill. Deri më tani janë regjistruar 25 parti politike, mes tyre edhe Partia Socialiste, të cilat kanë shprehur vullnetin për pjesëmarrjen në zgjedhje, parvërsisht bojkotit të opozitës. Ndërsa, javën që vjen pritet të regjistrohen edhe 9 të subjekte të tjera. PD dhe LSI kanë bojkotuar edhe më herët procesin zgjedhor me mosdërgimin e komisionerëve për KZAZ-të. Përveç bojkotit të zgjedhjeve, procesi zgjedhor ka hasur edhe në një tjetër problematikë, në pezullimin e tenderit për fletët e votimit, shkak është bërë ankesa e një kompanie që ka marrë pjesë në garë. Në faqen online të Komisionit për Prokurimet Publike, ende nuk ka një vendim për këtë ankimin dhe si rezultat, procedura e tenderit për fletët e votimit vijon të mbetet e pezulluar.

REGJISTRIMI

Deri tani në KQZ janë regjistruar 25 parti, ndërsa kanë aplikuar për tu regjistruar 8 parti të tjera, duke e çuar në 33, numrin e partive që duan të marrin pjesë në zgjedhjet lokale. 8 partitë e reja do të regjistrohen të martën nga KQZ-ja, ndërsa 1 parti, Aleanca Demokratike e Eduard Abazit, për shkak se nuk ka kthyer fondet e marra paraprakisht nga KQZ, është në kushtet për të mos regjistruar nga KQZ. Nga partitë e regjistruara bien në sy 5 prej tyre, që dikur kanë qenë aleatë të Bashës, Bashkimi Demokrat Shqiptar me kryetar Ylber Valteri, Partia Ora e Shqipërisë e drejtuar nga Zef Shtjefni, Bashkimi Liberal Demokrat e drejtuar nga Arian Starova, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë e Arian Galdinit, si dhe Partia Kombëtare Konservatore, e drejtuar nga Kujtim Gjuzi. Nëntë parti të reja, që do të garojnë në zgjedhjet e 30 qershorit pritet të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ditën e martë. Kështu, partitë

Limitet për PD-LSI, sot afati për regjistrimin e partive në zgjedhjet e 30 qershorit

Vendoret, në KQZ regjistrohen 25 parti, 5 aleatë "tradhtojnë" Bashën

9 partitë politike që pritet të regjistrohen



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

SHKURT

Zgjedhjet, KQZ-ja pezullon procedurën e tenderit për fletët e votimit

Kur na ndajmë vetëm pak javë nga zgjedhjet vendore të 30 qershorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pezulluar procedurën e tenderit për prodhimin e fletëve të votimit. Burime të besuara për "News 24" konfirmuan lajmin dhe sqaruan se procedura në fjalë u pezullua, pas ankimit që bëri pranë Komisionit të Prokurimit Publik një nga kompanitë pjesëmarrëse në garë. Kjo konfirmohet edhe në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, ku është publikuar ankimi, i cili lidhet me prodhimin e fletëve të votimit dhe maska (shabllone) për votuesit e verbër, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2019, por në publikim nuk jepen detaje mbi arsyet e ankimit. Ankesa ka pezulluar për momentin procedurën e tenderimit dhe për pasojë procesin e prodhimit të fletëve të votimit të 30 qershorit. Të kontaktuar nga "News 24", burimet pranë KQZ-së thanë se duke marrë në konsideratë afatet e limituar, të cilat mund të vinin në rrezik procesin e zgjedhjeve, janë duke shqyrtuar çdo mundësi ligjore që procedura për tenderimin e fletëve të votimit të vijojë. Ata sqaruan se pezullimi i procesit nuk ka lidhje me situatën e tensionuar politike në vend. Burimet bëjnë me dije se po bëhen përpjekje që situata të zhbllkohet përmes një procedure me negociim, për shkak se gjithçka duhet të jetë gati për zgjedhjet e 30 qershorit dhe KQZ-ja në detyrimin e saj ligjor dhe institucional të vijojë me procesin e organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve lokale.

e reja që do të regjistrohen të martën nga KQZ janë Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Demokracia Sociale,

Partia Zgjidhja, Pajtimin Kombëtar, Social-Punëtore, Partia Ligj dhe Drejtësi, Fryma e Re Demokratike, Aleanca Kuq

e Zi, Partia Lista e Barabartë. Deri tani në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë regjistruar 25 parti politike.

Mesazhi i Pashkëve për politikën: Nuk duam "vetëvrasjen" e kombit

Imzot George Frenzo, Arqipeshkvi Metropolit i Tiranës dhe Durrësit, në ditën e Pashkëve Katolike u kërkoi politikanëve shqiptarë që të angazhohen për një zgjidhje të drejtë, pasi sic tha ai, ne nuk duam "vetëvrasjen" e kombit. "U bëj apel të gjithë politikanëve, kanë detyrë morale të angazhohen për një zgjedhje të drejtë dhe të shqetësohen me shumë për të mirën e përbashkët se sa për pozitën që kanë. Situa-ta tashmë është shumë e rëndë dhe sa më shumë të zgjasë, më të mëdha do të jenë pasojat për popullin. Ne nuk duam 'vetëvrasjen' e kombit. Krishti i ngjallur në takimet e tij me njerëz pati gjithmonë të njëjtin urim 'Paqja me ju!', atyre që mbajnë inat në zemrat e tyre, që merren me ndjenja hakmarrjeje, Krishti i kurorëzuar në ditën e Pashkëve unë ju kam falur. Atyre që protestojnë me dhunë, me vandalizëm Jezusi i kujton fjalët e tij drejtuar Pjetrit kur i tha 'Të gjithë ata që rrokin shpatën, nga shpata do të vdesin'. Dhe atyre që kanë autoritet politik iu kujton se në darkën e tij të fundit, pasi u lau këmbët apostujve iu tha 'Ju dhashë shembull që sikurse iu bëra unë juve, të bëni edhe ju'. Përfaqësuesit e popullit duhet të jenë shembull për popullin!", tha Imzot George Frenzo.

PARTITË E REGJISTRUARA NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

ALEATË TË PARTISË SOCIALISTE

1. Partia Socialiste e Shqipërisë, Edi Rama
2. Partia Socialdemokrate Shqiptare, Skënder Gjinushi
3. Partia e Gjelbër, Edlir Petanaj
4. Partia Kristian Demokratike, Dhimitër Muslija
5. Partia Aleanca Demokratiane, Zef Bushati
6. Partia Socialiste e Moderuar, Gjergji Koja
7. Partia Unitetit Kombëtar, Idajet Beqiri
8. Partia Emigracionit Shqiptar, Kostaq Papa
9. Personat me Aftësi të Kufizuara, Gjovalin Shqalshi
10. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Genci Sakaj
11. Partia e të Drejtave të Mohuara, Ilir Vata
12. Demokracia e Re Europiane, Koçi Tahiri
13. Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Valentino Mustafa
14. Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet, Kujtim Muça
15. Partia Ardhmëria Shqiptare, Emin Subashi
16. Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, Kristo Kiço
17. Partia për Demokraci dhe Solidaritet, Gaqo Apostoli
18. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të emigrantëve, Ymer Kurti
19. Partia Komuniste e Shqipërisë, Qemal Cicollari

ALEATË TË PARTISË DEMOKRATIKE

20. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, Ylber Valteri
21. Partia Ora e Shqipërisë, Zef Shtjefni
22. Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Arian Starova
23. Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë, Arian Galdini
24. Partia Kombëtare Konservatore, Kujtim Gjuzi

JASHTË KOALICIONEVE

25. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Kadri Isufaj

KANË BËRË KËRKESË NË KQZ, REGJISTROHEN TË MARTËN

- JASHTË KOALICIONEVE
1. Fryma e Re Demokratike, Bamir Topi
 2. Lista e Barabartë, Ben Blushi
 3. Partia "Zgjidhja", Koço Kokëdhima

ALEATË TË PARTISË SOCIALISTE

4. Partia Demokracia Sociale, Paskal Milo
5. Partia Ligj dhe Drejtësi, Spartak Ngjela
6. Partia Social-Punëtore Shqiptare, Ramadan Ndreka
7. Partia e Reformave Demokratike, Krenar Rryçi
8. Pajtimi Kombëtar Shqiptar, Spartak Dobi

NUK KA KTHYER FONDET

1. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Eduart Abazi

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me Përmbarrues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga "Ibrahimi Rugova", Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 17.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i III - të për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me numër pasurie Nr.5/264/ND-1+2, Zona Kadastrale 6250, Vëllimi 20, Faqe 116, me sipërfaqe 137 m², ndodhur në adresën, Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë, pronësi: Z.Bujar Musa Kajazi, me vlerë fillestare në ankand 62'294.4 (Gjashdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë pëkatë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr.e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com;

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me Përmbarrues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga "Ibrahimi Rugova", Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 03.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i I - të për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme. Truall me sipërfaqe totale 3104 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës, me Nr.pasurie 16/131, Vëllimi 11, Faqe 10, Zona Kadastrale 8516, në pronësi të Shoqërisë "ADRIATIKA BETON" sh.p.k, me vlerë fillestare në ankand 322,816 (Treqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e gjatëmbëdhjetë) Euro. Të interesuarit të kontaktojnë në nr.e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888. email enuar.merko

Kompensimi, dosjet që marrin paratë me urdhër të Përmbarrimit

Pronarët, ekzekutohen vendimet 2014-2019

Fitojnë gjyqin me ATP, shlyhen detyrimet për 95 pronarë

Agjencia e Trajtimin të Pronave publikon listën me 95 vendime gjyqësore të formës së prerë, ku pronarët kanë fituar të drejtën mbi pronën e tyre. ATP-ja ka firmosur ekzekutimin e vendimeve, që datojnë nga viti 2014 deri në maj të vitit 2019. Përfituesit janë nga i gjithë vendi, ndërkohë që shuma që do të përfitojnë është përcaktuar me vendim gjykatë rast pas rasti. Bëhet fjalë për 95 dosje, përmes të cilave pretendentët e pronave, të pakënaqur me trajtimin e ligjit në fuqi të para 3 viteve, por edhe me ligjin aktual, tashmë me vendime të formës së prerë do të paguhen automatikisht nga Përmbarrimi. Ajo që vlen të theksohet është fakti se këto dosje janë shqyrtuar në të gjitha shkallët e gjyqësorisit brenda vendit dhe një pjesë e tyre kanë marrë edhe vendimin nga "Strasburgu".

ANKIMIMI

Ligji për trajtimin e pronës në nenin 29 të tij, pa parashikuar procedurën e ankimit: "Kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të

Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", thuhet në ligj. Ndërkohë që të gjitha vendimet përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe ato që do të merren deri në përfundim të procesit, do të zbatohen sipas parashikimeve të këtij ligji. Vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare për kompensim do të bëhet duke vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim.

LIGJI

Sipas ligjit në fuqi, format e kompensimit në vlerë për subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim: a) financiar; b) me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit; c) me aksione në shoqëri me kap-



ital shtetëror ose ku shteti është bashkëpronar, që kanë vlerë të barabartë me pronën e paluajtshme; c) me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i privatizimit. Ndërkohë që procesit të vlerësimit të pronës që

do të kompensohet i nënshtrohet: a) toka; b) objektet ndërtimore. Treguesit bazë të vlerës së pronës caktohen të veçantë për tokën dhe objektet ndërtimore. Kur një pronë është bashkim i tokës me objektin

FONDI I KOMPENSIMIT TË PRONAVE

- Fondi i Kompensimit të pronave është një fond i vënë në dispozicion të kompensimit të vendimeve përfundimtare për kompensim, sipas përcaktimeve të këtij ligji, i cili përbëhet nga:
 - a) Fondi financiar i kompensimit.
 - b) Fondi i tokës.
- Fondi i kompensimit është i paprekshëm. Asnjë organ administrativ apo gjyqësor nuk mund të disponojë mbi këtë fond, përveç subjekteve të parashikuara në këtë ligj për administrimin e tij.

ndërtimor, vlera e saj nxirret për njësi, si shumë e vlerave të objektit ndërtimor dhe të tokës mbi të cilën ai ngrihet. Vlera e pronës që kompensohet nxirret sipas përcaktimeve të këtij ligji,

duke u bazuar: a) për tokën, në hartën e vlerës; b) për objektet, në vendimin e Këshillit të Ministrave për metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë.

Kreditori	Numri i Protokollit dhe data e depozitimit të kërkesës në ATP	Numri i protokollit	Data
1	Emër	Mbiemër	Zyra Përmbarrimore/Kreditori
2	ERVEHE	CELMETA	Zyra Përmbarrimore Tiranë (Bleta Çikalleshi)
3	NEXHMJE	SALIU	BEST 2010
4	DIDIKA	QATPI	Z.P.Finanë
5	HASAN	SEFERAJ	TDR GROUP
6	REITA	TAJA	Baliff Services-Matani & co
7	SUZANA	TOLJA	SUZANA TOLA
8	EFROSINA	PERISTERI	BESART SHEHU
9	DIANA	KACULINI	DIANA BALIFF'S SERVICE për kreditorin DIANA KACULINI
10	KUJTIM	CAKRANI	VILHJASAJ
11	VASO	KONDI	TABAKU 2010 sh.p.k
12	REXHEP	MUSTAJAJ	Enxete Zisi për kreditorin Rexhep Mustajaj
13	NEXHMI	ÇUJFA	Përmbarues BASHA & T sh.p.k për kreditorin NEXHMI ÇUJFA
14	LIRI	CAPO	DEBIT COLLECTION për kreditorin LIRI CAPO
15	KRISTAQ	KAFEXHI	DEBIT COLLECTION për kreditorin KRISTAQ KAFEXHI
16	GAZMEND	KUQI	GAZMEND KUQI
17	ERVIN	SEFA	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE (vater kaçupi) për
18	NAZMIJE	BUSHATI	Shërbimet Përfundimtare Gëorxh Bushati & Çirke për
19	DIANA	METOHU	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE për kreditorin DIANA METOHU
20	TRASHEGIMTAR	TRASHEGI	VASIL SHANDRO për kreditorin FAIK DISHNICA
21	GEZIM	VINCANI	ERMIR GODAJ për kreditorin Gezim Vecani
22	FILIP	GURAZIU	Përmbarues BASHA & T sh.p.k për kreditorin FILIP GURAZIU
23	YLLI	ROSHI	Përmbarues JUSTITIA për kreditorin YLLI ROSHI
24	BERTI	SULOJLARI	Shërbimet Përfundimtare AKRINVEST Y.P.P për kreditorin BERTI SULOJLARI
25	LIRIA	DIBRA	Përmbarues T.M.A sh.p.k për kreditorin LIRIA DIBRA
26	ROBERT	MUSTAFAJ	Përmbarues EL VIN HOXHA për kreditorin ROBERT MUSTAJAJ
27	RASHGIMTARET	LUKA	Shërbimet Përfundimtare ASITRIFA për kreditorin RASHGIMTARET LUKA
28	KONDOR	CEKA	ELITE BALIFF'S OFFICE për kreditorin KONDOR CEKA
29	SKENDER	DJEPAXHIA	ELITE BALIFF'S OFFICE për kreditorin SKENDER DJEPAXHIA
30	SPIRO	PEKO	Përmbarues B.S.A për Kreditorin SPIROPEKO
31	VAIT	KABASHI	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE për kreditorin VAIT KABASHI
32	ILIA	LLAKMANI	ILIA LLAKMANI PF
33	QAZIM	DURRESI	BASHA & T sh.p.k për kreditorin QAZIM DURRESI ELITE
34	PETRI	HOXHA	BASHA & T sh.p.k për kreditorin PETRI HOXHA
35	QERIM	FAKURU	Shërbimet Përfundimtare ALBASSE sh.p.k për kreditorin QERIM FAKURU
36	HANE & LENE	BOCOVA	Shërbimet Përfundimtare ALBASSE sh.p.k për kreditorin HANE & LENE BOCOVA
37	RASHGIMTARET	ALIDA	FRUTTI (MEMI) AVOKATE
38	MAKSIM	GIOKUTAJ	Përmbarues TRIS sh.p.k për Kreditorin THOMA FORA
39	PETRI	XHAFER	DEBIT COLLECTION për kreditorin LIRI CAPO
40	ETIET	TAUSHANI	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE për kreditorin ETIET TAUSHANI
41	QENDRO	VOGLI	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE për kreditorin QENDRO VOGLI
42	LEONARD	TEFA	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE për kreditorin LEONARD TEFA
43	KEJDA	SEFERI	BALIFF SERVICES Matani për kreditorin SOKOLIN KEJDA
44	SOKOL	NOSI	BALIFF SERVICES Matani për kreditorin SOKOLIN KEJDA
45	IBRAHIM	SHEFA	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE për kreditorin IBRAHIM SHEFA
46	ISMAIL	DIBRA	Kërkese personale ISMAIL DIBRA, Shërbimet Përfundimtare

47	DIANA	KOLANECI	STRATI BALIFF'S SERVICE (vater kaçupi) për	3323	23/9/2016
48	SHEGUSHI	KARAOSMI	BALIFF SERVICES ALBANIA për kreditorin	3500	7/10/2016
49	FERIT	LLAGAMI	SHËRËT PËR TËRËSI TË SHËRËTIT'S SERVICE për	3899	11/11/2016
50	SUZANA	ISUFAJ	Erjon Bejko	4035	11.11.2016
51	ELSA	SHHJAJ	Dorjan Egenci	4515	20.12.2016
52	MANDITA	SHENGJERG	Elvira Zeqiraj Zyra përmbarrimore Tiranë	190	10.01.2017
53	RRAPUSH	HOXHOLLI	Ibir Devishaj/Power and Justice	199	10.01.2017
54	EDMOND	HAJDARAJ		116	18.01.2017
55	GAZMEND	KUQI	Eris Soriti Kodra Baliff	409	18.01.2017
56	TAHIR	NUMANI	Fanije Istrefi Bascha	723	24.01.2017
57	JORGJAQ	STEFA	Endri Jorgji Përmbarues zyra përmbarrimit tirane	822	26.01.2017
58	KLARITA	LICI	Lorena Gjoci	899	27.01.2017
59	ZENEPE	LARTI	Ejlona Mydini	1291	08.02.2017
60	BUJAR	VRETO	Gazmor Guri	1295	08.02.2017
61	MEFERET	KOKALARI	Pjeter Caka	3607	11.04.2017
62	MITRO	ZHUPA	Erjon Bejko	4351	02.05.2017
63	KUJTIM	SHPATARA		2823	01.06.2017
64	VANGJEL	COKA	Albert Fejzo	6283	27.06.2017
65	KATERINA	BUBUZI	Asaf Stroka	6844	13.07.2017
66	SINAN	DRIZA	Pjeter Caka	7462	28.07.2017
67	SAT	MARA	Baftajar Nela	7627	04.08.2017
68	SADETE	DOKU		8960	04.10.2017
69	XHEVAT	LLUPA		9219	10.10.2017
70	LLAMBRI	JANI		9649	23.10.2017
71	ADRIAN	DOCI		9733	25.10.2017
72	ANILA	TOPULLI		10184	06.11.2017
73	QAMILE	KUQI		10263	09.11.2017
74	ISMAL	MECA		6010	16.11.2017
75	JAMES	MYERS	Përmbarues Lorval Petani	440	18.01.2018
76	SALI	XHAFERAJ	Përmbarues Arjan Palli	547	22.01.2018
77	RUDI	PETI	Juljan Petiti	2937	30.03.2018
78	DASHAMIR	TUZI			
79	SPIRO	LAMANI	Shërbimet Elite Baliff's Ofice Devian Brahmanllari	4325	09.05.2018
80	FATBARDDHA	NALLBANI	Përmbarues Evelina Bekteshi	5340	04.06.2018
81	SHYQYRI	TOSKA	Zyra Përmbarimore Titane Majlinda Vasili	5499	07.06.2018
82	ZAMIRA	ELLA (NOVA)	Përmbarues Përmbarimit Titane Majlinda Vasili	6801	12.07.2018
83	FALIJER	QAZIMLLAR	Shërbimet 616 A Paqesor Hysa	7856	20.08.2018
84	SALI	SHIJAKU	TDR GROUP Alida Kodra	8411	19.09.2018
85	LEJLA	GUGALLI	Evelina Bekteshi	8543	24.09.2018
86	AQIF	PLAKU	Evelina Bekteshi	8681	27.09.2018
87	RAJMONDA	RAMA	Najada Beqaraj	9525	12.10.2018
88	VALTER	LAPA	Erjon Bejko	10039	25.10.2018
89	ESHREF	DELLALLISI	Erzen Qeva	10901	15.11.2018
90	GJOVALIN	SYKU	Adonid Kertaj	11146	22.11.2018
91	BAJRAM	VOGLI	Bajram Vogli	8755	14.12.2018
92	FADIL	KASMI	Brikena Kasmi	22	04.01.2018
93	BILAL	ZORBA	Dorina Saja	563	21.01.2019
94	SULEJMAN	OMERBASHI	Zyra e përmbarrimit tirane Majlinda Vasili	1156	05.02.2019
95	LEKA	BUNGO	Lyrina Kollaku	1352	08.02.2019

Biznesmenët sauditë: Shumë mundësi për investime, presim ofertat

Sauditët do të investojnë në Shqipëri, ja sektorët

"'Prestige Resort' është një vend fantastik"

Një delegacion biznesmenësh të njohur të Arabisë Saudite, anëtarë të Dhomës së Tregtisë, po vizitojnë Shqipërinë, vendet turistike dhe atraktive duke parë mundësinë për investime në vendin tonë. Biznesmenët sauditë, të cilët vijjnë për herë të parë në Shqipëri me ftesë të kryeministrit, operojnë në sektorët e shëndetësisë, 'real estate', turizmit dhe hotelierisë, ndërtimit, industrisë, minierave, telekomunikacionit dhe elektronikës, produkteve agro-ushqimore etj. Delegacioni i biznesmenëve, i shoqëruar nga ambasadori ynë në Arabinë Saudite, Sami Shiba, kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako dhe ministri i Turizmit, Blendi Klosi ndalojnë këtu fundjavë në Durrës dhe një pushim të këndshëm e bëri në mjediset e "Prestige Resort".

DELEGACIONI

Kreu i delegacionit, Muneer M. Bin Saad, tregon për "News 24" se gjatë ditëve të qëndrimit në Shqipëri kanë parë shumë vende tërheqëse në Tiranë, në veri dhe jug. "Tashmë ndodhemi në Durrës. Është një bregdet shumë i këndshëm, mot i mirë. 'Prestige Resort' është një vend fantastik. Jam i bindur që do të jetë shumë i ngarkuar me turistë. Ndërkohë, në vend ekonomia po përmirësohet, në Tiranë dhe në qytete të tjera. Po shohim mundësinë për të investuar në Shqipëri. Jemi të kënaqur që ndodhemi në Shqipëri. Kemi gjetur shumë mundësi. Jemi të impresionuar nga ajo që kemi parë. Zhvillimi po ecën gjithnjë e më tepër me ritme të shpejta. Shpresoj të bashkëpunojmë së bashku në sektorin e ekonomisë. Ju falënderoj të gjithëve, edhe ministrin e Turizmit për kohën që po na kushton neve! Kemi në plan të investojmë në Shqipëri. Do të nisim investimet. Disa prej kolegëve tanë do të investojnë në qendër të Ti-



'Prestige Resort'

ranës dhe në Bulevardin e Ri. Është një qytet atraktiv, i këndshëm, njerëzit të presin ngrohtë. Ministri i Turizmit është shumë serioz në qëndrimin e tij për t'i dhënë qëndrueshmëri turizmit në Shqipëri", - tha Muneer M. Bin Saad. Ndërkohë, Bader Suliman pronar i një kompanie ndërtimi, e sheh Shqipërinë si një vend të bukur dhe premtues për investime.

"Mendojmë se ekziston një potencial i madh për ekonominë shqiptare pas ndërtimit të infrastrukturës dhe përpunimit me nevojat e turistëve. Nëse rregullohet infrastruktura, do të keni një impakt shumë të mirë turistik. Është një peizazh i bukur, njerëz të mirë, ushqim i mirë. Mendojmë se ka një potencial të madh për të investuar këtu.

Jemi në fazën paraprake, duke mbledhur fakte. Po përpikemi të zbulojmë se çfarë lloj investimesh mund të bëjmë. Jemi kryesisht biznesi i ndërtimit, kështu që linja jonë e punës është në projektet e infrastrukturës. Tashmë po bisedojmë me zyrtarët dhe biznesmenët, po njihemi me planet e tyre, ofertat që paraqesin dhe kushtet që na ofrojnë. Ven-

dimin do ta marrim pasi të shohim të gjitha këto", - tha Bader Suliman.

INVESTIMET

Arabia Saudite ka në plan të sjellë edhe turistë në Shqipëri. Shefi ekzekutiv i kompanisë "Flyas", Bander Almohanna, beson se vendi ynë i ka të gjitha elementet që përputhen me kërkesat e turistëve sauditë. "Jemi shumë të sigurt që Shqipëria do të jetë një ndër vendet lidere në turizëm dhe ne do të jemi të lumtur të marrim pjesë dhe të kontribuojmë me qeverinë. Mendoj se Shqipëria është ende një vend i virgjër dhe ka shumë mundësi për biznesmenët për të eksploruar. Deri tani kemi vizituar qytete turistike, Tiranën dhe Durrësin dhe të dyja janë tërheqëse. Jam i interesuar të shoh edhe vende të tjera, por ajo çfarë kam parë deri tani është

të mbresëlënëse. Resorti ku po qëndrojmë na ka surprizuar me pamjen që ofron, shërbimin, cilësinë e ushqimit. Mendojmë të investojmë edhe këtu", - tha Bander Almohanna. Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, thotë për "News 24" se interesi i delegacionit të biznesmenëve arabë është drejtuar edhe portet i Durrësit, i cili është një prej porteve më të mëdhenj të Shqipërisë, por njëkohësisht edhe një nga portet që ka pozicion gjeografik shumë të përshatshëm për rajonin në përgjithësi, Maqedoni, Kosovë, Bosnjë apo Serbi. "Facilitetet që administrua e bashkisë, ministrinë, qeveria shqiptare po u krijon investitorëve u duk edhe në këtë takim të sotëm, ku ata shprehën shumë interes dhe janë në hapat e konkretizimit të disa investimeve që duan të realizojnë në Shqipëri, por edhe në rajonin Durrës-Tiranë. Shpresoj që në fund të këtij viti t'i konkretizojmë bashkëpunimet tona dhe t'i prekim investimet që ata do të realizojnë në Durrës. Ne krijojmë klimën, të gjitha lehtësirat dhe të gjithë dokumentacionin që atyre u duhet për t'ua bërë të mundur që të vijnë dhe të investojnë në Durrës. Pra, ne japim garanci që investimet e tyre në qytetin e Durrësit janë të paprekshme dhe janë investime që do t'i rikthehen për arsye të të gjitha faciliteteve tona. Që do të thotë se ne jemi të hapur të ndihmojmë me licencimet, me lejet e ndërtimit, me administratën, e cila të jetë aktive dhe prezente në të gjitha kërkesat që ata kanë, sepse janë investitorë të huaj, nuk e njohin mirë territorin e Durrësit dhe për këtë arsye kërkojnë një garanci. Kërkojnë mbështetje nga ana e institucioneve lokale dhe padyshim edhe nga ana e atyre qendrore. Ne këtë ua kemi ofruar dhe synojmë që të bashkëpunojmë për të investuar, sepse investimi sjell vende pune, sjell zhvillim ekonomik dhe mirëqenie për të gjithë", - tha Dako.

Klosi: Shqipëria mbështet investimet në turizëm

Ministri i Turizmit, Blendi Klosi, që ishte pranë biznesmenëve gjatë qëndrimit të tyre në "Prestige Resort" thotë se Shqipëria ofron një paketë kushtesh për të mbështetur investimet e huaja, veçanërisht në turizëm. "Në kuadër të kësaj iniciative, ne sot kemi disa hotele me pesë yje në vendin tonë, marka të reja ndërkomëtare, të cilat kanë arritur të gjejnë marrëveshje me biznesmenët lokalë, siç është edhe hotel 'Prestige', i cili garanton një standard me pesë yje në vendin tonë. Po ashtu, edhe vizita e Dhomës së Tregtisë nga Arabia

Saudite dhe disa grupeve të tjera, që po shtohen gjithnjë e më shumë janë shprehje e interesit se politikat nxitëse, stabiliteti i vendit, politikat ekonomike dhe qëndrueshmëria në rritjen ekonomike të ekonomisë shqiptare i bën investitorët e huaj të garantuar se këtu do të gjejnë një atmosferë shumë të rëndësishme për turizmin, një atmosferë të mbrojtur dhe natyrisht për biznes. Rritja e numrit të turistëve në Shqipëri dhe qëndrueshmëria e rritjes së turizmit në përgjithësi dëshmon për ta një garanci se biznesi i tyre do të ketë fitime dhe do të ketë sukses", - tha Klosi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,840,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 14 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 54,345,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 23 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Të rinjtë u arrestuan 7 muaj më parë në Morinë nga policia e agjentët e DEA-s

Ngritën laborator drogash sintetike në Tiranë, ekstradohen në SHBA 2 amerikanët

Vincent DeCaro, 30 vjeç dhe Arbër Isaku, 29 vjeç ishin shpallur në kërkim ndërkombëtar

TIRANË

Interpol Tirana ka ekstraduar drejt SHBA-ve dy shtetas të kërkuar nga Interpol Uashingtoni. Në kuadër të bashkëpunimit me Shërbimin Diplomatik të Sigurisë dhe Hetimit pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe Interpol Uashingtonin/SHBA, u bë ekstradimi nga Shqipëria drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës i shtetasve Vincent DeCaro, 30 vjeç dhe Arbër Isaku, 29 vjeç, të dy të lindur në SHBA. Mësohet se këta dy persona ishin shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Uashingtoni/SHBA, pasi Gjykata e Connecticut/SHBA, në vitin 2018 ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope" parashikuar nga Kodi Penal i SHBA-ve. Arrestimi provizor i shtetasve të mësipërm, me qëllim ekstradimi drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës është bërë në datën 21.09.2018 gjatë një operacioni të përbashkët mes Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Diplomatik të Sigurisë dhe Hetimit pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe Interpol Uashingtonin/SHBA. Vincent DeCaro, 30 vjeç dhe Arbër Isaku iu dorëzuan oficerëve të Policisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Aeroportin e Rinasi.

KUSH JANË DY TË RINJTË?

DeCaro dhe Isaku u arrestuan teksa tentonin të largoheshin drejt Kosovës nga pika e kalimit kufitar e Morinës. Ata ishin nën hetim prej një viti nga DEA,



29-vjeçari Arbër Isaku



Ekstradimi nga Rinasi

LABORATORI I DROGËS

Arbër Isaku, një shqiptaro-amerikan i lindur dhe rezident në Nju Jork ishte prej disa muajsh me qëndrim në Shqipëri. Ai ishte arrestuar nga policia amerikane më 27 gusht 2017 dhe gjatë kontrollit të banesës, agjentët amerikanë kanë mundur të sekuestrojnë 160 gr fentanyl dhe 200 tableta 30 gr të dyshuara si lëndë psikotrope. Të dy kishin krijuar në një kompleks pranë Rrugës së Kavajës, laboratorin e prodhimit të drogave sintetike.

LETËR-POROSIA

Nga letër-porositë e autoriteteve amerikane rezultoi se eksperti i përzjerjeve kimike dhe realizimit të lëndëve narkotike sintetike ishte DeCaro. I përfshirë në këtë aktivitet kriminal rezultoi edhe një shtetas tjetër amerikan i proceduar më parë dhe i njohur me emrin Richard, por për llogari të drejtësisë amerikane. Tregu në të cilin operonin me aktivitetin e tyre të paligjshëm ishte portali "DarkWeb", në të cilin të fshehur pas pseudonimeve personat kryenin tregti droge dhe armësh.

ndërkohë që kishin krijuar bazë dhe fshiheshin në Tiranë, ku po përgatiteshin për

të prodhuar drogë sintetike. Pas marrjes së letër-porositë dhe vendimit të Gjykatës së

Krimeve të Rënda për ekzekutimin e saj, Departamenti i Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit pas 1 muaji hetimi në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe DEA-n arriti të zbulojë bazën ku fshiheshin. Gjatë kontrollit në bazën ku fshiheshin dhe zhvillonin aktivitetin kriminal këta shtetas u gjetën dhe u sekuestruan mjetet dhe prekurorët që do të shërbënin për përgatitjen e drogave sintetike, si edhe një numër i madh pajisjesh elektronike. Shtetasit e mësipërm u mbajtën nën vëzhgim nga agjentët e Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit dhe u arrestuan në Morinë, në tentativë për t'u larguar nga Shqipëria. Në

operacion kanë marrë pjesë edhe agjentët e DEA-s.

Isaku, një shqiptaro-amerikan i lindur dhe rezident në Nju Jork ishte prej disa muajsh me qëndrim në Shqipëri. Ai ishte arrestuar nga policia amerikane më 27 gusht 2017 dhe gjatë kontrollit të banesës, agjentët amerikanë kanë mundur të sekuestrojnë 160 gr fentanyl dhe 200 tableta 30 gr të dyshuara si lëndë psikotrope. Të dy kishin krijuar në një kompleks pranë Rrugës së Kavajës laboratorin e prodhimit të drogave sintetike. Nga letër-porositë e autoriteteve amerikane rezultoi se eksperti i përzjerjeve kimike dhe realizimit të lëndëve narkotike sintetike ishte DeCaro. I përfshirë në këtë aktivitet kriminal rezultoi edhe një shtetas tjetër amerikan, i proceduar më parë dhe i njohur me emrin Richard, por për llogari të drejtësisë amerikane. Tregu në të cilin operonin me aktivitetin e tyre të paligjshëm ishte portali "DarkWeb", në të cilin të fshehur pas pseudonimeve, personat kryenin tregti droge dhe armësh. Agjentët amerikanë kanë kërkuar nga autoritetet shqiptare të ekzaminohen të gjitha pajisjet elektronike e sekuestruara të të arrestuarve si dhe IP-ja e linja e internetit të përdorur nga DeCaro dhe Isaku gjatë periudhës që ata kanë qëndruar në Shqipëri.

SHKURT

Sekuestrohen 288 kg heroinë, u gjet e fshehur në kamion

BULLGARI - Zyrtarët bullgarë të doganave njoftuan se kanë konfiskuar 288 kilogramë heroinë të gjetur në një kamion, i cili vinte nga Irani dhe hyri në Bullgari përmes Turqisë. "Droga u zbulua në pikën e kontrollit "Kapitan Andreevo", tha të premtun doganierja Ivan Kuchmov. Sasia e madhe e heroinës ishte futur në 144 pako të fshehura brenda makinerisë së deklaruar që po transportohej me kamion. Për këtë u arrestuan si përgjegjës shoferi iranian dhe një shtetas turk. Ata rrezikojnë 20 vite burg, nëse shpallen fajtorë për veprën e trafikut të drogës dhe narkotikëve. Bullgaria, e cila shërben si transit për transportin e drogës nga Lindja e Mesme drejt Evropës Perëndimore ka shtuar masat e kontrollit, duke bërë të mundur bllokimin e trafiqeve. Në statistikat e publikuar thuhet se gjatë vitit 2018 janë konfiskuar 1021 kg heroinë në pikat kufitare të vendit, pothuajse 20 për qind më shumë se një vit më parë, duke treguar një sukses kundër narkotikëve.

1000 kontrolle nga OSHEE, procedohen 67 abonentë

SHKODËR - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) ka ndërmarrë një aksion në Shkodër, si një nga zonat e konsideruara problematike për vjedhjen e energjisë elektrike. Gjatë dy javëve të fundit janë realizuar rreth 1000 procedura verifikimi në qytetin verior nga Departamenti i Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve (njësi e specializuar Task Forcë). Kontrollat kanë konstatuar 18 raste linjash furnizimi jashtë matjes, 35 raste rilldhjesh të paligjshme, 7 raste furnizimi pa kontratë dhe 3 ndërhyrje në sistemin e matjes. Në vijim të këtyre rasteve të konstatuara, OSHEE ka depozituar procedim në organet e drejtësisë për 63 konsumatorë (biznese dhe familjarë).



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,400,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë. Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkrahimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 13 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilin do të hapet edhe tenderi, ku tohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

NUJFTIMI ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbartimit "BALLIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të II (Dytë), për shërbim të pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 496/386+3-N2, Vol. 52, Faqe 239, ndodhur në Linzë Dajt, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGLI" shpk identifikuar me NIPT J71720304M. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 4,962,048 (katër milion e nëntëqind e gjashtëshjetë e dy mijë e dyzet e tetë) LEKË. Ankandi do të zhvillohet më datë 23.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbartimit "BALLIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telofon 042320227, email: elvinth@hotmail.com

Javën e ardhshme nis pyetja e drejtuesve të Rinasit. Prokurorët do të marrin dëshmitë

Grabitja e 5.7 milionë eurove në aeroportin e Rinasit, hetuesit: Morën pjesë 12 persona

Përveç 5 autorëve, në ngjarje dyshohet të jenë përfshirë edhe 7 të tjerë me rol vëzhguesi dhe ndihmësi

TIRANË

Prokuroria e Krimeve të Rënda do të nisë javën e ardhshme marrjen në pyetje të zyrtarëve të aeroportit të Rinasit për grabitjen e parave mesditën e 9 prillit. Sipas TV "Klan", hetuesit gjatë këtyre ditëve kanë administruar dokumentacionin dhe praktikën e ndjekur në aeroportin e Rinasit ditën kur ndodhi grabitja. Po kështu, është sekuestruar edhe kontrata që TIA ka nënshkruar me kompaninë ICTS, që kishite për detyrë ruajtjen e pistës së aeroportit të Rinasit. Policia nuk ka zyrtarisht ende asgjë të identifikuar nga grabitësit që në bashkëpunim me Admir Muratajn rrëmbyen nën kërcënimin e armëve rreth 5.7 milionë euro. Përveç Muratajt, që mbeti i vvarë nga shkëmbimi i zjarrit me policinë, grupi hetimor dyshon se në grabitje morën pjesë të paktën edhe 7 persona të tjerë, që kanë luajtur rol vëzhguesi dhe ndihmësi. Hetuesit kanë dyshime se Murataj ka bashkëpunuar me persona që ka pasur njohje të vjetër dhe ka kryer më herët grabitje me këta të fundit. Ndërkohë, policia e Rinasit tashmë ka nisur patrullimet në perimetrin që më herët ushtronte kontroll vetëm kompania ICTS, ndërsa masa janë marrë edhe në sallën e kamerave të sigurisë, ku do të qëndrojnë edhe punonjësit policie. Një ditë pas grabitjes, në perimetrin e jashtëm u dislokuan edhe forca ushtarake, që do të mbështesin policinë për ruajtjen e sigurisë në Rinas.

BASHKËPUNËTORËT E DYSHUAR

TË ADMIR MURATAJ

Pak ditë pas supergrabitjes së ndodhur në aeroportin e Rinasit, dyshohet se bashkëpunëtorët e Admir Muratajt, që mbeti i vvarë me plumb në kokë janë persona me të cilët ai ka njohje të hershme dhe ka kryer disa grabitje me ta. Mjeshtrët i grabitjeve të bankave, kështu është cilësuar Klement Çala, 31-vjeçari që dyshohet të ketë bashkëpunuar me Admir Muratajn edhe në grabitjen e 9 prillit. Emri i tij ka dalë gjatë hetimeve për ngjarjen që mori vëmendjen e të gjithëve, jo vetëm brenda kufijve. Vrasja dhe identifikimi i Muratajt bëri që policia të verifikojë emrat pranë tij dhe bashkëpunëtorët nga e kaluara. Policia nisi vëzhgimin dhe dyshon se ish-policë me iniciale M.H., Aleks Pepa dhe Klement Çala kanë bashkëpunuar me Muratajn edhe



Admir Murataj

në grabitjen e fundit të miliona eurove nga një avion që do të udhëtonte drejt Austrisë. Por arrestimi i tyre kërkon prova, të cilat grupi hetimor po i verifikon nëse do t'i çojnë te personat e dyshuar.

Prokuroria ka bërë pjesë të këtij hetimi edhe grabitjen e 30 qershorit 2016, ku në pistën e Rinasit u grabitën 1 milion euro. Për këtë ngjarje u shpall në kërkim Aleks Pepa, 44-vjeçari nga Elbasani, së bashku me dy persona të tjerë thyen sigurinë në Rinas thuasje me të njëjtën mënyrë që u përdor në grabitjen e 9 prillit. Por, provat e policisë që këto tri grupe të kenë bashkëpunuar dhe të jenë bërë një në grabitjen e fundit janë të pakta, megjithatë është njëra pistë që po ndiqet. Ende policia nuk ka rënë në gjurmët e këtyre personave, pasi janë mjaft të kujdesshëm dhe nuk lënë gjurmë për lëvizjet që kryejnë. Ndërsa, ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj, paraditen e së premtes ka zhvilluar një takim me krerët e policisë. Pjesë e diskutimeve ka qenë edhe grabitja e ndodhur në pistën e Rinasit. Të enjten në parlament Lleshaj tha se kjo ngjarje do të zbardhet shumë shpejt. Ndërkaq, dy ditë më parë, policia ka nisë një aksion në fshatrat e Fushë-Krujës në kërkim të autorëve të grabitjes në aeroportin e Rinasit. Blutë kanë marrë indicie se autorët e grabitjes mund të fshihen në këto fshatra.



Grabitja në aeroportin e Rinasit

Kryeprokurorja e Tiranës, Elisabeta Imeraj: SPAK do të përmirësojë goditjen ndaj krimit dhe korrupsionit

TIRANË - Drejtuesja e Prokurorisë së Tiranës, Elisabeta Imeraj, tha ditën e djeshme se reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngritja e strukturave të posaçme antikorruption, SPAK, janë të nevojshme për t'u përballur me krimin. "Për produktin duhet të presim. E rëndësishme është që të gjitha mekanizmat e përfshira në zbatimin e këtij legjislacioni të ndryshuar, pra në zbatim të reformës në drejtësi të bëjnë punën e duhur, në mënyrë që produkti si SPAK të dalë siç duhet. Kjo pritet për t'u parë në varësi të punës që po bën secila nga institucionet përkatëse", tha kryeprokurorja e Tiranës. Imeraj i bëri këto komente në një takim që organizoi qendra "Zëri i Integritetit" me studentët të juridikut për të diskutuar mbi plotësimin e detyrave antikorruption, që BE i ka vendosur Shqipërisë. Ajo i krahasoi këto struktura të reja speciale kundër korrupsionit në 2019-ën si një domosdoshmëri njëjloji si ishte e nevojshme ngritja e Gjykatës dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda në 2004-



ën, pra si një kundërpërgjigje ndaj krimit në periudha të ndryshme kohore. Drejtuesja e Prokurorisë së Tiranës, e cila ka qenë më parë prokurorë e Krimeve të Rënda, kërkoi mbështetjen e komunitetit qytetar dhe mediave në punën e hetuesve, të cilët janë pjesë e komunitetit dhe kanë angazhimet e tyre në familje dhe në lagje, e dërgojnë fëmijët në kopshte e shkolla si gjithë të tjerët. "Fakti që prokurorët hetojnë edhe raste korrupsioni të kolegëve të tyre tregon se vullneti i tyre për punë të ndershme ekziston. Nga kjo trupë prokurorësh dhe gjyqtarësh në kemi disa të hetuar, të gjykuar e të deklaruar fajtorë, edhe pse

janë kolegë tanë", - tha zonja Imeraj. Ajo u shpreh se prej shumë vitesh hetoi krimet e rënda dhe tani që drejton Prokurorinë e Tiranës, e quajti si hap të natyreshëm kandidimin e saj për t'u bërë pjesë e strukturës speciale antikorruption, SPAK-shkruan VOA. Shqipërisë i kërkohet prej disa vitesh nga BE-ja të luftojë më me forcë krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe ta tregojë këtë me rezultate konkrete, ndërsa një reformë e thellë strukturave ka përfshirë sistemin e drejtësisë, pjesë e të cilëve krahas vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë edhe strukturat SPAK dhe BKH.

SHKURT

Kandidat për Kushtetuesen, gjyqtari Bekteshi drejt konfirmimit

TIRANË - Gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, njëherazi kandidat për Gjykatën Kushtetuese, Rexhep Bekteshi u përball pa probleme të premtën me vetingun gjatë seancës dëgjimore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, KPK. Treshja gjyqese përbëhej nga Roland Ilija kryesues, Firdes Shuli relatore dhe Brunilda Bekteshi anëtare, ndërsa në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar ishte e pranishme Mia Roessingh. Relatorja e çështjes, Firdes Shuli u shpreh në fillim të seancës dëgjimore se gjyqtari Bekteshi është vlerësuar për të tria kriteret. Lidhur me pasurinë e gjyqtarit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, ILDK-PKI ka dorëzuar pranë komisionit një raport sipas të cilit, ai kishte kryer deklarim të saktë e kishte burime financiare të ligjshme.

Të shohet siguria në portin e Durrësit, plan musash për sezonin

DURRËS - Në prag të nisjes së sezonit turistik, Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, për të garantuar mbarëvajtjen e çështjeve të sigurisë në anijet dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë, zhvilloi një testim sa i takon nivelit të sigurisë në ambientet e terminalit të pasagjerëve në portin Durrës. Ushtrimi i sigurisë ka për qëllim testimin e planit të sigurisë së portit, gatishmërinë e Forcës së Sigurisë dhe bashkëveprimin e strukturave përkatëse ligjzbatuese në port. Demonstrimi i ushtrimit testues u ndoq nga afër nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbartimore L.D.C

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbartimore L.D.C
 "Triull + ndërtesa" me nr. pasurisë 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale, 3866, me sipërfaqe totale 300 m², regjistruar në Z.V.R.P.P.
Dana, çmimi fillestar për shitje është 1.800.000 Leka.
 Data e shpalljes 27.02.2019
 Data e zhvillimit 28.03.2019 deri në orën 16.⁰⁰
 Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

SHOQËRIA PËRMBARTIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
 Rr. "Tish Dala", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tirane
 Web: www.3h.al Email: shqg_3h@yohoo.com tel: 020202711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.16.04.2019 deri ne dt. 24.04.2019 per: sendin e luajtshem- automjetin terheqes Renault me Targa AA 245 OE, model Magnum 480 me cmim fillestar 751,800.00 Leka automjetin gjysem rimorqo marka Fruehauf TD 35, me Targa AER 831 me cmim fillestar 98,800.00 Leka ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L.
Ankandi zhvillohet ne zyrën permbartimore ne daten 24.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së pajllajshme për të cilën ka vene hipoteke ABI BANK, me këto të dhëna:
 "Ari", me sipërfaqe 5,130 m², me adresë në Piraj, Lezhë, , ne Zonën Kadastrale Nr. 2964, me Nr. Pasurisë 2019, Vol. 1, fq. 127, në proninë të zri, Alma Lulaj Marku.
 Në vlerën 2.490.000 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Leka.
 "Njësi", me sipërfaqe 191 m², me adresë në Lagen "Besëlidhja", Lezhë, , ne Regjistrin hipotekor Nr. 578, date 28.10.2016, ne Zonën Kadastrale Nr. 8632, me Nr. Pasurisë 4/400-N11, në pronësi të Shoqëria ENCO GROUP sh.p.k
 Në vlerën 107.200 EUR(njëqind e shtatë mijë e dyqind) EUR.
 Ankandi zhvillohet në datën 03.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartuesit gjyqësor me adresë Bulevardi Bajam Curri", Pal. Shk.21, Sh.3, Ap. 18, Tiranë.



Arqiveshvi Metropolit Shkodër-Pult uron besimtarët për festën e Pashkëve

"Jetojmë në kohë të vështira", Angelo Massafra: Secili të bëjë pjesën e vet

Arqiveshvi Metropolit Shkodër-Pult, Angelo Massafra, ka zgjedhur Ungjillin sipas Gjonit për të uruar besimtarët e krishterë me rastin e Pashkëve katolike.

Ndër të tjera, Massafra uron besimtarët që të mikpresin kumtimin e emrit të Jezusit të Ngjallur, të cilit i kërkon të shpëtojë e lirojë Shqipërinë prej padrejtësive, mendjemadhësisë e etjes për pushtet.

"Për këtë arsye, ju uroj të gjithëve ju, katolikë, ortodoksë e krishterë që të dini ta mikprisni kumtimin e emrit të Jezusit të Ngjallur! Ai na shpëtoftë dhe e liroftë Shqipërinë tonë prej padrejtësive, prej mendjemadhësisë, prej etjes për pushtet dhe zotërim, pasi këto gjëra shkaktojnë urrejtje, hakmarrje dhe vrasje", thotë Massafra.

MESAZHI I PLOTË

"Shko te vëllezërit e mi e thuj:

Po ngjitem tek Ati im e Ati juaj, tek Hyji im e Hyji juaj".

(Gjn 20, 17).

Për urimet e mia për Pashkën 2019, këtë vit kam zgjedhur rreshtin e Ungjillit të Gjonit, ku përshkruhet përvoja e të Ngjallurit, që bën Maria Magdalenë, figura e Kishës që është në kërkim të Zotit të vet. Për fenë tonë varri i zbrazur është një shenjë e Ngjalljes, ashtu si Gjoni apostull, edhe ne, që në ditët e mundimeve e kemi ndjekur Jezusin, i kemi rjetuar ngjarjet e kryqëzimit dhe të vdekjes së tij, të drejtuar prej dashurisë,



Arqiveshvi Metropolit Shkodër-Pult, Angelo Massafra

risë, na mjafton të dimë se varri ku e kishin vënë, tani është bosh. Por kjo nuk mjafton që fesë sonë t'i bashkohet edhe përmasa e gëzimit të brendshëm dhe të jashtëm. Nevojitet një "më shumë", që është takimi dhe përqafimi me Zotin e kryqëzuar dhe të ngjallur. Edhe ne, besimtarët e Kishës në Shkodër-Pult jemi duke kërkuar të dashurin, shikojmë duke përsëritur emrin e tij, duke ua thënë edhe të tjerëve, që ta kërkojnë së bashku me ne dhe, pasi ta gjejnë, të gëzojnë edhe ata. Por, këtë takim ne të krishterët e bëjmë çdo ditë: ashtu si Marisë, edhe neve i Ngjalluri na e drejton fjalën e vet; madje na thërret në emër, duke na zbuluar në këtë mënyrë se sa shumë ai na njeh dhe na do, sepse njohja dhe dashuria shkojnë së bashku. Edhe ne e thër-

rasim në emër, duke bërë që ky emër të tingëllojë në asambletë tona, sepse emrin i Tij është "emri që është mbi çdo emër" (Fil 2, 9). Dhe çdo ditë ai, i Ngjalluri, na jepet neve në formën e bukës dhe të verës eukaristike, sepse dashuria e tij për ne nuk është vetëm "me fjalë", por konkrete: nuk mjaftohet që të na bëjë "ta ndiejmë" fjalën e Tij, por dëshiron edhe që të jetojmë me

ne një bashkim të thellë, që ne e quajmë "bashkësi". Dhe, si të mos mjaftonte, na mbush me shpirtin e vet, që gjallëron të gjitha veprimet tona. Këtë gjë bëjmë ne si Kishë çdo ditë! Ka vetëm një problem: sa kjo e vepruar kishtarë është edhe e vepruar e çdo besimtar? Duhet ta bëjmë këtë pyetje, të dashur vëllezër e motra! Kjo pyetje është thelbësore për jetën tonë të fesë. Pasi, nëse nuk është kështu, përvoja jonë e të Ngjallurit nuk do të ishte e plotë. Marisë Magdalenë i jepet edhe një detyrë e rëndësishme: t'ua kumtojë të Ngjallurin vëllezërve të vet dhe motrave të veta; por edhe neve Jezusi na jep detyrën për të shpallur i Gjallë.

Të dashur, mos u lodhim në të qenurit tonë misionarë të të Ngjallurit, le të themi dhe ua tregojmë të tjerëve fuqinë e emrit të tij që shëron, fal e shpëton. Vëllezër dhe motra, është e vërtetë, jetojmë një moment të vështirë, të gjithë e ndiejnë vështirësinë për të jetuar, që ndonjëherë i ngjan një lufte për mbijetesë. Le të mos shkurajohemi, të

shikojmë gjithçka që kemi bërë në këto vite, të vlerësojmë ecjen që kemi bërë deri tani me shumë sakrificë. Secili prej nesh, sot, të bëjë pjesën e vet... e ardhmja është edhe në duart të secilit, përveç të Zotit. Për këtë arsye, ju uroj të gjithëve ju, katolikë, ortodoksë e krishterë, që të dini ta mikprisni kumtimin e emrit të Jezusit të Ngjallur: Ai na shpëtoftë dhe e liroftë Shqipërinë tonë prej padrejtësive, prej mendjemadhësisë, prej etjes për pushtet dhe zotërim, pasi këto gjëra shkaktojnë urrejtje, hakmarrje dhe vrasje! Ai na dhëntë guximin e nevojshëm për të fituar mbi çdo formë egoizmi, forcën për t'u angazhuar për të mirën e përbashkët në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të vëmendshme ndaj nevojave të më nevojtarëve dhe na dhëntë gëzimin e brendshëm e të thellë për të qenë qytetarë aktivë, të ndershëm dhe guximshëm për rindërtimin shpirtëror, moral, kulturor dhe ekonomik të atdheut tonë të dashur!

Për shumë vjet Pashkën të gjithëve!

BalkanWebj.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Agjencia Shtetërore e Kadastrës/ Zunë truallin pa leje, bëhen pronarë

Qeveria miratoi kalimin e të drejtën mbi pronësinë për parcelat ndërtimore ku janë ndërtuar objekte pa leje. Agjencia Shtetërore e Kadastrës publikon listën me 200 pronarë që marrin certifikatën e pronësisë. Përfuturit janë në Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Shitesat, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. 'Gazeta Shqiptare' publikon listën e plotë me përfutuesit në të gjithë vendin.

VENDIMI

Këshilli i Ministrave vendosi në mbledhjen e fundit miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë, në favor të subjekteve përfutuese, për 200 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara, që preken prej tyre, sipas shprehjes që i bashkëlidhet këtij vendimi. Sipas ligjit në fuqi

Tapi për 200 familje, ja kush përfiton truallin

Përfutuesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë

nuk mund të legalizohet më shumë se 3-fishi i bazës së objektit të ndërtuar pa leje. Në rast se një person ka ndërtuar 50m2 do të marrësh 150 metra dhe kjo logjikë do të ndiqet për të gjitha ndërtimet. Objektet tregtare që kanë bërë ndërtime p.sh., 500

metra do të marrin 1500 metra, por do ta paguajnë me çmim tregu. Ndërsa për llogaritjen e vlerës së parcelës është marrë gjysma e vlerës së tregut. **KALIMI I PRONËSISË** Në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohet që

kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Në rastin e ndërtimeve me funksion banimi, si rregull sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë duhet të jetë deri

në masën e trefshit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m². Për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik zbatohet vetëm kriteri i trefshit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Kur për shkak të përmasave

ose konfiguracionit të parcelës ndërtimore krijohen sipërfaqe të lira, që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

LIGJI

Sipas ligjit në fuqi nuk mund të legalizohet më shumë se 3-fishi i bazës së objektit të ndërtuar pa leje. Në rast se një person ka ndërtuar 50m2 do të marrësh 150 metra dhe kjo logjikë do të ndiqet për të gjitha ndërtimet.

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Udhëzime juridike (pronës)
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit		
			Numer	Date	
TIRANE JUG					
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8380					
KAMEZ-VORE					
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2066					
NAIM	MET	PASHA	70209326	20.02.2018	TE TRETEVE E(500 m ²)
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2884					
NAZMI	RRAHMAN	HYSA	70209250	18.02.2018	TE
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1649					
IMER	HALIL	HALMUSA	70208286	27.07.2018	TRETEVE E(500.5)
SAIMI	IMER	HALMUSA			
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1649					
VEHA	MET	TODAJ	70202102	15.02.2016	TE
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1066					
SKEN	RIZA	SELITA	70208215	21.07.2018	TE
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2884					
ISUF	XHAFERR	POLES	20063	13.03.2012	TE
TIRANE SHITESAT					
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260					
JORG O	NDONI	PRIFTI	120392	26.07.2018	
NIKOL L	MARK	NDOI	119116	16.06.2017	
FREDI	DEMIR	XHAFER AJ	119502	28.09.2017	
FASLLI	NJAZI	KORITA	120595	17.10.2018	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260					
GELDON	GEZIM	TELA	118584	07.03.2017	
FREDERIK	PETRIKA	MUSHI	118677	27.03.2017	
HASIME	JONUZ	ÇELA	118676	27.03.2017	
ALBI	BESNIK	MUÇO			

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Udhëzime juridike (pronës)
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit		
			Numer	Date	
TIRANE, ZONA KADASTRALE 8160					
LIRAK	MUNTAZ	KODRA	120052	25.04.2018	
EVA	YZEIR	SEJDIA	120127	22.05.2018	
BARIJE	MALIQ	NAJDENI			
KUJTIM	MERO	HAKCANI	120053	25.04.2018	
MEHMET	MEHMET	HAKCANI	120054	25.04.2018	
IFETE	SHYQYRI	HASIMJA	120055	25.04.2018	
FIQIRI	ALI	DUMI	120057	25.04.2018	
GAVRIL	THIMI	QIRJO	120056	25.04.2018	
KRIST	LLUKAN	DUSHI	119942	23.03.2018	
NAZMI	ALUSH	REXHEPI			
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8220					
TAHIR	TAIP	KALEMAJ			
TAHIR	TAIP	KALEMAJ	119112	16.06.2017	
FANIJE	THOMA	HAMLLA	119007	23.05.2017	
LUTFUE	MEHMET	KOÇI	119008	23.05.2017	
FATMIR	MEHMET	SHETA	119006	23.05.2017	
FLAMUR	SULEJMAN	DEMNERI	119114	16.06.2017	
TEUTA	SULEJMAN	DEMNERI			
MERITA	SULEJMAN	DEMNERI	119114	16.06.2017	
FLAMUR	SULEJMAN	DEMNERI	119054	05.06.2017	
VLORE					
QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 2832, ZVRPP Vlorë					
REIZ	MEZIN	KULL	212036	25.09.2018	Shtetëror
DERVI	MEZIN	KULL	212034	25.09.2018	Shtetëror
GURI	MEZIN	KULLURI	212035	25.09.2018	Shtetëror e (0)m ² E te
QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 8602, ZVRPP Vlorë					
PATRIOT	SADIK	NURAJ	4983	16.02.2011	Shtetëror e (0)m ² E te tretteve (440.7) m ²
QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 8605, ZVRPP Vlorë					
RIZA	DEMIR	NANA	212207		Shtetëror e (0)m ² E te tretteve (500) m ²
					Shtetëror e (0)m ²

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Ojenu a juridike (prones)
Emër	Atësi	Mbiem ër	Leja e legalizimit		
			Numer	Date	
GURI	DEMIR	NANA	107478	21/10/2018 42951.00	Shtetor e (0)m ² E te treve (500) m ²
ELBASAN					
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 3422					
ARDJ AN	MEHDI	KABAS HI	2579886	31.08.2018	PRON AR
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527					
LEZHE					
QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA KADASTRALE 8632					
JAK	NDUE	MARKU	816912	27.06.2016	E te
MONDI	JAK	MARKU	817941	26.08.2016	E te
DURRES					
QARKU DURRES, ZVRPP DURRES, ZONA KADASTRALE 3369					
EDM OND	ISLAM	ISAKU	223286	15.09.2016	PRONA R
ASTR IT	ISLAM	ISAKU	222656	06.09.2016	PRONA R
ARBE	KASEM	VORA			ME PRONA R
ISMET	KASEM	VORA			
BAJRA	KASEM	VORA	220020	12.07.2016	
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8515, ZVRPP DURRES					
PERP	NAZIF	HOXHA	242039	26.05.2016	ME
BASH	NAZIF	HOXHA	147097	29.02.2016	ME
QAMIL	TAIP	SPANESH	147088	11.02.2016	ME
SAIMI	NAZIF	HOXHA	152600	16.02.2016	ME
SELA	NAZIF	HOXHA	147096	31.03.2017	ME
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8517, ZVRPP DURRES					
NDRE	PRENG	CUMRA	280027	25.07.2018	
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27.05.2016	
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27.05.2016	
SHKODER					
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 1495, ZVRPP SHKODER					
BASHKI	OAZIM	ÇOBAJ	93194	31.11.2015	
ARIF	OAZIM	ÇOBAJ	92742	16.02.2015	
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8591, ZVRPP SHKODER					
HAKI	HASAN	FASLUA	18770	30.06.2017	
HASA N	MUSA	RAMJA	18769	20.07.2016	
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8593, ZVRPP SHKODER					
FRAN G	GJON	LEKAJ	10221	02.05.2012	
LAZE	KOL	GJEKAJ	10005	26.04.2012	
NDOC	NDUE	LEKAJ	11022	14.05.2012	
GJON	RAKE	DOÇAJ	19591	29.07.2016	
GJON	MARASH	KOLAJ	19583	13.10.2015	
KUJTI M	ZEF	VUKAJ	19584	27.12.2018	
LULE	SOKOL	GJELAJ	94803	10.05.2016	
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8597, ZVRPP SHKODER					
NDOC	KOLE	BJESHK A	102231	30.03.2018	

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar				
Emër	Atësi	Mbiem ër	Leja e legalizimit	
			Numer	Date
1	2	3	4	5
QARKU ELBASAN, ZVRPP GRAMSH, ZONA KADASTRALE 1842				
OSMAN	ZENEL	TAÇE		
MONDI	OSMAN	TAÇE		
LUAN	OSMAN	TAÇE	1020008	9.1.2017
OSMAN	ZENEL	TAÇE	792008	8.2.2017
SAIP	LAVE R	BIBA	528428423	31.1.2018
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526				
NJAZI	MURA	MUSAI	28938	15.3.2018
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526				
ZAIM	ZALO	NUHU	9997540	12.12.2015
MIDIL	QAZI	BIÇAKU	99632580	21.9.2015
SHPETIM	MIDIL	BIÇAKU	77965322	3.5.2016
ANDRI	MIDIL	BIÇAKU	778526	2.3.2016
SERVET	HYQIME T	DAUTI	990660	6.12.2014
BESIM	OSMA	BALLA	1020680	18.11.2016
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527				
BEHAR	QAMIL	VLLAHI	9925688	15.4.2015
ALBER	QEMAL	VLLAHI	9931251	25.8.2015
SAMI	IBRAHIM	XHAFI	991703	8.1.2015
HAJDA	RUSTEM	BOZHIQI	9928944	24.4.2015
ASTRIT	ASLLAN	SHOTI		2010
SKENDER	SALI	DEDA	992848	20.3.2015
SHEFQET	ISMAIL	RAMA	991755	4.2.2015
AGM	JAHO	ÇEKOJA	2578794	17.4.2018
BASHKIM	YMER	BEQIRI	58987458	20.10.2017
JANI	BAJRA M	GJOCA	79406	11.3.2016
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976, ZVRPP TIRANE				
MERITA	HAMIT	ZEQIRAJ	730890	26.8.2015
FLORINA	HALIT	CAM	1230131	24.7.2018
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170, ZVRPP TIRANE				
NAZMR	RAMAZAN	HIMA	122775	3.11.2017
BLEDAR	NAZMR	HIMA		
MIKEL	NAZMR	HIMA	721449	6.11.2015
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180, ZVRPP TIRANE				
FERIQ	XHEVAL	FERRA	19348	4.10.2012
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210, ZVRPP TIRANE				
ARQILE	KICO	FERI	18354	15.11.2012

DEBATI

AKUZA SI BASHKËPUNËTOR

Visar Zhiti: Fantazmagori absurde e patologji revanshi

Fatmira Nikolli

Shkrimtari: Po goditet e vërteta, qëndresë ndaj totalitarizmit barbar

PEN-i Shqiptar: Persekutorët me detyra të larta, se nuk u ndëshkuan

Xhelatët dhe viktimat e komunizmit janë vënë sërish përballë në demokraci, në një "luftë" ku po trajtohen si të barabartë e ku ndonëse kanë kaluar 30 vite nga rënia e regjimit, askush prej atyre që mbajtën poste drejtuese nuk u penalizua për krimet kundër njerëzimit. Kur debati me/për të shkuarën ka mbetur vetëm temë tryezash për trajnime, pa arritur kurrë në llogaridhënie e mbajtje përgjegjësie, vendi ynë ka njohur vetëm një "gjq kafesh" si shpagim për mëkatet zhurmëmëda. Asnjë fjalë për jetën e humbura, jetën e shkërmoqura, asnjë fjalë e asnjë penalizim për ligjet "mesjetare" apo tejkalimin e tyre. Asnjë i dënuar për krimet që pat bërë në emër të popullit, asnjë i dënuar as për ata që e patën tejkaluar ligjin dhe patën persekutuar për interesa të vetat nën maskën e makabritetit të një regjimi autoritar. Dikush është "dëmshtëpërlyer" me para nga shteti për jetën e çuar dem e tmerret e jetuara, por a blihet e shkuara me para? Përgjigja është doemos jo, sepse askush e asgjë nuk t'i kthen dot më mbrapsht vitet e humbura në skuta, luca e burje. Përtej kësaj, shembulli i krijuar në vendin tonë është precedent i rrezikshëm. Të mos dënosh kriminelët e një regjimi dhe të krijosh modelin e kulturën e mosdëshkimit (duke i mbytur klithmat me këste të dhëna para zgjedhjeve si lëmoshë), ka krijuar siç dëshmohet në rrethet e rrudhur në banorë, kur shumëkush zgjedh të ikë nga një vend që nuk e njeh drejtësinë as në raport me të shkuarën, as në raport me të tashmen. Thënë kjo, ne ende rrekemi të "blejmë" të shkuarën përmes "dëmshtëpërlyeve", qoftë kjo si shpagim për ish- të përndjekurit, qoftë kjo si mitmarrije për tashmen. Modeli që vendosëm e pranuan dikur, duke mos vënë para drejtësisë faktorët është kthyer në sistem dhe sistemet janë të vështira të zhbëhen. Surrjed-



Visar Zhiti

hojë e sa më sipër, ne po përballlemi me një situatë logjikisht krejt utopike. Xhelatët e kahershëm po shijojnë lirinë në "kapitalizmin" që patën dënuar e madje janë ende xhelatët tanë. Tashmë në një formë të re. Duke qenë se mbrojtja më e mirë është sulmi, në mungesën e institucioneve që do të duhej t'i kishin dënuar a t'i dënonin edhe tani, ata përdorin të drejtën e fjalës për të sulmuar e "dënuar" së dyti ata që i patën dënuar e sulmuar njëherë, duke i çuar jetën e tyre në tehu e thikës. Duke qenë se shpesh na e ka ënda të krahasohemi me Gjermaninë a të marrim shembull prej saj (jo vetëm) por kryesisht për çështjet e përballjes me të shkuarën, ish-xhelatët nazistë janë arrestuar dhe dërguar para drejtësisë edhe kur i kanë kaluar të 80-at, edhe me identitete të ndryshuara e, edhe nëse kishin shkuar literalisht në fund të botës. Rasti shqiptar është mjerisht i dhimbshëm dhe i turpshëm: ne nuk vumë asnjë kur për drejtësisë, por i emëruam në sistemet e drejtësisë, që edhe njëherë të na interpretojnë ligjet sipas midesë së vet. Ata u ribënë ekspertët "sui

generis". Ndërsa të përndjekurit u "gëzoheshin" thërrimeve që ua hodhën, përndjekësit ndërtauan një sistem të ri sipas modelit të vjetër, kur në krye të piramidës qëndrojnë ironikisht, po ata. Çorba që kemi gatuar është prishur e mban erë, por ne kemi zgjedhur të mbyllim hundët. Jemi sërish të mësuar e bashkëjetojmë me banalitetin e së keqes, që tashmë ka ndërruar formë për t'u kthyer në normalitet e mënyrë e të genurit. Nuk ka një përgjigje deri kur as pse kaq gjatë. Nuk ka një përgjigje për asgjë. Për aq kohë sa amullia vazhdon, për aq kohë sa sistemi është ky, na mbetet vetëm të shohim se deri ku do shkojnë dhe nëse do dinë të ndalin. Ne na është dhënë në duar lodra e lirisë, por dikush tjetër e ka telekomandën e saj. Ne mund të mendojmë se ajo nuk funksionon, por dikush tjetër e ka ndaluar atë.

RASTI "VISAR ZHITI"

Së fundmi, Edmond Caja, ish-kryepolic në kampin e Qafë-Barit e me banim në Gjermani e ka akuzuar Visar Zhitin si gënjeshtar dhe bashkëpunëtor të regjimit. Ndërsa një debat i

gjerë ka përfshirë atë, një deputet dhe disa prej shokqatave që kanë në fokus të punës së tyre zbardhjen e krimeve të së shkuarës, shteti shqiptar, luan rolin e vëzhguesit asnjansës. I pyetur nga "GSH" për sulmet që atij dhe Agron Tufës i janë bërë së fundmi nga disa personazhe publike që kanë qenë pjesë e strukturave në regjimin komunist e për të cilët ka edhe dokumente, shkrimtari Visar Zhiti, që ka vuajtur burgjet dhe persekutimin komunist, qe mjaft i qartë. "Sulmet që na bëhen sot nga ata që kanë mbajtur uniformat e diktaturës së dikurshme, që kanë punuar në organet e dhunës a të mbrojtjes së saj, pra nga ata që kishin punë persekutim janë jo vetëm fantazmagori absurde dhe patologji e revanshit, por edhe të rrezikshme, pra të dënueshme", tha Zhiti për "GSH". Në prononcimin e tij, ai theksoi se "janë dy herë të dënueshme, herën e parë duheshin dënuar si dhunues profesionistë dhe tani si shpifës ordinerë, ndotës të mjedisit mendor e shpirtëror". Shkrimtari, që përmes letërsisë së burgut ka rrëfyer si ishte të jetoje

mes kampeve e burgjeve komuniste në Shqipëri, tha se të paktën "na vjen mirë që atë që s'e ka bërë dhe s'po e bën dot politika moralisht dhe drejtësisia ligjërish, po e bën opinionin i shëndoshë, që për fat ende është, për aq sa ka mundur të gjejë hapësira mediatiqe, duke shpërthyer kundër kthimit të vegimeve horror e mashtrimit tradicional. Intelektualë, ish-të persekutuar, gazetarë, anonimë, shkrimtarë, grupime të tyre etj., edhe nga vende të tjera të botës, që nga Italia, Zvicra e në SHBA, gazeta 'Dielli', VOAL, PEN-i International etj., janë të indinjuar, madje të fyer".

Në fund të prononcimit të tij për "GSH", Zhiti tha se "po goditet e vërteta, qëndresa ndaj totalitarizmit barbar, morali, po nëpërkëmbet vuajtja njerëzore, shumëçka që meriton nderim. Të keqes i duhet prerë rruga, ndryshe ajo bëhet më e keqe dhe e qëndrueshme, sikënç dhe na ka ndodhur gjatë, shumë gjatë. Këtë duan të bëjnë ata, të dikurshmit e tanishëm, të tmerrshëm e fantazmagorikë".

REAGIMI


Ka pasur së fundmi edhe një reagim nga PEN-i shqiptar, që gjykon se sulmet ndaj shkrimtarit Visar Zhiti janë veprime të qëllimshme, akte kriminale, të cilat po përsëriten, sepse krimet e diktaturës komuniste në Shqipëri nuk u ndëshkuan asnjëherë. Entela Kasi, presidente e PEN Qendrës së Shqipërisë (PEN International, me seli në Londër) thotë se sot nuk është koha që të pyesim se si këto akte të qëllimshme, amoralë, kriminale gjejnë hapësirë në media të caktuara në shtypin shqiptar. "Kjo është pyetja që shtrohet sot nga shkrimtarët e huaj, nga elitat e mendimit botëror të 'PEN International' dhe jo vetëm. Persekutorët kanë dhe mbajnë detyra të larta në Shqipëri, sepse krimet e dik-

taturës komuniste në Shqipëri nuk u ndëshkuan asnjëherë!", shkruan presidentja e PEN-it shqiptar. Për të, kjo është një kamberë alarmi për klasën politike shqiptare, e cila pas rënies së Murit të Berlinit, ka dështuar duke veshur me pushtet dhe imunitet të gjithë ata individë, të cilët duhet të ishin jo vetëm jashtë jetës politike të vendit, por duhej të ishin përballur me akuzat për krimet, të cilat i kanë kryer në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit. "Kjo është e vërteta, të cilën e artikulojnë elitat e mendimit botëror të letërsisë në 'PEN International', lidhur me këtë çështje. Pyetja tjetër që shtrohet është: si ka mundësi që intelektualët, shkrimtarët dhe njerëz të medias në Shqipëri, lidhur me këtë çështje nuk kanë të njëjtin reagim për rastin e shkrimtarit Visar Zhiti? Kësaj pyetjeje, e cila na drejtohet të gjithëve në Qendrën PEN të Shqipërisë po i përgjigjem në statusin e drejtueses të PEN, Qendrës së Shqipërisë", nënvizon ajo. Në vijim, Kasi vëren se për aq kohë ata që shkruan atekspertiza kundër shkrimtarit Visar Zhiti në kohën e diktaturës komuniste në Shqipëri për denimin e shkrimtarit, sot i kemi në ekrane, në auditorë të promouar, të mbrojtur, të push-tësishëm, ky është tregues se persekutorët e djeshëm nuk mund të jenë garant për lirinë dhe demokracinë në Shqipëri e për më tepër të jenë misionarë të lirisë. Personalisht, si njeri dhe si drejtuese e PEN - Qendrës së Shqipërisë përulem me respektin më të thellë ndaj shkrimtarit shqiptar, Visar Zhiti. Sot shoqëria politike, institucionet e shtetit, shoqëria intelektuale, akademikët, shkrimtarët e njohur të vendit duhet të veprojnë në të ndaluar çdo akt e sulm ndaj shkrimtarit Visar Zhiti. Nëse ne lejojmë që të tilla ngjarje të përsëriten kështu siç vërtet po ndodh, nëse ne heshtim, ne të gjithë pa përjashtuar askënd, po pranojmë që të nëpërkëmbet, shkelet, cenohet çdo vlerë e dinjitetit njerëzor në Shqipëri!", thekson Entela Kasi në emër të PEN-it shqiptar.

E DIEL

21 Prill

2019



Stefan Taçi, Notre-Dame, pastel 2001

NGA MARCIN CZERMINJSKI*

"KOLONIA SHQIPTARE NË BORGIO ERIZZO TË ZARËS"

Disa kilometra mbas Zarës fil lonte fshati që, në të vërtetë, ishte një varg shtëpish të ndërtuara në të dyja anët e rrugës, në një distancë nga njëra-tjetra çerek milje tonën, ashtu siç më siguruan. Borgo Erizzo, siç quhet që nga themelimi i saj, fillimisht të lë përshtypje të mira: shtëpi të rregullta, me kopshte me lule dhe me perime; njerëz me pamje të bukur dhe të shëndetshëm dhe, nga sa mund të kuptosh nga veshja, jetojnë të kamur.

Sigurisht që vizitën e parë e bëra tek prifti i famullisë, që ishte Don Sime Toriçi, administratori i Arbanasit.

Ai më priti me mikpritje të mrekullueshme dhe menjëherë, si fillim, urdhëroi të më gostisnin me kafe, si pas zakonit shqiptar. Zonja e famullisë u zu ngushtë dhe tha: "Nuk ka mbetur asnjë

Shqiptarët "e panjohur" të Kroacisë në shekullin XIX

kokërr kafeje, sepse e gjitha u harxhua të dielën". Meqenëse ishte e premtë mbasdite mund ta kuptoja se, ndonëse jam në një fshat të kamur, tek famulltari nuk ka rezerva ushqimore, por ka varfëri. Duhet ta pranoj se kjo gjë më la përshtypje të mirë, sepse këtu varfëria është e pranishme, që e ka burimin nga mënyra dhe karakteri baritor i jetesës.

Duke u njohur për qëllimin e vizitës sime, prifti Toriç më shëtiti nëpër kishë dhe në të gjitha rrugicat e skutat e fshatit. Më njohu me shqiptarët më të shquar, ndërsa këta, duke parë se mbaja shënime, grumbulloheshin në numër të madh rreth meje dhe secili përpiqej të më jepte detaje të reja ose t'i sqaronte ato. Ato që grumbullova në vend, si dhe materialet e marra nga arkivi i guvernatorit të Zarës, po i paraqes këtu dhe ndoshta ato

mund të hedhin dritë në marrëdhëniet e këtushme të Republikës Venedike me shtetin kufitar Otoman.


Që nga koha e ardhjes dhe pushtimit turk të shteteve të sllavëve të jugut: Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe të Shqipërisë, Re-

publika Vendike vendosi raporte të ngushta me popullsinë e atjeshme katolike dhe, në një farë mënyre, ishte e ndërgjegjshme për rolin e saj, për përkujdesjen që duhet të tregonte ndaj tyre. Nëse këtë e bënte për interesat e saj apo për shkak të ndjenjave humanitare, do

ta shohim më poshtë; por është e sigurt se protektorati i Venedikut të fuqishëm ishte shumë në favor të popullsisë së shtypur, sepse nga fundi i shekullit XVII përndjekja e të krishterëve, veçanërisht në Shqipëri, kapërcu çdo kufi.

Familja e Sami Frashërit nuk i lejoj eshtrat e tij në Shqipëri

Lidhur me këtë do të themi vetëm dy gjera. Njëra nga këto është një ngjarje që ne nuk e dim. Qeveria shqiptare, e cila ndodhej në atë kohë në pushtet, kur doli diskutimi mbi të se " ishte shqiptar", apo " nuk ishte shqiptar", duke iu drejtuar zyrtarisht familjes së Samiut, ka kërkuar për t'i sjelle në Shqipëri eshtrat e dijetarit të madh, duke i bere të gjitha ceremonitë dhe ta varrosnin në Tiranë. Mirëpo familja e Samiut, kësaj dëshire të Qeverisë Shqiptare i ka dhënë këtë përgjigje: Ai është pasuri e kësaj toke, dhe do të prehet në këtë tokë".



Në këtë numër: MARCIN CZERMINJSKI, HIKMET FERIUN ES DHE KUJTIM NURO, SUL GRAGJEVI, DEMIR GJERGJI ETJ...

A

ARGUMENT

Një prift polak, Marcin Czerminjski, (Marçin Çerminjski), në kuadër të vizitave të tij misionare kishtarë katolike që bëri në Ballkan, në vitin 1892 vizitoi edhe Shqipërinë dhe Dalmacinë, territor ky që sot bën pjesë në Kroaci. Duke lëvizur në rrugët e Zarës, që në atë kohë ishte kryeqytet i Dalmacisë, nga fytyrat ai dalloj se në atë qytet banonin shumë shqiptarë. Kjo tërhoqi vëmendjen e tij dhe për këtë u angazhua të përcaktonte origjinën e tyre, shkruan studiuesi i njohur, Leonard Zissi, që e ka përgatitur shkrimin...

Prifti polak rrëfen koloninë shqiptare në Zarë të Kroacisë, në shekullin XIX

NGA MARCIN CZERMINJSKI*

Vijon nga faqja 13

Duke parë shpeshherë fytyrat e shqiptarëve nëpër rrugët e Zarës, pyesja veten: nga kanë ardhur ata? Çfarë bëjnë ata këtu?

Përgjigjen e gjeta dhe ajo ishte: "Këtu ata kanë koloninë e tyre, e cila qeveriset sipas rregullave të saj". Meqenëse në atë kohë grumbulloja materiale për një punim të gjerë për Shqipërinë, mua më intereso shumë ky lajm, prandaj vendosa t'i vizitoja dhe t'i njihja nga afër këta emigrantë. Një i njohuri im dalmat, që njihte marrëdhëniet e kësaj kolonie, m'u afrua për të më shoqëruar, prandaj pa mëdyshje, ditën e parë që e pata të lirë, bëra një shëtitje të këndshme tek kjo koloni shqiptare.

Nëpërmjet portës së njohur "Di Terra Ferma", rruga të çonte tek një xhade në gjendje të mirë, anash e mbjellë me pemë dhe që kalonte buzë detit. Gjatë gjithë gjatësisë së saj shihja pamje të mrekullueshme të Alpeve Dinarike.

Të mbështetur disa herë nga ushtritë e Republikës së Venedikut, të pafatët u përpoqën të shpëtonin nga thundra osmane, por përpiqjet e tyre shkollonin dëm dhe të mundurit detyroheshin ose të braktisnin atdheun, ose të mohonin besimin. Pjesa më e madhe e popullsisë zgjodhi alternativën e parë dhe, që nga ajo kohë, filluan emigrimet në drejtime të ndryshme, për në Sicili, në Italinë e Jugut, në Istria, Dalmaci, Kotorr, Mal të Zi.

Republika e Venedikut i hapj kufijtë e saj për këta njerëz të varfër me shumë dëshirë, ndonëse ishte kundër dhe pengonte emigrimin e tyre për në shtete të tjerë, madje edhe në ato italiane, si p.sh. në Mbretërinë e Napolit. Kjo ishte një politikë shumë e justifikuar, po të marrim parasysh veprimet çnjerëzore të Perandorisë Osmane dhe bindjen e atëherëshme të saj se fuqia e shtetit varet vetëm nga numuri i të nështruarve. Me këtë shpjegohet fakti që, në gushtin e vitit 1726, rreth 20 familje shqiptare mbërritën në Zarë, me lutjen për t'u pranuar në komunë, ndërsa administratori i përgjithshëm Nicolo Erizzo II urdhëroi menjëherë vendosjen e emigrantëve në afërsi të qytetit.

Nga dokumentet e arkivit të guvernatorit të Zarës, rezulton se ata ishin njerëz me të vërtetë përndjekur që, për shkak të besimit dhe me vullnet të lirë kishin hequr dorë nga gjithë pasuria dhe prona e tyre, me qëllim që të garan-

tonin për vete dhe trashëgimtarët e tyre thesarin më të çmuar, atë të besimit fetar. Nga ana tjetër, qeveria venedikase, duke mos fshehur asgjë, deklaronte se ata i pranonte në kufijtë e saj, sepse dëshironte të shtonte popullsinë e vet, si dhe të ardhurat nga pronësia e tokës, e cila deri në atë kohë shfrytëzohej pak ose aspak, për shkak të mungesës së fuqisë punëtore. [Shih arkivin e guvernatorit të Zarës me titull: "Nicolo Erizzo", vëll. I, faqe 158.]

Për Nicolo Erizzon nuk ka qenë e vështirë të nxirrte një urdhëresë për vendosjen e shqiptarëve të ardhur pranë Zarës, por ishte vështirë të realizohej ajo, për shkak të mungesës së tokës në



afërsi të qytetit për t'ua shpërndarë atyre. Këtë gjë e administroi prifti Jan G. Grisogono, i cili dhuroi për këtë qëllim pronën e tij private, që shtrihej disa kilometra larg Zarës. Atje u ndërtuan banesat për shqiptarët me shpenzimet e qeverisë, të tilla që i shohim edhe sot, që janë të pajisura me sendet e domosdoshme shtëpiake për veprimtarinë ekonomike të tyre.

Duke vlerësuar meritën e madhe dhe fisnikërinë e jashtëzakonshme të priftit Grisogono, publike që shtriheshin më larg, duke i zgjedhur vetë ai. Fatqësisht, ky premtim mbeti vetëm në letër dhe nuk u realizua asnjëherë, madje edhe atëherë kur familja e tij e falimentuar iu lut për këtë Senatit të Venedikut në vitin 1778. Krahas themelimit të kolonisë në Borgo Erizzo dhe degës së saj në Zemoniko, shqiptarëve iu dha një status i veçantë, në përshatje me karakterin dhe traditat e tyre.

Konkretisht, ata kishin të drejtën e zgjedhjes së kreut të kolonisë, i cili duhej miratuar nga Administratori i Përgjithshëm i Zarës. Pushteti i tij varej nga "për-



sigurimit të kësaj prone për shtetin e tij, duke dashur të lidhë me një të forta koloninë me Republikën e Venedikut, e liri atë për një farë kohe nga taksat dhe detyrimet e tjera, me qëllim që ata të krijonin një ekonomi të shëndoshë për një kohë të shkurtër dhe të arrinin madje një gjendje pasurie të tillë, ashtu siç e kishin patur edhe në atdheun e tyre.

Disa vite më vonë, në gjurmët e këtyre emigrantëve, disa dhjetra familje të tjera shqiptare u larguan nga Perandoria Osmane dhe u strehuan nën krahët e përkujdesjes së Venedikut. Administratori i atëherëshëm, Petro Vendramini, i pranoi me dëshirë dhe i sistemoi, ashtu siç

Për shqiptarët e Zarës

Mbasi studioi dokumentet në arkivat e Zarës, si dhe bisedat që zhvilloi me përfaqësuesit e organeve vendore të Zarës dhe me shqiptarë nga kolonia e këtij qyteti, studimin që bëri për këtë koloni, në vitin 1896, e botoi në librin "Në Dalmaci dhe në Malin e Zi", me titullin e mëposhtëm, të cilin po e botojmë të përkthyer në shqip. Pa dyshim që ky studim është nga më të hershit që janë botuar për historikun e kësaj kolonie në Zarë dhe që mbështetet në burime arkivore.

faqësuesit", që duhej t'u bindej në çdo rrethanë që kishte të bënte me shërbimet publike. Kreu i kolonisë duhej të zbatonte të gjitha urdhëresat e pushtetit qendror ushtarak, të kujdesej për ruajtjen e rendit në koloni, ta përfaqësonte atë në bisedimet e ndryshme me fqinjët dhe, së fundi, të zgjidhte çdo vit gjyqtarët nga gjiri i shqiptarëve. Menjëherë pas shpalljes së këtij statusi, ata bënë zgjedhjen e kreut, që ka qenë Lluca Andriçi, i biri i Andreas, por pa mbiemër sepse, ashtu si edhe deri më sot, popullsia shqiptare zakonisht nuk përdor asnjë mbiemër, por djali i shton emrit të vet emrin e të atit dhe ky mjafton si mbiemër familjar.

Nicolo Erizzo, i kënaqur prej

ishin sistemuar edhe paraardhësit e Erizzos.

Ende pa mbaruar sistemin e plotë i këtyre familjeve, administratori i jashtëzakonshëm i Venedikut, Emo, që banonte në Kotorr; njoftoi administratorin e Zarës, Grimantin, se një karvan i ri prej 150 shqiptarësh kërkonte t'u bashkëngitej atyre që ishin vendosur në Borgo Erizzo. Për Grimantin, ky ishte një lajm i mirë, sepse këtë herë u ruhej telasheve të mëdha e të rrezikshme që mund të kishte prej një numuri kaq të madh të nënshtruarish nën osmanët. Këta emigrantë ishin arratisur për shkak të përndjekjes prej dy vëllezërve Omer, pashallarë të Tivarit, prandaj meritonin mëshirë. Nga ana tjetër, Trak-

tati i Paqes midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane parashikonte shkëmbimin e ndërsjellë të të arratisurve, madje në rast nevojë, edhe nëpërmjet përdorimit të forcës ushtarake. Numuri i madh i të arratisurve nga Perandoria Osmane dhe të atyre që ishin strehuar në tokat e Dalmacisë nuk ishte i mundur të mbahej në fshehtësi ndaj Potës së Lartë, gjë që do të rrezikonte fillimin e luftës për shkak të shkeljes së Traktatit. Kështu që Grimani u ndodh midis dy zjarreve.

Përballë kësaj alternative, ky italian i zgjuar mundi të gjente një variant të tretë për të dalë nga kjo situatë. Ai urdhëroi Emon, administratorin e jashtëzakonshëm të Kotorrit që të bisedonte privatisht me emigrantët shqiptarë që të ktheheshin dhe, në rast se nuk do t'ia arrinte kësaj, atyre do t'ua lehtësonte arratisjen në treva të tjera sa më të largëta në veri të Dalmacisë. Njëkohësisht ai dërgoi në Shkodër një agjent që të mësonte qëndrimin që mbante pashai për këtë çështje. Dhe ky informacion mbërriti shpejt në Zarë.

Sipas mendimit të osmanëve, shqiptarët ishin arratisur përpara përndjekjeve të Ahmet Omer Pashës, të cilin kohët e fundit e kishin larguar nga posti. Pasardhësi i tij, Kurt Pasha, e dinte mirë se çfarë duhet të bënte dhe, për llogari të xhepit të vet, dëshironte të zinte peshq në ujëra të turbullta. Prandaj, qëllimisht këtë çështje e bëri të bujshme dhe kërcënoi se do të ankohej në Konstandinopojë në rast se Venediku nuk do të jepte shpërblime të majme. Agjenti i Grimanit, Bucchi, njeri me shumë fantazi, afroi pranë vetes, Sulejman Agën, person ky me influencë të madhe dhe të rëndësishme në Shkodër. Ky i deklaroi dhe bindi Kurt Pashën se shqiptarët qenë arratisur vetëm për shkak të përndjekjes prej paraardhësit të tij dhe se me të padrejtë ngarkohej me përgjegjësi Republika e Venedikut.

Ndërmjetësimi i Sulejmanit pati sukses në sajë të këmbënguljes dhe guximit të tij. Kurt Pasha hoqi dorë nga pretendimet e veta dhe as nuk i njoftoi për këtë çështje organet qendrore të Perandorisë. Ahmet Omer Pasha ishte kundërshtar personal i Sulejman Agës, pra edhe hapin miqësor ndaj Republikës së Venedikut në të vërtetë e bëri nga dëshira e hakmarrjes ndaj të vetëve për shkak të shkarkimit të tij, sesa për mirësi ndaj Venedikut. Megjithatë, Sulejman dëshironte të përfitonte një çmim nga rasti i mirë që i erdhi në dorë.

O

OPINION

NGA BEN ANDONI

Përvitësh dhe sidomos pas takimeve të përbashkëta të ekzekutiveve të Shqipëri-Kosovë, drejtuesit e ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë kanë përcjellë dosje të përbashkëta, ku parashikohet protokollin e marrëveshjeve me aktivitetet të shumta. Kështu ka qenë edhe së fundmi, ku ministri respektivë të kulturës në Shqipëri dhe Kosovë kanë përcjellë protokollin e marrëveshjes për kalendarin e përbashkët. Po a ka ndonjë impact real ky kalendar dhe a janë të interesuar shqiptarët për kosovarët dhe anasjelltë? Përveç një grupi të limituar njerëzish që merren me artin në të dyja anët e kufirit, shqiptarët dhe kosovarët janë indiferentë për njëri-tjetrin dhe kulturën që përcjellin. Këtë e shton zbehja e punës së medias andej dhe këndej kufirit, por më shumë akoma: Pasja e një lloj shemrie, që individë jo të pakët mundohen ta mbajnë dhe ta promovojnë për të mos u realizuar tregu i përbashkët.

Pengesa e parë mbetet gjuha e bashkëpunimit por mund të shtohen edhe elementë të tjerë. Ka gjithnjë e më shumë personazhe të cilët mundohen t'i errësojnë kontributet e mëdha që janë bërë në të dy anët e kufirit për identifikime të njëjta, ka

Pengesa e parë mbetet gjuha e bashkëpunimit, por mund të shtohen edhe elementë të tjerë. Ka gjithnjë e më shumë personazhe, të cilët mundohen të errësojnë kontributet e mëdha që janë bërë në të dyja anët e kufirit për identifikime të njëjta, ka kinse kompetentë që pretendojnë se Shqipëria është munduar të Kosovës dhe jo pak që përflasin njerëzit e Kosovës në Shqipëri.

Pse Kosova dhe Shqipëria nuk krijojnë dot një treg të përbashkët?!



kinse kompetentë që pretendojnë se Shqipëria është munduar të errësojë historinë e Kosovës dhe jo pak që përflasin njerëzit e Kosovës në Shqipëri. Trashëgimia e madhe e vlerave të njëjta, përcjella e përpjekjes së mbijetesës pothuajë errësohen, kurse sot duket se premtimet e Shqipërisë dhe Kosovës sa i përket bashkëpunimit kulturor mbeten vetëm në letra. Ankesa të artistëve janë të pafundme, por sistemet e ndryshme të organizimit janë nga pengesat kryesore, që u shtohen njëkohësisht edhe mu-

ngesa e predispozitës për të gjetur kontakte dhe kuptohet fondet. Drejtori i Galerisë së Arteve në Tiranë, një artist i njohur kosovar, e ka shtuar sikletin me sjelljen aspak të mirë ndaj artistëve shqiptarë, kurse thënie nga Kosova se Shqipëria nuk mund ta trajtojë si provincë Kosovën vërtet mund të artikulohej nga pak njerëz, por në thelb përbëjnë një lloj mentaliteti, që mbart gjithnjë e më shumë një grup njerëzish në Kosovë.

Shqipëria e viteve të fundit është treguar shumë e hapur me Kos-

Shqipëria me Kosovën

Shqipëria e viteve të fundit është treguar shumë e hapur me Kosovën dhe po ashtu edhe Kosova për Shqipërinë në muajt e vitet e para të çlirimit nga pushtuesit serbë. Pas kësaj, marrëdhënia ka ardhur duke u ftohur dhe për të gjykuar më shumë për këtë do të duhej puna e psikologëve dhe sociologëve. Megjithatë, ka një gjë e cila lidhet me ato nënshtrës perceptimesh, që aktorët të ndryshëm i vënë në zbatim sa herë duhet të minohet kjo lidhje. Sot politikanët bëjnë gati të prekshme shumë realitete, por në të vërtetë Shqipëria dhe Kosova janë fare larg ose me aktivitetet periferike, që paqka madhësisë që besohet se u jepet, nuk kanë ndonjë impact të madh në areale kulturore të këtyre vendeve.

ovën dhe po ashtu edhe Kosova në muajt dhe vitet e para të çlirimit nga pushtuesit serbë. Pas kësaj, marrëdhënia ka ardhur duke u ftohur dhe për të gjykuar më shumë për këtë do të duhej puna e psikologëve dhe sociologëve. Megjithatë, ka një gjë e cila lidhet me ato nënshtrës perceptimesh që aktorët të ndryshëm i vënë në zbatim sa herë duhet të minohet kjo lidhje. Sot politikanët bëjnë gati të prekshme shumë realitete, por në të vërtetë është se Shqipëria dhe Kosova janë fare larg ose me aktivitetet periferike, që paqka madhësisë që besohet se u jepet nuk kanë ndonjë impact të madh. Kjo të shkon ndërmend kur së fundmi dy ministrat respektivë të

Kulturës, të Shqipërisë e Kosovës, Elva Margariti e Kujtim Gashi, mes temave të shumta të diskutuara në Tiranë, hodhën idenë e krijimit të një fondi të përbashkët për të mbështetur financiarisht edhe aktivitetet e skenës së pavarur artistike, të cilat mbushin një pjesë të mirë të jetës kulturore në hapësirat shqiptare, këtej e andej kufirit, por që nuk kanë impact, sepse vazhdimisht kur vjen puna të realizohen ngrihen barrierat. E megjithatë zryrtar vazhdojnë të firmojnë kontrata dhe marrëveshje, që kanë fare pak impact...dhe mbi të gjitha njohje.

(Milosao)

Për këtë qëllim, agjentit të Venedikut Bucciti, i këoi se dëshironte të kishte një orë, "sigurisht duke e paguar atë". Administratori Grimani, duke njoftuar për këtë kërkesë, që është e vërteta ishte një kërkesë modeste e Sulejmanit, i dërgoi atë që dëshironte, "sigurisht, pa interes". Në këtë mënyrë, çështja e 150 shqiptarëve, që kërcënonte me luftë, u zgjidh në mënyrë paqësore. vetëm me njëorë xhepi. [shih arkivin e Gubernatorit të Zarës, Grimani Zorzi, vëll.VI, faqe 310 dhe "Grimani Zorzi dispacci, vëll.VI, faqe 83 dhe 84. (Pronë e bibliotekës së gjimnazit në Zarë.)]

Në vitin 1773, numri i gjithë emigrantëve në Borgo Erizzo ka qenë rreth 344 vetë, së bashku me disa persona të tjerë të ardhur, pa llogaritur këtu banorët në Zemoniko. Ky numër në përgjithësi është i lartë, ndërsa gjendja e tyre ekonomike ishte gjithësesi e mirë, sidomos e atyre që merreshin me bujqësi. Për këtë arsye, ata filluan të mendonin që të kenë edhe famullinë e tyre. Kryepeshkopi Zmajević, si për t'u bërë një privilegj, pranoi dëshirat e tyre, se më parë ata i përkisnin dioqezës së Tivari. Prandaj këtë dëshirë të tyre e parashitri dhe e përkrahur në Senatun Venedikas. Qeveria e Venedikut dha pa asnjë vështirësi një donacion për famullitarin, ndërsa kryepeshkopi zgjodhi për t'u shërbyer besimtarëve një nga priftërin-

jtë që njihte gjuhën dhe zakonet shqiptare.

TIPA SHQIPTARËSË NGA RRETHINAT E ZARËS

Famullitarët e rinj filluan ndërtimin e kishës me energji të jashtëzakonshme, me një konstruksion shumë të thjeshtë, por me bazmante të forta dhe me gurë të gdhendur. Anash ndodhë dhoma për vendosjen e sendeve të priftërinjëve në kishë, si dhe banesa e famullitarit. Kisha që u quajt "Nëna Perëndesha Loretane" u ndërtua me një shpejtësi të tillë, sa që përfundoi që në vitin pasardhës, më 1734, gjë që është shënuar edhe në tabelën përkujtimore të vendosur në murin e saj.

Afërsia me qytetin dhe rritja e shpejtë e popullsisë në Borgo Erizzo detyruan banorët e tij për të kërkuar të ardhura të tjera nga zejtaria dhe tregtia, sepse toka që dispononin nuk mjaftonte për të

jetuar. Menjëherë ata filluan të punonin si muratorë në qytet, pastaj u pëlqeu të merreshin me tregti dhe, se sa të zotë ishin shqiptarët në këto zanate, mjafton të hedhësh një sy përqark.

Kur në Zarë shpërtheu një epidemi, Administratori i Përgjithshëm, Pietro Mikeli, urdhëroi që në Borgo Erizzo të vendoseshin të ashtuquajturët "stacione". Këto ishin vende të izoluara nga karantina për banorët që vinin nga rrethinat me mallra për t'i shitur në qytet. Ardha e fshatarëve që në numur ishin shumë të madh, por meqenëse të gjithë ishin të detyruar të prisnin për një kohë të gjatë, atëherë shqiptarët ngritën bujtina për të shitur verë, që lehtësuan shitjen e mallrave, zgjidhjen e interesave të tyre dhe çështje të tjera. Ata vendosën aty edhe një mjek popullor; njohës i sëmundjeve epidemike, i cili vazhdoi të qëndronte aty për një kohë të gjatë. Si rrjed-

hojë e këtyre, Borgo Erizzo filloi të pasurohej, madje edhe në dëm të vetë qytetit të tyre dhe të bujqëve fqinjë.

Ndërkohë pati edhe disa acarime por, në fund të fundit, deri në ditët e sotme kolonët kanë privilegjet e tyre në disa zanate ose artizanate. Pothuajse janë në duarte tyre zanatet e muratorëve dhe mbi të gjitha të kasapëve, ndërsa tek femtarët thurra me xunkth e shisheve, si dhe prodhimi i likerit të famshëm dalmat i quajtur "Maraskin". Disa prej tyre zhvillojnë tregti në shkallë të gjërë me Italinë dhe Francën me gjedh dhe derra, me lëkurra, drithëra e mallra të tjerë, por asnjëherë nuk merren me tregtinë e peshkut. Kjo sepse, deri në ditët e sotme, malësorin shqiptar deti nuk e josh, ndonëse më se prej dy shekujve banojnë pranë tij, por deri tani e kanë ruajtur antipatinë e mëparshme që kanë për të.

Megjithë vështirësitë e shumta etnografike dhe materiale, shqiptarët flasin mirë dhe e përdorin gjuhën e tyre amtare pothuajse si të vetmin mjet komunikimi midis tyre. Ata që banojnë afër kishës dhe, si të thuash, në qendër të fshatit, në përgjithësi ruajnë më mirë zakonet e mëparshme shqiptare sesa të vobektit që jetojnë diku më larg. Kohë më parë, edhe këtu ka vepruar hakmarrja, ndërsa sot këtë fenomen e njohin si të përmendur nga historia, sepse qeveria us-

triake ka nën kontroll rregullin dhe nuk lejonin aventurat e përgjakshme. Ceremonitë e varrimit, ashtu si edhe tek shqiptarët që janë nën sundimin osman, edhe këtu ndiqen po njësoj, megjithëse në një shkallë më të reduktuar.

Famullitari i atjeshëm më tregoi se aktualisht, ndër 2000 besimtarëve të famullisë së tij, vetëm katër familje ruajnë me rigorozitet të madh të gjitha traditat, ndërsa tek të tjerët, për sa i përket kësaj përqasjeje, ato janë zvenitur. Por në çdo rast, mesha për Shën Nikollën këtu bëhet njëllor si në Shqipëri, ku ftojnë famullitarin për drekë ose darkë dhe ai duhet të bëjë lutjet për të afërmit e personit të vdekur të familjes. Me këtë rast lidhen edhe "vëllamet" midis tyre, ndërsa pas Meshës së Shenjtë që kryhet para altarit, kandidatët pijnë një gotë verë, por pa gjak, siç ndodh në Shqipëri. Kështu, prej kësaj dite midis tyre krijohet një lidhje me detyrim të ndërsjellta, madje sikur të ishin prej një gjaku, të cilën vetëm vdekja mund ta ndajë.

Me një ndjenjë të lartë u ndava prej pasardhësve të shqiptarëve martirë, për të cilët famullitari inderuar Don Sime ruante për ta kujtimit të përzemërta. Pra, edhe këto fjalë që unë kam shkruar, le të dëshmojnë për simpatinë dhe kujtimin tim për ta".

*Përgatiti: Leonard Zissi

P

PERSONAZH

Të shtatë fëmijët shtypnin me radhë gjunjët e Samiut. Edhe vdekja iu bind rregullit: ka lindur në 4 qershor dhe ndërroi jetë po në 4 qershor. Numri 4 kishte një rol të çuditshëm në jetën e tij...

Familja e Sami Frashërit nuk donte që eshtrat e tij të vinin në Shqipëri

NGA HIKMET FERIJONES
DHE KUJTIM NURU

Vijon

A nija po afrohej për në skelen e Caddë Bostanit. Udhëtaret po dilnin. Në mes të shume per sonave, ishe i afte te dalloje Samiun, sepse gjatesia e tij ishte 184 cm. Në mes te udhëtareve, ishe ne gjendje te dalloje nga kokat e tyre, mjekrën e tij të bardhë. Ishte i dobët, në atë shkallë që do të habiste përkundrejt qafës. Ishte shpatull ngushte. Menyra e punes dhe e jetesës se tij po rriste krejtësisht shëndetlgesine e tij. Ndonjëhere ate, me cfare do lloj menyre mund ta nxirrnin nga dhoma për te marre rreze dielli, sepse qëndronte i mbyllur me dite te tera. Përpara shtepise ishte një bahce e jashtezakonshme, plotesisht 20 dynyme. Mirepo, Samiu ne kete bahce 20 dynymsh, ne gjithë jeten etij, neqoftese oret shtohen me njëra-tjetren , kohen që ka kaluar ketu, ndofta nuk mund te kapnin as 20 ore. Ne bahce, te kapte syri peme qërshije. Dhe te gjitha ishin qërshi te bukura. Me te ardhur koha e tyre, Samiu do te dilte ne bahce, vetem për t'i shartuar ato me doren e tij. Mirepo edhe kjo është mjaft e rralle. Ne kohen që bente kete pune thoshte: -Për njerëzit, ushqimi i kokes nuk është vetem për shijen e kokes, është e domosdoshme dhe shija e gojes. Une po përgatis shijen e gojes se femijeve. Por femijet nuk i hanin keto qershi. Ato, i hante vetem Fehmi Pasha. Duke kaluar vitet, shendetlgesia e tij kishte marre një gjendje te padrueshme. Edhe pse kishte mjeke brenda familjes se tij, ai nuk i kishite dhene shendet aspak rendesi deri ne ate kohe. Shtatiku po i shkaktonte shume dhimbje. Filloi inxheksionet. Nderkohe femijet kishin një detyre te rendesishme. Me ore te tera, vinin rregullisht me rradhe , një nga një me duart e tyre te holla dhe te medha i benin masazh kembeve dhe duarve te tij, te cillat i dhimbnin aq shume dijetarit te madh te gjuhes. Me te mbaruar rradha e një femije, i vinte rradha tjetrit. Me ne fund shendetlgesia e tij, beri ate që parashikohej, bile dhe nga Pallati Mbreteror i thane: "Sami bej, tashme ne Pallat ju nuk do te vini. Shkrime nuk do te shkruani. Rroga juaj do te dergohet ne shtepi". A ishte kjo e pranueshme për Samiun? Nga shtepia nuk po dilte, por kishte filluar pune shume te rendesishme. Po bente kerkime lidhur me burimet baze te Turqishites. Po lexonte mbishkrimet e mon-



umenteve te Orhunit dhe bente me një rregullsi te madhe mbledhjet e njohura te dites se Merkure. Mbledhjet e se Merkures, dijetari i bente me shoket, i cili i donte shume.

NJE RASTESI QE NUK MUND TE BESOHET

Një nga cilesite, vetite me te medha te Samiut, padyshim, ishte dhe rregulli i tij. Psh: Ai nuk e imagjiononte ta shihte letrën e rrudhosur. Ai e merrte ate dhe me gish-tat e tij te gjate dhe te holle e rregullonte me aq kujdes, sa do te habiteshe. I hiqte asaj te gjitha rrudhat. Madheshtia e rregullit kishte krijuar disa rastesi te cuditshme ne jeten e dijetarit, nga që e dinte gjendjen e tij, aq sa nuk do te mund besohej. Psh: Ai ka lindur me 4 Qershor 1850 . Me 4 Qershor te vitit 1854 mbushi 54 vjec dhe ne dite e pare te lindjes se tij, ndërroi jete. Madheshtia e rregullit, edhe ne vdekje, u krye sipas rregullit te tij. Përseri kjo si rastesi e cuditshme, e cila duhet pranuar. Numrat që mbaronin me 4, kane luajtur një rol te madh ne jeten e Samiut. Kishte lindur me 4 Qershor. Kishte marre diplomën nga shkolla me 14 Maj. Nderroi jete ne moshen 54 vjecare, ne vitin 1904. Bile, dhe ne kohen që ishte vetem, i pamartuar, nuk mund te duronte një jete te parregullt dhe pa pune ne te gjitha aspektet. Ai nuk ka mundur te jetonte ne hotel eshte ne shtepi pensioni. Përreth rajonit te Fatihut, ai kishte zgjedhur një shtepi dhe mbante një puntor te mire. Jeten e tij e kishte futur ne një rregull te pafundm. Kete rregull e kishte mbajtur, edhe kur ishte i internu-

ar ne Tripoli. Megjithese dilte mjaft rralle ne rruge, vazhdimisht mban-te një bllok me përmasa te vogla. Me t'i ardhur dicka ndermend, menjehere fillonte ta shkruante ne kete bllok. Për kete, ai kishte disa blloqe te vegjel. (Ne Arkivin Qëndror te Shtetit, keto shenime mungojne ne fondin e tij arkivor. K.N.) Ne kohen që ndërroi jete, Ahmet Xhevdeti, cili shtypi veprat e tij, ne kohen që po bisedonte për rregullin e tij, kishte një leter për 20 doreshkrimet. Përseriste gjithmone: Asnjë fjale e tepërt, asnjë fjale mangut. Shkrimet e tij nuk i lexonte dhe korrigjonte dhe njëhere. Ahmet Xhevdeti tregon se Samiu se ne një pjese kishte shkruar 40 vjet me pare autobiografine e tij me boje te zeze. Mirepo ne te njëjten faqe, une pashe që kishte përdorur tre bojra te ndryshme: te zeze, te kuqe dhe blu.

KISHTE TRI EMRA

Pothuajse, nga që nuk kishte mbiemra ne ate kohe, Samiu do te behet nervoz lidhur me ngatërrimin e emrave ndaj njëri-tjetrit. Dhe për kete, te gjithë ishin partizane ne përdorimin e tre emrave. Bile, aq me tepër: kjo kerkonte mosngatërrimin e një emri te njohur si Samiu. Ne fakt, për shkak te fames se gjere ne ate kohe, shume Shemseddine kishin marre dhe emrin Sami. Kurse disa me emrin Sami, një nga një ne anen kryesore te emrave te tyre kishin vendosur Shemseddin Sami. Përkundrejt kësaj, Samiu, i cili ishte përkrahës i mendimeve europiane për emrat dhe mbiemrat, firmoste keshtu: Ebu Ali Shemseddin Sami. Dhe djemve dhe vajzave te tij u kish-

te vendosur secilit prej tyre tre emra. Psh: Emri original i Ali Samiut ishte Saddedin Ali Sami. Kurse emri i femijes tjetre ishte: Sulejman Nexhmeddin Sami. Ne familje secili kishte tre emra.

SECILI TE HIPTTE NE MAKINE TE VEÇANTE

Sami Frasheri ishte përkrahës i reformimit, i ndryshimit, i transformimit ne shkalle te gjere te cdo gjeje. Disa gjera, që ndodhin ne ate periudhe, do ta benin ate te shqëtesohej shume. Psh: Kishin ardhur nga fshati dhe kishin zbritur ne Stamboll. Kishin dale tek Kopruja (Ura-K. N.) Ketu Samiu kishte pyetur: A nuk ka një makine ku te hipte Samiu dhe ne një makine tjetër bashkeshortja e tij. Ja kjo ishte një nga gjerat që i shqëtesonte aq shume Samiun. Ne ate kohe, burre-grua shkonin se bashku tek fotografi për te bere fotografi. Nuk ishte një nga gjerat që i vinte ndermend cdo kujt për te bere fotografi. Mirepo, Samiu nga ketu e 60 vjet, bile akoma shume kohe përpara, kishte bere fotografi me bashkeshorten e tij tek fotografi. (Ne pjesen e pare te shkrimit gazetari Hikmet Feridun Es e ka botuar kete fotografi. K.N.) Ai kishte një dashuri te verber për te gjitha llojet e ndryshimeve. Ne kohen që vishte jaken e kollarisur thoshte: Cfare torture! Neqoftese gruaja vesh fustan, akoma me mire.

NJE GDHENDES I MIRE

Samiu, ne kohen që ishte i lodhur nga shkrimet, merrte rripa druri. Fillonte t'iu jepte atyre forma te ndryshme dhe aty gdhendte

shkrime te ndryshme. Ai ishte një gdhendes shume i mire. Samiu, 50 prej titujve te librave i ka gdhendur me doren e tij. Edhe modelet e makines se daktilografimit, që ai do te bente, i ka gdhendur.

Fjala e fundit që Samiu tha kur ndërroi jete. Qeveria shqiptare ka kerkuar eshtrat e Samit, përse eshtrat e Samiut nuk u derguan. Femije, që ne moshen 8 vjec me callme te madhe. Punet që nuk mundi t'i beje:

a) Revista "Toka dhe Qielli",
b) Shtetitjet ne vendet e targeta. Kurioziteti ndaj Astronomise. Neqoftese do te kishte jetuar me gjate. Me lexoni Graziellen. Lotet që mbushen Samiun. Ne varrin e tij nuk ka një gur. (Është fjala përpara vitit 1944- 194, kur Samije Erer ka dhene intervisten K.N.)

Pikpamja e Samiut lidhur me besimin fetar për ate, ishte plotesisht e vecante. Megjithese ishte një mik mjaft i mire i dijetareve me te njohur te Lindjes, ai do te ndahej nga ata nga pikpamja e besimit ne shkallen me te fundit. Psh: Te afermit nuk e kishin pare kurte ate te lutej dhe te agjeronte. Vajza e tij thote që ai ishte "Volterian". Bile eshe pse ishte mikmu me i singërte i tyre, ai bente shaka fort me imamet. E kishite pranuar fene për vehten e tij, vetem për miresi dhe drejtesi. Nuk besonte tek ajo që kishte ngelur mbrapa. Megjithate, ne kohen që ai ishte ne moshen 8-10 vjecare, është pare te shtetise me një tallagan mbi shpinen e tij dhe ne koke me një callme te madhe. Sidomos, ai krijonte një dallge te habitshme për lagjet me popullsi greke, kur një femije ne moshen 8-vjecare kalonte ne mes tyre me një callme te madhe ne koke dhe një tallagan ne shpine. Mirepo nuk kishte asnjë lidhje e callmes me besimin fetar. Nga veshja e tij e tallaganit dhe vendosja ne koke e callmes se madhe, kishte vetem një qëllim. Dijetaret, te diturit, te cilet ndodheshin ne vend(Perandoria Osmane-K.N) ne ate kohe, visheshin te gjithë ne kete menyre. Tallagani me callme ishte uniforma e dijetarit. Dhe "se-mundnja" shkencore tek Samiu i vogel, kishte ardhur ne një faze aq te zjarrte që te gjithë femijet ishin te etur për gjere te ndryshme. Ne kohen që femijet vishnin rroba kapiteni me bilbil ne xhep, ai, vetem për tu pare dhe për tu ndjere se i kishte hyre shkences, vishej me kete veshje ne ate moshë. Një callme, që nuk kishte asnjë lidhje me besimin fetar. Ne te gjithë jeten e tij, kishte qëndruar vetem si një njëri i mire, i drejte, i

ndershem. Përveç shkences objektive dhe që ishte fetar në vehten e tij, fjala e fundit e Samiut në nderimin e jetes ka qëne "Allah". Se bashku me ate që nuk ka qëne i lidhur me fene, besonte me force në vazhdimin e frymes.

QELLIMET, TE CILAT NUK MUNDI T'I REALIZONTE

Samiu, i cili nderroi jete në moshe që mund te thuhet mjaft i ri për një shkencetar, ka patur disa gjera , ideale , mendime që ka dashur te beje. Ai deshironte te bente disa botime për te nxjerre librat e tij, te cilet arrinin deri ne 100. Psh: për te nxjerre një reviste me emrin "Toka dhe Qielli". Dhe për ketete bisedonte vetem për Astronominë. Natyrisht, ai fliste për shkencen, kafshet, por ne krye te temave, ceshtjeve, i cili kishte shqëtesim, ishte Astronomia. Kishte sjelle te gjitha veprat e Kamil Flamortyonit. Bile, ai kishte menduar formen e revistes dhe marre vendimin për ta nxjerre ate njëhere ne muaj. Samiu e donte shume emrin: "Toka dhe Qielli", ku do te gjente shume te përmbledhur emrin e revistes. Ne fakt, është bere dhe një botim i vecante me emrin "Toka dhe Qielli". Dhe një nga idealet e tij ishte te te mbështeste me ketete reviste punimet shkencore. Ne fakt, ai kerkonte cdo gje për shkencen. Sidomos ne jeten e tij, miqte, te cilet vinin nga vendet me te largeta, grupe-grupe, mbasi qëndronin ne shtepine e tij, me jave, muajt, te tere ata e ftonin ate për te shkuar ne Kine, Indi, Afganistan. Dhe Samiu e ndiente një dëshire te forte për te shkuar ne keto vende, por nga që kishte një dhembje te madhe nga shiatiku, nuk lejohej te shkonte qofte dhe deri ne Bursa. Ne jeten e tij, vetem njëhere, dhe ajo ne kohen që kthehej nga intronimi mund te ketete shkuar ne Napoli. Neqoftese jetonte, nuk kishte asnjë dyshim se ai do te krijonte mrekullira ne disa fusha te reja, sepse për shkak te experiences, nuk kishte asnjë fushë që te mos kishte shkruar: nga fjalore, tek drama, roman. Ai ka shkruar tregimin me titull: "Kapiteni i vjeter". Për shkak te ekzistences te teatrove, kishte vazhduar dhe ne ketete fusha. Ai kishte dhe një roman. Energjia që Sami kishte, dashuria ndaj gjuhës Turke dhe aftesia që do te habiste, jane përmasat, me te cilat ne mund ta vleresojmë. Ne hasim ne një pretendim te tille: "Gjuha kryesore e tij ishte Greqishtja". Kete gjuhe ai e ka mesuar, sepse është diplomuar nga gjimnazi "Zosimea". Nga që Turqishten e ka mesuar me vone, veprat e para i ka shkruar dhe me gabime. Samiu ka hyre si autoriteti me i larte i gjuhës Turke, te cilen e ka dashur dhe ka punuar për ate.

Me lexoni një pjese nga Lamartini. Shkaku i nderrimit të jetës se tij është bere nga uremia (uremie-fr-azotemi)

Ne ditet e fundit te semundjes, ai po e ndiente se ndaj tij po afrohej nderrimi i jetes. Samiu, nga që kish-te mjaft merak, kujdesohej për thonjte e duarve, te cilet i rregullonte ne cdo kohe me thiken e vogel te xhepit. Ai kishte aq merak për pastertine e thonjve dhe te duarve, sa që kur shkruante me tre lloj ngjyrash boje dhe me tekste te vecanta, i kushtonte shume kujdes grykes se shisheve te bojes. Ishte i dhene mbas letersise franceze dhe sidomos ndaj periudhes se romantizmit. Ne kohen që ishte mire me shendet, cdo mbremje, vajzes që ne moshe te vogel i mesonte Frengjisht deri sa te vinte koha e ngrënies. E detyronte ate te lexon-

te Viktor Hygojn, Lamartinin. Nderroi jete me 4 Qërshor 1904. Ne ditet e lindjes se 4 Qërshorit , vazjes I tha: Me lexo mua Graziellen. Samija e re morri Graziellen. (Graziella është një roman i shkrimtarit te njohur Frances, Alphonse de Lamartini-t, botuar ne vitin 1852. K.N.) E hapi. Kishte një pjese që babai i saj e pelqente shume. E lexoi kete pjese. Syte e Samiut u mbushen me lote, që me te vertete kjo pjese ishte e bukur dhe me kuptim. Diten, ne kohen që po hynte ne një moshe te re, dijetari i madh nderroi jete. Fjalia e fundit, përpara fjales "Allah", duke bere me shenjë me doren e tij ndaj Yusuf Celalit (Jusuf Xhelali K.N.) nipi i tij i ri, i cili i qëndronte tek koka ishte: - Mjekojini syte e ketij femije-, dhe pastaj nderroi jete. Yusuf Celali ishte shume i talentuar, mirepo ishte një i ri, syte e te cilit shikonin shume pak. Samiu i mbante vazhdimisht afer te rinjte e ketille te talentuar. Por, Yusuf Celali u nda nga kjo jete mbas disa vitesh prej tij. Mbas nderrimit nga jeta, nga cdo ane e botes, deri nga Kina, nga vende që nuk do te vine ne mendje, errdhen shume letra ngushellimi.

Përse eshtrat e tij nuk erdhën në Shqipëri

Përpara se t'i japim fund shkrimtit tone, thekson gazetari Hikmet Feriun Es-, deshirojme te prekim dhe çështjen shqiptare, e cila ka parashtruar vazhdimisht kerkesen lidhur me eshtrat e Samiut. Lidhur me këtë do të themi vetëm dy gjera. Njëra nga keto është një ngjarje që ne nuk e dimin. Qeveria shqiptare, e cila ndodhej ne ate kohe ne pushtet, kur doli diskutimi mbi te (Sami Frashërin K.N.) se "ishte shqiptar", "nuk ishte shqiptar", duke iu drejtuar zyrtarisht familjes se Samiut, ka kërkuar për t'i sjelle ne Shqipëri eshtrat e dijetarit te madh, duke i bere te gjitha ceremonite dhe ta varrosnin ne Tirane. Mirepo familja e Samiut, kesaj dëshire te Qeverisë Shqiptare i ka dhene kete përgjigje: Ai është pasuri e kesaj toke, dhe do te prehet ne kete toke." Dhe te dyten le ta regjistrujme kete. Sot dhe emri i një rruge te madhe që fillon nga Yedikule-ja është rruga "Koca Imrahori". Ky është një hero me emrin " Koca Imrahor Iljazi. Është ne mes te atyre që hynë për here te pare se bashku me Fatihun te Stambollit. Ne fakt sot, nuk është e nevojeshme për te treguar pemene gjenealogjike si kjo. Ajo matet me sherbimin që ky njëri i ka bere shoqërise, me shkallen e dashurise ndaj saj. Te gjithë, neqoftese kemi mundur t'i sherbejmë shoqërise, atehere i dituri Turk ne cfardo lloj forme do te mund te lartsohet. Samiu është varrosur poshte një qëparisi ne varrezat e Sahray-i Cedid. Mua me treguan grumbullin, masen e një toke, që bile nuk ka një gur me te voglin, një gur qofte 40 cm. (Është fjala përpara vitit 1945. Sot eshtrat e Sami Frasherit, që nga viti 1968, ndodhen ne varrezat e Ferikoy-it (Stamboll) se bashku me eshtrat e antareve te tjere te familjes se tij. K.N) Po, gje e pabesueshme. A nuk jemi ne kombi që thote: Për ne balta, e cila shpërndahet nga kembja e kalit te dijetarit, është stolia me me vlere për ne?



R

ARGUMENT

Metropolitan Opera

"Aida" e Verdit dhe "Karmen" i Bizet, në performancë

NGA SUL GRAGJEVI*

Më 11 dhe më 12 Janar të sezonit operistik 2018-19, isha në performancat e operave të bukura, të operës "Aida" dhe të operës "Karmen" në Metropolitan Opera, organizimi më i lartë i muzikës klasike, me një brendësi fantastike dhe një sistem zëri superior. Për dy netë pamë një realizim të përsosur të dy operave me një "glorious music" të një produksioni të gjerë e të përsosur.

Operën "Aida" e dirigjoi Italiani nga Viareggio, **Nicola Luisotti**. Këtë sezon ai dirigjoi operat "Aida", "Rigoletto" dhe "Traviata" në Met, "Turandot" në Madrid, "La Forza del Destino" në Paris Opera si dhe "Simfoninë No.9" në Madrid. Ka qenë drejtor i muzikës në Teatro di San Carlo të Napolit për dy vjet. Dirigjoi performancat e tjera si "Falstaff" dhe "La Bohème" në Covent Garden, "Tosca" në Valencia, Torino etj.

Opera "Aida" është një shembull i sofistikuar i "Romantizmit Italian", i mbushur me një aromë bindëse misterioze dhe ekzotike. Giuseppe Verdi krijoi një paletë unike muzikore për këtë operë. Madhështia e subjektivit është e prirur të bartë koret madhështorë patriotikë (akti i parë dhe i dytë) si dhe "Marshin Triumfues" (akti i tretë). Këto momente publike shpesh shërbejnë si kuadër për solot e tenorit dhe të soprano: "Celeste Aida" e tij mundëse në fillimin e aktit të parë, "Ritorna vincitor" e saj dhe "O patria mia" në aktin e tretë. Siç është parë, pjesa më impulsive në këtë dramë, në dallim prej koraleve, janë solot e shpeshta e të bukura siç është aria e tenorit në skenën e faktores të aktit të parë, e mezzosopranos në skenën e gjykimit në aktin e katërt, aria e soprano në skenën triumfuese të aktit të dytë si dhe në finalen e famshme, te skena e varrit "Aida" dhe "Radies" fillojnë duetin e tyre të fundit, të ndarjes me jetën e trishtuarit e të kalimit në përjetësi. Skena e varrit është vërtet e veçantë: "Radies" këndon ngadalë i shoqëruar nga muzika:

"La fatal pietra sopra me si chiuse;

Ecco la tomba mia.

Del di la luca mio non vedro

....

non rivedro' piu Aida ("guri fatal mbi mua po mbyllet. Ja

Kritiku i njohur, bashkëpunëtor i përhershëm i "Milosao" na shpjegon dy performanca. Më 11 dhe më 12 janar të sezonit operistik 2018-19 isha në performancat e operave të bukura, të operës "Aida" dhe të operës "Karmen" në Metropolitan Opera, organizimi më i lartë i muzikës klasike, me një brendësi fantastike dhe një sistem zëri superior. Për dy netë pamë një realizim të përsosur të dy operave me një "glorious music" të një produksioni të gjerë e të përsosur. Për hir të së vërtetës, shkrimi është botuar me vonesë...



Si u shkrua vepra

Giuseppe Verdi e shkroi operën në bashkëpunim me libretistin Antonio Ghislanzoni duke u konsultuar edhe me egjiptologun frëng, Auguste Mariette. Vepra është një kombinim i shkëlqyer i "grand operas" më të përpunuar me bel canto dhe me teknike orkestrale moderne. Ajo përbën një fazë të re në zhvillimin e krijimitarisë së kompozitorit si dhe të stilit të ri. "Aida" konsiderohet "opera e këngëtarëve" dhe këta këngëtarë duhet të kenë zë madhështor ashtu si arkitektura kolosale egjiptiane

varri im. Nuk do të shoh më dritë nga lart... Nuk do ta shoh më Aiden" ndërsa "Aida", e shoqëruar nga orkestra, me nota të regjistrit të poshtëm shpreh gjendjen e saj të rëndë dhe vendosmërinë për të vdekur në krahët e "Radies":

"In questa tomba che per te s'appriva

Io penetrai furtiva,

"E qui lontana da ogni umano sguardo

Nelle tue braccia desiai morire".

Verdi i madh ka shkruar dy ari-ozo, njëherë për "Radiesin" dhe tjetër për "Aiden". Në duetin midis "Radies" dhe "Aida", Verdi, e përsërit dy herë lamtumirën e tyre për jetën dhe tokën.

"O terra, addio, addio, valle di pianto,

Sogno di gaudio che in dolor svani,

A noi si schiude il ciel.....

Kjo skenë aq e bukur dhe prekëse u realizua në mënyrë të përsosur nga soprano dhe tenori, Kristin Lewis dhe Yonghoon Lee. Që të dy kanë kënduar në Operan e Shtetit Vienë, Bavari, San Francisco, Covent Garden, Paris Opera, Staatsoper Berlin, Lyric Opera

Chicago, La scala, Hamburg, Napoli, Torino etj.

Amneris dëgjohej të kërkojë paqë, "Pace t'imploro, salma adorata", ndërsa kori i këndon pafundësisë së përjetshme.

Giuseppe Verdi e shkroi operën në bashkëpunim me libretistin Antonio Ghislanzoni duke u konsultuar edhe me egjiptologun Frëng Auguste Mariette. Vepra është një kombinim i shkëlqyer i "grand operas" më të përpunuar me bel canto dhe me teknike orkestrale moderne. Ajo përbën një fazë të re në zhvillimin e krijimitarisë së kompozitorit si dhe të stilit të ri. "Aida" konsiderohet "opera e këngëtarëve" dhe këta këngëtarë duhet të kenë zë madhështor ashtu si arkitektura kolosale egjiptiane. Megjithëse "Aida" u shfaq në vitin 1871, ajo si opera ka ende freskinë artistike, asgjë nuk ka humbur admirimet universalisht dhe mbetet shumë popullore. Opera "Aida" është gjithashtu e para midis shumë veprave të Verdit që braktisi "momentet e mëdha" në favor të një punimi integral të kompozuar. Dramaciteti i operës rritet dhe rrjedh në mënyrë llojike; skenat spektakulare janë pjesë e kesaj llojike. Giuseppe Verdi ishte i dëshpëruar me traditat e "scrittura pratica"-s, të cilat kërkonin subjekte mesjetare, me pasion pa kufi. Me Verdin, opera tregoi një zhvillim të madh në cdo aspekt, në melodi, në harmoni e orkestracion gjithashtu dhe në formën e organizimit. Gjithsesi, në veprë nuk ka asgjë të zakonshme; dëgjuesi është tërësisht i zënë sapo fillon opera me preludin fin, dhe pas tij me duetin që lartësohet mrekullisht. Në të gjithë operën e Verdit, "Aida", të shfaqur në Met, është përdorur me mesjetëri kolori lokal. Në vend të ekzotizmit dhe orientalizmit, Verdi përdori tërësisht koncepte harmonike, melo-

→ Vijon nga faqja 17

dike dhe orkestrale perëndimore për të ngjallur një atmosferë tërheqëse ndërsa në skenën e Nilit, avancoi në fushën kompozicionale sipas Claude Debussy-së. Dashuria trekëndëshe e Idamante, Ilija dhe Electra në Idomeneon e Mozartit shumë vite më parë, është paraardhëse për Radames, Aida dhe Amneris në operën Aida. Orkestra nën drejtimin e Nicola Luisotti ishte e përsosur gjithë kohën, dëgjua ndër tjera, temën memorabile të Aidës në aktin e tretë të luajtur nga flauti, një ton i lartë i mbështetur nga violinat dhe violonçelot 'sotto voce' ndërsa ajo priste të takonte Radames-in jashtë tempullit. Të njëjtët tinguj memorabile orkestrale dëgjohej nga harqet në fillimin e aktit të tretë, me notën Sol të luajtur në mënyrë të ndryshme, pizzicato, tremolando, duke krijuar kështu një teksturë të një delikatese të pakrahasueshme, mister dhe bukur – të një qetësie nokturnale. Natyrisht, duke qenë kjo opera Italiane, zërat e këngëtarëve sundojnë në mënyrë supreme. Publikuesi i Verdit, Ricordi e përshkruante Aidën si një "natyrë e dashuruar", një mirësi, një butësi, si veçori kryesore. Kjo natyrë e dashuruar ka lartësitë dhe thellësitë e saj muzikore, dëgjua ndërpërhim, dëshirë të zjarrtë, përvojat, mall për atdheun "O patria mia", romanca e saj në aktin e tretë. "Oh, atdheu im, kurrë nuk kam për të parë më" që Aida e këndon para dhe pas çdo strofe, një linjë që shpesh është therëse në fragmentet ekspresive. Babai i saj Amonasro, baritone Roberto Frontali, me një lirizëm të theksuar përpiqet t'i mbush mendjen Aidës që të veprojë sipas urdhërit të tij, duke kërkuar prej saj që të mësojë nga Radames rrugëkalimet e ushtarëve egjiptianë me qëllim që etiopianët të sulmonin befasisht Egjiptin. Por Aida refuzon, dhe i ati e mallkon të bijën: "Ti s'je më vajza ime, por një sklave e Faraonit".

Megjithatë në disa skena Radames këndon si tenor heroik, ëmbëlshëm lirike e pjesës së tij në duetin e vdekjes nga fundi operës është një venë e re e patosit për të si tenor. Mezzo Amneris, Dolara Zajack, është më komplekse si karakter, me një "parlante melodico". Kur ajo del me Radames-in në aktin e katërt, "Ah! Tu dei vivere", Verdi i jep asaj një nga meloditë më të anktshme, madhështore, dhe të bukur, që asnjëherë nuk është shkruar për një mezzosoprano. Kamfis është një nga priftërinjtë më të fuqishëm rolin e të cilit e realizoi mjaft mirë, basi Vitalij Kovaljov.

Opera Aida ishte një përshëndetje dhe-lamtumirë e versionit Frëng të grand operas të italianizuar, e bazuar në histori dhe e mbushur me skena të mëdha ceremoniale, grumbullime të mëdha. Momentet finale të veprës me korin afër varrit që thërret "Immenso Fitha" si dhe Amneris në ankt për jetën e Radames-it, nuk ngahj më asnjë histori tjetër operistike.

Opera Karmen e Bizësë në katër akte, me libretto të Henri Meilhac dhe Ludovic Halevy, e bazuar në romanin e Prosper Merimee, u bë e mundur si produksion nga një dhuratë bujare e Mrs. Paul Desmarais Sr. Është e 1017 ta performancë e Georges Bizësë në Metropolitan Opera. Kjo performancë u dirigjua nga Louis Langree,

Metropolitan Opera

"Aida" e Verdit dhe "Karmen" i Bizësë, në performancë



Për operan "Aida"

Opera "Aida" është një shembull i sofistikuar i Romantizmit Italian, i mbushur me një aromë bindëse misterioze dhe ekzotike. Giuseppe Verdi krijoi një paletë unike muzikore për këtë operë. Madhështia e subjektit është e prirur të bartë korët madhështorë patriotikë (akti i parë dhe i dytë) si dhe "Marshin Triumfues" (akti i tretë). Këto momente publike shpesh shërbejnë si kuadër për solot e tenorit dhe të sopranos: "Celeste Aida" e tij mundëse në fillimin e aktit të parë, "Ritorna vincitor" e saj dhe "O patria mia" në aktin e tretë.

Francë. Është dirigjent i njohur që ka dirigjuar në festivalet e Mozartit që në vitin 2002, ka qenë drejtor i muzikës në orkestrën filharmonike në Liezh, në Operën e Lionit dhe në Glyndebourne Touring Opera, shef dirigjent në Camerata Salzburg, ka dirigjuar në Filharmoninë e Vienës, Berlinit, Londrës, Parisit, Toronto, në Lyric Opera Chicago etj. Në rolin e Karmenit këndoi mezzosoprano Clementine Margaine nga Franca, e njohur në performancat e Karmenit në Vienë, Berlin, Paris dhe Toulouse, Napoli e Dresden.

Në rolin e Don Jose këndoi tenori i njohur sot, Roberto Alagna. Që në vitin 1996 ai ka debutuar si Rodolfo në La Bohème, ka kënduar në më shumë se 125 performanca në 16 role. Ai ka kënduar edhe me sopranon tonë Inva Mula. Alagna është tenor i operas Franceze. Në rolin e Mikaelës këndoi soprano Polake Aleksandra Kurzak. Ajo ka një përvojë të pasur në rolet e

Desdemonës, Liu në Turandot, Vitellia në Clemenza di Tito, Alice Ford në Falstaffin e Verdit, Mimi në La Bohème, në rolin titull të Lucia di Lammermoor dhe Fiorella në Il Turco in Italia krahas Vienës, Covent Garden dhe La Scala. Në rolin e Escamillo-s këndoi basi nga Moska, Aleksander Vinogradov, i njohur në rolet të Don Giovanni, të Faustit, Luisa Miller, Vesperi Sicilian, Simon Boccanegra, Vilhelm Teli, këndoi si Escamillo në Zurich, Venice, Toulon, Verona, Romë.

Opera Karmen ishte vepra e fundit e Georges Bizet. Ajo përmban shumë melodi të njohura që mbeten lehtë në memorien e dëgjuesit. Orkestra e Bizësë sjell një paletë të gjërë të tingullit. Solot kryesore, më të rëndësishmet janë të kombinuara në mënyrë ekselente, nga më të shquarat është ajo e baritonit në aktin e dytë, "Toreador" ("Votre toast, je peux vous le rendre..... Toreador, en garde"), ajo e tenorit, Kënga e Luleve ("La fleur que tu m'avis jetée") në aktin e dytë, si dhe aria e Mikaelës nga akti i tretë ("Je dis que rien ne m'epouvante").

Karmeni dhe Don Jose kanë tre duete të shquar që shënojnë skenën e marrëdhënies fatale të tyre: faza joshëse, tërheqëse (akti i parë), konflikt (akti i dytë) dhe shpërthimi tragjik (akti i katërt).

Është interesante se, kur Karmen ka disa solo në formën e këngëve-janë momentet në të cilat aktualisht supozohet që ato duhet kënduar brenda kontekstit të dramës.

Vdekja e Georges Bizet më 3 Qershor 1875, tre muaj pas hapjes famoze të natës së Karmenit në Opera Comique të Parisit, është një prej ironive më mizore në historinë e muzikës, shkruan Prof. Hugh MacDonald. Ndërsa ishte tragjik edhe rasti Puccini që nuk arriti të shoh



Turandot ose Berlioz që kurrë nuk e pau operën e tij Les Tryens. Bizet ishte vetëm 36 vjeç, por në qoftëse Verdi, Wagner ose Strauss do të jetonin sa jetoi Bizet, atëherë, kuptohet, se shumë opera të tyre nuk do t'i frekuentonim fare sot. Tre vjet më vonë, pas prezantimit të Karmenit në Operan e Vienës, sukcesi i saj vazhdoi në Bruksel, Budapest, St. Petersburg, Stokholm, Londer, Dublin, New York dhe Filadelfia.

Idea e mrekullueshme e Bizësë ishte e bazuar në historinë e Prosper Merimee's, romani Carmen. Më 1872 Bizësë i kërkuar të shkruante një operë në tre ose në katër akte për Opera Comique të Parisit, një teatër në të cilin operat tradicionale kishin një përfundim të gëzueshëm, pra publiku ishte mësuar të shihte këto lloj operash. Ishte teatër familjar në të cilin audiencat argëttoheshin dhe kurrë nuk ishin të shokuara madje kurrë nuk kishin dëgjuar për vdekje vdekje në Opera Comique! Një gjë e tillë kurrë nuk ka ndodhurkeni dëgjuar, kurrë! thoshte ish-drejtori i teatrit, dramaturg, Adolf de Leuven.

Dhe askush nuk e besonte që një operë e cila mbaronte me vdekje, do të shfaqej në skenën e Operas Komike të Parisit.

Ishte Camille du Locle, poet dhe orientalist që më vonë u bë libretisti i "Don Carlos" së Verdit, i cili i kish sugjeruar Bizësë idenë e një opere. Zgjedhja e Karmenit në atë teatër çoi në një rrugë tjetër të pautitshme qysh me sjelljet e heroines dhe më vonë me vdekjen e saj. Ajo pinte cigare, joshte ushtarët, korruptonte njerëzit zyrtarë. Ajo ishte e zgjuar, e mençur, magjepshe dhe ndonjëherë edhe e dhembshur, delikate, muzika e saj është aq tërheqëse dhe e bukur sa që askush nuk mund ta kishte magjnetizmin e saj. Bizet e njihje shumë mirë shoqërinë Frëngë të kohës së tij, ai njihje mirë subjektin për muzikë dhe dinte ta sillte në jetë dhe në skenë. Ky muzikal-teatër, u ngarkua me një realizëm të pashembullt që e bënë dy figurat kryesore, Carmen dhe Don Jose. Në fakt, drejtori i teatrit du Locle ishte shqetësuar për përmbajtjen e subjektit dhe përplasjen me audiencën konservatore parisienne, kurse shtresa e mesme e francezëve, nuk shqetësohej, se kjo gjithmonë ka qenë e moralit të fuqishëm. Për këtë arsye, du Locle mendonte se nga përplasia me konservatorët, klientela e zgjedhur do ta bojkotonte "shtëpinë e operës" por megjithatë ai u angazhua për ta shfaqur Karmenin. Opera u shfaq më 3 Mars 1875 nën dirigjimin e Adolf Deloffre në Opera-Comique të Parisit. Në rolin e Karmenit këndoi mezzo Celestine Galli-Marie. Gerges Bizet ishte shqetësuar për të gjetur për operën e tij melodi autentike. Habanera e famshme, p.sh. u adaptua si melodi nga kompozitori Spanjoll-Amerikan Sebastian Yradier. Megjithatë, Bizet do të shkruante ai vetë muzikën e bukur Spanjolle.

Seguedille, që mbyll aktin e parë, është plot kolor dhe tepër dramatike. Pjesa më e madhe e operës nuk është spanjolle, e reja e

kësaj opere i takon traditës Frëngë të 'opera comique'. Gjithashtu te Karmeni vihet re edhe një lirizëm i fuqishëm Frëng që rrjedh nga Gounod, mentor i Bizësë, e që më të geshur ai thoshte se aria e Mikaelës nga akti i tretë është marrë prej tij. Muzika e Bizësë është moderne dhe se gjenialiteti i tij është evident në brilancën e secilit numër individual, në gjetjen e melodive të shquara dhe formave për çdo skenë. Francezët mësuara ta duan, ta adhurojnë Karmenin. Më 1878, opera të shfaq në New York në Akademinë Muzikore në italisht dhe më 1881, në anglisht, ndërsa në Met, më 5 Janar 1884. Mbahet mend që atëherë kur Çajkovskij e cilësoi Karmenin si operë më popullore në botë.

Pas provave, kur Bizet shtoi 6 soprano të para dhe 4 të dyta, ai i tha drejtorit të teatrit du Locle: "unë ndjej një fitore të mundshme, ju siguroj, e di që ju do të ripaguheni nga kjo gjë". Tani Bizet, pas provave të shkëlqyeshme e pranoi që kish bërë një punë shumë të mirë. "Bukur, kam shkruar një punim shumë të qartë dhe plot gjallëri, plot kolor dhe plot melodi ju do ta pëlqeni". Bizësë iu deshën dy muaj që të përfundonte të gjithë orkestracionin prej 1200 faqesh. Teodore de Banville (1823-1891), poet dhe shkrimtar i njohur Frëng, e duartrokiti atë "për paraqitjen e dramës me njerëz realë të karaktereve të gjalla në vend të kukullave të Operas Comique" ndërsa Jules Massenet i dërgoi një notë urimi Bizësë në të cilën i shkruante: "Sa i lumtur duhet të jesh në këtë moment!"

Sipas Schonbergut, është e vërtetë që në aktin e fundit, opera ka diçka të përbashkët, tragjike, me aktin e fundit të "Don Giovanni" me ndryshimin se në rolin kryesor, në rastin tonë, është një grua dhe jo një burrë. Karmeni dhe Don Giovanni vdesin dhe më mirë që ndodh kështu, ndryshe dy personazhet kurrë nuk do të mbeteshin figura të mëdha e të rëndësishme në artin operistik. Vetë Karmeni ishte më shumë se një karakter: "Ishte menjeprehtë, e fortë, por edhe delikate". "Jamais Carmen ne cedere. Libre elle est nee et libre elle mourra" ("Karmen s'ka për t'u nënshtruar kurrë. E lirë ka lindur dhe e lirë do të vdesë"). "Në të vërtetë, thotë Harold C. Schonberg, Karmeni ishte më shumë e moralit se sa e imoralit, sepse ajo ishte gjithmonë e ndershme me veten e saj". Karmen është një operë e pasionit, e forcës, vërtetësisë dhe padyshim qëndron më lart nga shumë opera tjera. Ajo është një nga 10 operat më popullore në botë. Vepra e Bizësë është një dramë muzikore e ngrohtë që prej notës së parë të uverturës e deri në fund. Kjo vjen edhe nga që Karmeni bashkon muzikën pikante 'kabarë' dhe ritmet e vallëzimit popullore Spanjoll, me artin më të lartë muzikor, në një tërësi organike të përsosur. Elementet popullore janë të pranishëm në të gjithë operën me një përpunim original, plot shije, tepër tërheqëse, harmonitë janë Frëngë, por mjeshtëria e Bizësë krijon një kënaqësi për çdo dëgjues. Karmen është diva cigane e operës dhe askund më shumë se në aktin e parë, me Habanerën, nuk ndeshemi me ekspresionin brilant të saj. E gjithë muzika e bukur e Bizësë, plot ekspresion, elegancë, plot ngryra dhe temperament, është e asimilueshme dhe mbetet gjatë në memorien e dëgjuesve.

*Sul Gragjevi, kritik muzike

P

POEZIA

NGA DEMIR GJERGJI

MBRËMJA E LIVADHIT

Me mëzat një mëzat,
Livadhiti azat...
Mëzati jaran,
Kullot manxuranë,
Mëzati azganë,
Bredhin revan.
Matanë livadhiti pa fund e pa anë,
Për kurorë kumbon një kambanë.
Mëzati zemra i qan,
Mëzave thundrat u hanë!

GJARPRI

S'kam këmbë si ju, as duar me thonj,
As armë për gjah, për krishtë a mbrojtje.
S'kam mjekër e flokë, as push të ngrohtë...
Zvarritem, komete e ftohtë
Me helmin e tmerrshëm në gojë.

Kur fundi në hon kërkon fillimin në yje,
Lidhem rreth vetes njëje,
Shoh ëndrra me bishtin nën krye.

30 SHKURTI

-Kantik-
Kjo ditë jetime në moshën time...
Hijet e gjata me rrënjë të nata.

Shkurti e la, marsi s'e pa.
Perië ra nga xhepi, njeri nuk e gjeti.

Kjo ditë u ngrys si unë u përmbys
Dikur në një maj mbi lotin e saj.

Kjo ditë u tret si kripa në det...
Që emër të ketë, flijohet një jetë.

Nxito, ti o erë, shko, hape një derë,
Të hyjë o të dalë, një sy a një fjalë.

SHTËPIA PA KUKULLA

-Rrëfënjë në tri kohë-

Sërish na ra udha
Nga shtëpia pa kukulla...
Ku nata na zu vite të shkuara...

Bujtëm aty unë, djali dhe gruaja.
Një zonjë beronjë na priti me mjalte e me fruta,
I zoti i shtëpisë ngriti shëndete me kupa.

Natën foshnja trembej përgjumësh,
Zgjohej,
Qante,
Gjirin s'e zinte për qumësht.
S'pranonte ledhe, ninulla,
Kërkonte të lozte me kukulla!

Sot prapë na ra udha
Gërmadhës pa kukulla.
Biri i tim biri këmbëngul me të lutura,
Të ndalim këtu, të lozë me flutura.

TRI DITË

At-e-bijë
Bashkë, - dy ditë:
Dje e sot.

Vjen e nesërmja,
Bijëz-mbesë...
Midis nesh...

Ylli u ndez,
Mes për mes
Në Univers.

SHËNIM ARKEOLOGU

Hapen hije, shemben pargje, zhvishen

Demir Gjergji paraqitet me një tjetër përmbledhje poetike me titull "Pjergulla në kupë". Cikli i mëposhtëm, që botohet në përcjellje të kësaj ngjarjeje është përzgjedhur nga krijimtaria e fundit e autorit. Besnik i stilit të vet, poeti vazhdon synimet dhe përpjekjet e tij drejt formës moderne, të ndërthurur natyrshëm me atë tradicionale...

Pjergulla në kupë

*Ku(r)do që të jemi,
Dikush na vizaton
Pas shpine.
'19*



sheshe...
Rende, shekuj, krejt si tesha mbretëreshe,
Ditë-vite, prikë intime virgjëreshe,
Djellit puthen e këndellen nëpër epshe.

Mbreti i lashtë me kurorë apogjeu,
E shpall emrin, që në harpë ta thotë Orfeu
Te monedha që nuk dihet, se ç'farë shiti e çfarë
bleu,
Që nuk thuhet, se ç'tradhtar a aleat shpërbleu.

DHE VIJNË MËNGJESE SËRISH

E pamë paruken e barit,
Mbi shkëmbin tullac të blerojë,
E ndjemë në palcë acarin,
Kur erdhi, e shtriu për shtrojë.

la ndoqëm flatrimin fajkoit.
Tek shtynte qiej e kufij.
Na theri në rrënjë të thoit,
Rënkimi i rënies së tij.

U ndezëm në vallen e flakës,
Pa ditur për shkumbin e zi,
Dhe humbëm në guvën e plagës,
Thëngjij të ftohtë nën hi.

T'i qepa fustan e këmishë,
Mëngjeset që binin mbi dhë...
Dhe vijnë mëngjeset sërisht,
Po zëre se s'jemi më ne!

KROI

A thua do të kthehem prapë,
Andej nga erdhëm me vrap?

A thua do të shkojmë sërishtmi,
Ku nuk na kujtohet se ishim?!

A thua na deh dhe një herë,
Kjo verë përzier me vrer?!

A thua dikur do ta shohim
Vetveten që më nuk e njohim?!

A thua...A thua...A thua
Rrijdh sot ai ujë në krua?!

PËRBALLË PYLLIT

Gjelbërimi erdhi,
Krejt ai i vjetmi...

Asnjë dru s'u zverdh,
Asnjë gjeth s'u shkund,
Asnjë shpend s'u dergj
Në dheun e murrmë.

Po ata dhe ne...
Këtu e atje,
Si të humbur dije!

ATJE KU ENDE S'KAM QENË

Në ajër
Ngrë një flatër.
Në tokë
Hap një gropë.

Në natë
Lus për fat.
Në ditë
Lë një shpirt.

Fiatra për t'u ngritur,
Gropa për të zbritur,
Fati për të ndritur,
Shpirti për t'u fikur.

LEXIMI I NATËS

Përballë
Letrës së bardhë,
Mbyll sytë,
Për të lexuar
Natën.

KËNDOJ HESHTJEN

Poshtë zhurmës
Së turmës,
Të filli i frymës mbështetem...
Këndoju vetveten
Si heshtjen.

LULESHTRYDHET

Në tregtëzën e së dielës me diell,
Shet luleshtrydhe të vjela në qiell.

Në vend që t'i blej,
Tinëz i mbledh nga sytë e thellë
Dhe nata me buzët e saj m'i sjell.

SEGMENT

-Të dija të vogël...-
(Akord serenade)

Tej në vite,
Thellë në vise,
Poshtë në moshë.

Botë bosh
Në qiejllin shoshë!
Sytë a zemrën të besosh?!

DRITARJA

Sa më larg, në dëborë të larohet ai mal,
Më e ngushtë do të duhej një ditare ballë për
ballë,
Që ta shohin sytë tanë, kur të hyjë e kur të dalë.

Sa më tutje, prapa malit të mërgosh të largësitë,
Më të gjerë do ta gjeje ti dritaren ndonjë ditë,
Për të hyrë e për të dalë nëpër gjak e nëpër
shpirt.

FRONI

I kisha fituar krejt luftëtar,
Isha vetëshpallur hero,
Të kishin mundur të luturat:
Te buza të mbinte një "Po"!

Në sy më s'më hynin të bukurat,
Ku ishin e s'ishin ato.
Ty frymën ta zinin të puthurat,
Unë prapë të pyesja: "Më do?"

S'më joshnin kurorë e skeptër...
Ku mund të shkonim më lart?!
Shtërnguar ndjeheshim mbretër,
Veçuar, shtegtarë të ngratë.

...Por maja për ne qenka honi,
Gremina e qiellit gjithkund.
Unë bie i mundur nga fronti,
Ti qan e fsheh lotët në fund.

DY VETMI...

Atje rrezet pengohen e bien,
Nën mjegull, larg trupash, tej hijesh,
Prej hapit tënd fillikak.

Këtu mbrëmjet mëngjesese ikin,
Pa orë mesditë, pa prillin,
Në vrapin tim arrakat!

Atje udhët u mblodhën e fjetën,
Pa gjurmët, ndalesat dhe jetën,
Që kur të panë ty vetëm.

Këtu vjeshtat u kthyen nga erdhën,
Pa shirat, pa shpezët, pa erën.
Në zemrën je-time u prehën.

VETË I DYTË

Kur më sheh pasqyra,
Bota mbyll sytë,
Na lë vetëm,
Shkon e verbër.

Në qelq, vetë i dytë-
Fryma e fytëra.

LISI I VETËM

Kush tha, se lisi i vjetër,
Mbeti fare vetëm,
Shkretëtim të bëshkës?!

Gjethet po e lënë, ai flet me shpezët,
Hijet arratisen, vallëzën me degët,
Mërgojnë foletë, ai qesh me erën.

Kush tha, se lisi i vjetër
E përcolli jetën?!

...nga numri i shkruar

"Milosao" e këtij numri mund të konsiderohet relativisht e mirë. Mbante pak erë sepse ishte e mbushur me shkrime për personazhe të vjetra. Në qendër ishte jeta e Kostë Çekrezi dhe vazhdimi i shkrimit për Sami Frashërin, që po zgjatej pafundësisht. E veçanta për Kostë Çekrezin ishte se merrej në konsideratë nga studiuesi Andon Andoni koha e hershme e formimit të tij, e cila lidhej me Shqipërinë.

Ky personazh, Kostë Çekrezi, mbahet si një nga katër liderët e komunitetit shqiptar të Amerikës, pas Faik Konicës, Fan Nolit dhe Kristo Dakos. Në të gjallë Fan S. Noli do ta rendiste si "ndër tre njerëzit që mund t'i sillnin dobi fatit të Shqipërisë" dhe "punëtori më i madh që ka nxjerrë Përlindja Shqiptare". Autori, që ka shkruar një monografi për të përpiqet të shpjegojë hershmërinë e kësaj figure të shquar dhe gati të harruar. Redaktori i duket se ka mungesë të dritëhijeve, ato që realisht mund të ngrenë një figurë si duhet.

Në këtë numër, vazhdoi shkrimi kilometrik dhe disi patetik për jetën e Sami Frashërit, përgatitur nga Kujtim Nuro, një osmanolog i shquar dhe Hikmet Feridun Es botuar në gazetën "Aksham" (Stamboll), Dhjetor 1944-Janar 1945 me titull: Personalitetet e famshme që nuk i njohim- Shemseddin Sami - Një gjigand mendimtar, të cilin nuk e njohim aspak (Arkivi i Taha Toros - Universiteti i Qytetit të Stambollit). Në këtë numër u përshfaq përkorja e frikshme e jetës së tij por edhe episode shumë intime familjare, që shoqërohen edhe me përshkrime interesante të panjohur, si përsëmbull martesë me të kunatën. Redaktori pati vëre-



jije nga dikush sepse ky numër dukej nga titulli si një lloj bluetooth i një shekulli të shkruar. Në fakt, kjo për shkak të intimiteteve të pathëna.

Redaktori bëri një vëzhgim për albumin e fundit, që i është dedikuar piktores Rudina Proda, të cilën e konsideroi si një institucionalizim të krejt vepërimitarë së saj për shumë vite. Familja e saj, streha, e cila jo vetëm e ka ruajtur por edhe e mbrujti artin e saj, është frymëzuesja dhe angazhuesja e një projekti të tillë tejet mbresëlënës, por në një farë mënyre fryt i një pune kushtuar një individi me cilësi shumë të veçanta që duhet vlerësuar, shkroi ai.

Anastas Kostandini na solli diçka për mikun e tij Maks Velo, ku afirmoi si mesazh identiteti-pikturën , një pikturë që shfaqte materien, strukturat, dritën fizike apo hijedritën për t'i gjetur ato indirekt mes ngjyrave. Për fat të keq, mungesa e redaktorëve dhe mbi të gjitha korrektorëve na bënë të punojmë gati me tekste të parregulluara. Këtë justifikim e themi për disa shkrime të gjata, që nuk mundëm t'i pastronim krejt. Roland Gjoza erdhi me një tregim, që për redaktorin ishte një rëfzim gati psikologjik i zgjidhur deri-diku këndshëm. Fajta e fundit iu la kolegut dhe publicistit të njohur Aleksandër Çipa, i cili në kohët e fundit vjen me këtë cikël poetik që i dedikohet ndjesive të tij, të lidhura ngushtë me Himarën, vendlindjen, dhe me të gjithë shtratin e vet mitik në një regjistrë gati burimor. Redaktori nuk e ndoqi si duhet deri në fund botimin e "Milosao's", për shkak të shumë problematikave, që për fat u zgjidhën deriduku mirë nga layout.

P
POEZIA

Dy shkrimtarë shqiptarë, Luljeta Lleshanaku dhe Ndrek Gjini kanë qenë sivijet të ftuar në njërin nga festivalet më në zë të letërsisë në Irlandë, "Cuirt International Festival of Literature" - (8-14 prill 2019).

Ky festival letërsie zhvillohet çdo vit në Galway, qytet turistik në perëndim të Irlandës. Ai është themeluar në vitin 1985 dhe për 34 vjet me radhë ka pritur mjaft shkrimtarë të njohur nga e gjithë bota, përfshirë këtu edhe fitues të çmimit "Nobel", të tillë si Seamus Heaney, Herta Müller e mjaft të tjerë...

NGA STAFF MILOSAO

Zëra nga Shqipëria: Përtej diktaturës

Dy shkrimtarë shqiptarë, Luljeta Lleshanaku dhe Ndrek Gjini kanë qenë sivijet të ftuar në njërin nga festivalet më në zë të letërsisë në Irlandë, Cuirt International Festival of Literature - (8-14 Prill 2019)

Ky festival letërsie zhvillohet çdo vit në Galway, qytet turistik në perëndim të Irlandës. Ai është krijuar në vitin 1985 dhe për 34 vjet me radhë ka pritur mjaft shkrimtarë të njohur nga gjithë bota përfshirë këtu edhe fitues të Çmimit "Nobel", të tillë si Seamus Heaney, Herta Müller e mjaft të tjerë.

Gazeta me e madhe Irlandeze Irish Times, si dhe kanali televiziv publik RTE1 , si çdo vit edhe kësaj radhe i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë këtij festivali. Në përmbledhjet rreth këtij festivali ata përmendin se "Cuirt për vitin 2019 përfshijnë pjesëmarrjen e shkrimtarit nigerian Ben Okri, fitues i "Booker Prize", poetët e mirënjohur ndërkombëtarisht Patricia Smith dhe Rafeef Ziadah, romancier amerikan Joshua Cohen, dhe një mori autorësh dhe poetësh kryesorë irlandezë si Joseph O' Connor, John Kelly, Emilie Pine dhe Sinéad Gleeson.

"Irish Times" dhe RTE1 citojnë gjithashtu se tema e festivalit të sivjetëm 'Literature Of Witness' vjen sivijet me një prezantim interesant nga Shqipëria me fituesen e English PEN Luljeta Lleshanakun, dhe poetin shqiptar që banon në Galway, Ndrek Gjini.'

Aktiviteti ku Lleshanaku dhe Gjini prezantuan krijimtarinë e tyre u zhvillua ne Teatrin Nuns Island më datën 10 Prill 2019. Salla e këtij teatri ishte e mbushur plot. Drejtoresha e këtij festivali Dr. Emily Cullen u shpreh se ishte mjaft e kënaqur por edhe e surprizuar pasi biletat e këtij aktivi-



Prezantuesja thotë se Lleshanaku është gati për çmimin e madh poetik

Prezantuesja e këtij aktiviteti, poetja dhe dramaturgia e njohur, e cila boton në gjuhën Irlandeze, Maire Holmes, që është njëkohësisht dhe kryeredaktore e revistës së mirënjohur letrare "The Galway Review" në hyrje të fjalës së saj i njohu të pranishmit me një lajm që e mësua më pak minuta para se të fillonte ky aktivitet. Lajm që kishte të bënte me faktin se Luljeta Lleshanaku është përzgjedhur për çmimin "Griffin Poetry Prize 2019", që është çmimi më i madh në botë, i cili jepet për poezinë. Ky çmim jepet në Kanada nga "The Griffin Trust."

teti ishin shitur te gjitha katër ditë para shfaqjes. Kjo, tha ajo,- ndodh ndërko-

hë që pak kohë më parë kishim bileta të pashtitura për mjaft aktivitete të tjera të këtij festi-

ti poetja dhe dramaturgia e njohur që boton në gjuhën Irlandeze, Maire Holmes, që është njëkohësisht dhe kryeredaktore e revistës së mirënjohur letrare The Galway Review në hyrje të fjalës së saj i njohu të pranishmit me një lajm që u mësua më pak minuta para se të fillonte ky aktivitet. Lajm që kishte të bënte me faktin se Luljeta Lleshanaku është përzgjedhur për çmimin Griffin Poetry Prize 2019, që është çmimi më i madh në botë që jepet për poezinë. Ky çmim jepet në Kanada nga The Griffin Trust.

Për shumë nga shkrimtarët shqiptarë edhe sot e kësaj dite edhe pse metoda e Realizmit Socialist është e abandonuar, në fakt teknikisht duket se mbeten robër të një letërsie të vjetër. Në gjendje të kapërcejë kohën dhe kulturën, Luljeta Lleshanaku është një pioniere e poezisë shqiptare. E lindur në vitin 1968, ajo ishte vetëm 17 vjeç kur Enver Hoxha vdiq në 1985 dhe u themelua shpejt si zë i fuqishëm poetik. Krejt ndryshe ndodh me poetin shqiptar nga Galway, Ndrek Gjini, një figurë e njohur në skenën e arteve dhe letërsisë lokale dhe një themelues i Galway review. Përmbledhja e tij e parë në gjuhën angleze, "The death of night" u botua në vitin 2011 nga EMAL. Në këtë aktivitet janë bashkuar dy poetë dhe miq të vjetër, teksa ata ndajnë një fazë dhe na sqarojnë për historinë e hidhur dhe të palumtur të Shqipërisë dhe letërsisë së saj, u shpreh media e këtij festivali.

vali ku të ftuar janë shkrimtarë në zë nga Kroacia, Anglia, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Zelanda e Re, Nigeria, Palestina, Ukraina, SHBA-të dhe Slovenia.

Të dy shkrimtarët shqiptarë bënë një paraqitje mjaft dinjitoze para një audience të mbushur plot me krijues, dashamirës të letërsisë, akademikë, lektorë, studentë e mjaft të tjerë.

Prezantuesja e këtij aktivite-

Opinioni **i** Ditës

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... prej 6 dekadash, e cila u mbyll në rrethin e ngushtë familjar në prani të Merkelit. Madje, sipas sugjerimit të vetë familjes, në vend të luleve dhe kurorave, të pranishmit kontribuan me donacione të nevojshme për përfundimin e rinovimit të kishës historike të qytetit, të cilën e kishte nisur shumë më parë babai i Merkel, pastori Horst Kasner, por që vdekja nuk e la ta çonte deri në fund. Shtypi dhe media gjermane dhanë vetëm një njoftim të shkurtër për këtë ceremoni dhe atë zonjë 90-vjeçare, e cila deri një ditë përpara se të vdiste jepte me pasion lëndën e anglishtes në shkollën e mesme të qytetit. Takimi i fundit me vajzën e saj ishte në shkurt, kur Merkel u nderua si "Qytetare Nderi" e vendlindjes së saj, Templin.

Ajo që la shumë mbresa dhe në këtë rast të dhimbshëm ishte qetësia dhe heshtja me të cilën Merkel e priti dhe përcolli këtë humbje të madhe të nënës, njeriut më të shtrenjtë në botë. Ajo që e motivonte në fëmijëri/rini "të bëhej me e mira, se ishte vajzë pastori" dhe kështu ndodhi me Merkelin edhe në politikë.

Edhe gjatë këtyre ditëve ajo ishte e zënë me takime punë në Bruksel, Paris, mbledhje kabinetit, parlamentit etj. Natyrisht, humbja e nënës e preku shumë. Por, si dhe më 2011-ën pas vdekjes së babait të saj, kur u pyet se çfarë ndjente, ajo tha fare shkurt se, "gjithkush që ka familje e di që do të thotë kjo humbje".

Gjatë këtyre ditëve fare pak u tha dhe u shkrua për të ndërën, sepse kur vjen fjala për aspektet të jetës private, Merkel mbetet hermetike. Deri tani psh., asnjë nga bashkëpunëtorët apo miqtë e saj më të afërt nuk ka hyrë në banesën e saj; verën e kaluar pati një shqetësim nga media nëse kishte shkuar me pushime, mirëpo kabineti i saj sqaroi se kancelaria nuk bën pushime, por vetëm "ndryshon ajrin" dhe se është në kontakt të përhershëm me situatat dhe bashkëpunëtorët e saj.

Ndaj, edhe kur shkëputet për pushime, Merkel mjaftohet me një foto me bashkëshortin e saj, profesorin e shquar të kimisë, Joachim Sauer. Ky i fundit shfaqet në publik një ose dy herë në vit në Festivalin e Beyruthit, pasi është traditë të shkohet si çift dhe aq. Rrallë, shumë rrallë pronohet dhe shfaqet në media e ca më pak për jetën bashkëshortore. Ndërsa persona publikë, siç thotë gjermani, "privatja mbetet private".

Në fakt, ky nuk përbën një rast të veçantë, por shpreh qartë mënyrën, sjelljen, stilin e jetës dhe punën së Merkelit gjatë gati 14 viteve si kancelare dhe në karrierën politike 30-vjeçare. Merkel shquhet nga gjuha, artikulumit dhe publikime model, gjithnjë, në ditë të mira e të këqija.

Ajo i zgjedh dhe i artikulon me shumë kujdes fjalët, pa epiteje, insinua, ironi dhe sarkazëm, pa lëndime dhe sulme politike, ca më



pak personale ndaj askujt, as ndaj kundërshtarit politik, gjerman apo të huaj, sado të "krisur e të këqij" qofshin. Në jetën e saj të gjatë politike nuk gjen një rast të vetëm, sado të vogël të kësaj natyre!

Këtë sjellje politike Merkel e rrezaton edhe gjatë interpelancave në Bundestagun gjerman, tek dëgjon e qetë kritika dhe sulme të ashpra nga përfaqësues të dy partive të fuqishme opozitare ekstremiste. I shoqëron ato hera-herës me një buzëqeshje të lehtë, por pa ndërrhyrë. Vetëm në fund të interpelancës, pa përmendur emrin e folësit, por vetëm temën apo kritikën përkatëse, jep përgjigje shkurt me shpjegimet e rastit, pa përdorur asnjëherë fraza mohuese apo përcmuese, por me finesë, qetësi dhe siguri pohon vizionet dhe alternativat e saj, edhe pse të ndryshme ose të kundërta.

Këtë modesti, thjeshtësi, natyrishtëri dhe përpulsi Merkel e shfaq edhe me median e shtypin, në intervistat dhe bisedat me ta, larg megalomanisë, gjuhës së drunjtë, arrogancës dhe zhargoneve të papranueshme ndaj medias, madje edhe kur kjo e fundit "ta bën borxh". Ndaj, e konsiderojnë si "kancelaria e vetëpërmbytjes".

Kancelaria e saj e suksesshme 14-vjeçare, bashkë me, pse jo, dritëhijet e veta dhe erozionin zgjedhor tregon se shumica e elektoratit gjerman ka ende nevojë për një lider të tillë, jo të zhurmshme, me bujë dhe megalomane, jo të batutave dhe e spektakleve boshe mediatike, por "me këmbë në tokë". Ndaj, megjithëse dhjetorin e kaluar, pas 20 viteve në krye të saj, ajo u dorëhoq nga kreu i CDU-së dhe kandidimi si kancelare më 2021, si reagim ndaj rezultateve të dobëta zgjedhore, popullariteti i saj vazhdon të mbetet në nivelet më të larta.

Ndonëse Merkel dhe Gjermania renditen në krye, sjellje dhe profile të tilla modeste dhe të veçanta kur vjen fjala për jetën private janë tipar dallues i liderëve perëndimorë. Kështu, bie fjala, shumë vonë dëgjova rastësisht kur isha me punë si diplomat në Berlin për

Dhe kur Merkel humbet nënën...

li "gjuha kocka s'ka, por kocka thyen". Këto vërtet ndodhin edhe gjatë, por rrallë, ndërsa te ne është janë bërë rregull i përgjithshëm me efekte tejet negative për mjedisin dhe klimën demokratike në vend.

Shqetësuese dhe të bezdisshme janë bërë edhe daljet e tepruara të liderëve tanë, të cilët kanë pushtuar pa asnjë kufizim kohor të gjithë hapësirën mediatike dhe rrjetet sociale dhe me qoka e sebepe private. Kur dhe në një monarki kush-tetuese daljet publike dhe private të mbretit dhe të princërve janë të kursyera, të disiplinuar dhe rregulluara në të gjitha format. Kurse, në një republikë parlamentare si e jona nuk i intereson kujt se çfarë bën një drejtues shteti dhe qeverie gjatë pushimeve, se çfarë ha, ku, si dhe më kë lahet, se si po ecën në not fëmija e tij etj., si këto. Sepse edhe vetë familjet mbretërore kur shkojnë me pushime, me protokoll bëjnë vetëm një foto familjare për gjithë median dhe aq. Kështu ndodh, me ndonjë përjashtim edhe me familjet presidenciale dhe parlamentare. Dhe kur shfaqen në raste të caktuara, kjo ka sfond publik, kryesisht kur shkojnë me misione bamirësie dhe edukative në vende dhe zona të ndryshme të botës, çka është me interes të madh publik. Kështu psh., princesha trashëgimtare e Belgjikës, 18-vjeçarja Elisabeta ka disa muaj që studion në Londër në një shkollë elitare, por veç fotos së nisjes nga Brukseli, për të nuk është dhënë asgjë në media dhe në shtyp.

Kurse tek ne bëhet "batërdia" duke mbingarkuar median dhe gjatë pushimeve verore e fundjavave me lloj-lloj njoftimesh, që vetëm lajme nuk janë. Le pastaj kur ka dasma, morte e gëzime të tjera. E keqja tjetër është se nomenklatura e "përfituesve" vazhdon të zgjerohet, duke shkuar deri te bashkitë, kompanitë, firmat e biznesit dhe familja e tyre, ish-at e ndryshëm, madje edhe të dënuar me burgim!

Për të mos qenë nihilistë, ka vërtet edhe politikë të lartë deputet etj., që japin shembull pozitiv lidhur me sjelljen e tyre politike, publike dhe mediatike të shoqëruar gjithnjë me raporte optimale midis publike dhe private në jetën dhe karrierën e tyre politike, parlamentare etj.. Këtu shquhet pa diskutim në të gjitha funksionet e mëparshme të larta kryetari ynë i Kuvendit, zoti Gramoz Ruçi. Megjithatë, si i thonë fjalës "përjashtimi nuk e prish rregullin".

Kjo kërkim që edhe media jonë të ndjekë shembullin e homologëve perëndimorë e të mos lejojë "bombardimin" e publikut me lajme të kësaj natyre.

Së fundi, Gjermaninë dhe Merkel mund të mos i ndjekim dot në fusha të tjera, por në rastet e lartpërmendura asgjë nuk mungon e nuk kushton, veç shmangies së mentalitetit provincial ballkanik dhe vullnetit për të vepruar si perëndimorë. Për më tepër, ky model demokratik sjelljeje nuk kërkon kriter, projekte, fonde, negociata, por vetëm predispozicion, frymë dhe përgjegjësi politike/ qytetare ndaj publikut.

HOROSKOPI

DASHI
Të lindurit e kësaj shenje duhet të diskutojnë sot buxhetin familjar. Familjarët tuaj mund të kenë planet e tyre rreth menaxhimit të një shume të madhe parash. Incidentet janë të mundura në marrëdhënien e dashurisë.

DEMI
Mund të jetë një ditë e ngarkuar me aktivtete të ndryshme. Ka gjasa të hasni edhe vështirësi, por gjithçka do të kalojë lehtë. Mundohuni të jeni me kreativë dhe të shijoni sa më shumë raportin në çift.

BINJAKET
Binjakët nuk do të kenë dëshirë të shpenzojnë energji për zgjidhjen e problemeve të dikujt tjetër. Do të kenë fat në një takim që do të zhvillojë gjatë ditës. Mbrënjën rekomandohet ta shpenzoni me familjen dhe të dhuronis sa më shumë dashuri.

GAFORJA
Duke nisur që nga kjo e diel, gjithçka do të ecë më mirë se më parë. Do të nisni një rrugë më të qetë, e cila do t'ju ofrojë mundësi të shumta në vendin e punës. Do të arrihi të realizoni diçka, për të cilën jeni mundar pafund.

LUANI
Planetët kashillojnë të mos e teproni me pyetje sot dhe të mos kërkoni me çdo kusht të zgjidhni enigmat më të mëdha. Lëreni ngjarjet të rrjedhin natyrisht. Kontradiktat nuk do mungojnë në marrëdhëniet tuaj në çift.

VIRGJERESHA
Kjo ditë do të jetë e veçantë, pasi vijet janë në favorin tuaj dhe do t'ju ofrojnë mundësi të shumta, të cilat nuk duhen humbur. Ka gjasa t'ju rikthehen ndjenjat ndaj ish-partnerit/partneres suaj.

PESHORJA
Peshoret mund të harrojnë disa ide që kishin menduar më parë. Në përgjithësi, kjo e diel do të jetë e jashtëzakonshme. Për shembull, mund të nisni të ndjeni për dikë ose mund të mos jeni më të interesuar për një person që keni adhuruar deri tani.

AKREPI
Mosmarrëveshjet e së shkuarës do i lini pas njëherë e përgjithmonë. Nëse nuk jeni në një marrëdhënie dhe po kërkoni prej kohësh shpirtin binjak, ka gjasa ta gjeni atë sot. Do të dini mirë ku të orientoheni dhe do të arrihi atë që keni planifikuar prej kohësh.

SHIGJETARI
Nuk do të ndiheni shumë në humor sot. Përpjekjet që do të bëjë partneri/partnerja juaj nuk do t'ju kënaqin aq sa ju dëshironi. Sa i përket anës financiare, do i kaloni vështirësitë dhe do ndiheni më të qetë.

BRICJAPI
Do të ndiheni mjaft energjikë sot dhe do të dëshironi të realizoni çdo plan që keni bërë. Megjithatë, bëni kujdes me veprimet. Është shumë e rëndësishme të jeni optimistë dhe të veproni me qetësi.

UJORI
Beqarët do kenë një ditë të mbushur me risi dhe emocione të forta. Në planin financiar mundohuni të mos nitoheni për asgjë, pasi vetëm kështu mund të shmangni problemet.

PESHQIT
Disa persona të kësaj shenje do të përjetojnë një surprizë mjaft të këndshme. Mund të merrni një dhuratë të rëndësishme nga familjarët tuaj. Ka edhe gjasa të merrni një informacion të rëndësishëm, që mund të përcaktojë rrugën e së ardhmes suaj.

Opinion i Ditës

Tërheqja në politikë, si strategji lufte

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

... do të dëshpërohen me pronicimin tim dhe me mendimet e mia.

Nga historia e luftërave të lasha dhe më të reja kemi mësuar që në beteja hyn jo vetëm për të fituar, por edhe për të humbur dhe se jo vetëm sulmi, por edhe tërheqja është një strategji për një fitore të mundshme...

Ky mësim historie vlen edhe për luftën politike. Ka raste që tërheqja tregon për një lojë mashtruese, e cila definon fitoren, ashtu siç ka raste që tërheqja bëhet edhe kur kupton se mund të humbasësh shumë nga shokët e tu dhe nga arsenalit luftarak.

Tërheqja e Edi Ramës nga posti i kryeministrit, përkohësisht ose përgjithmonë është një kusht i panegociueshëm i opozitës. Edi Rama, ka kohë që e dëgjon refrenin "Rama ik! Rama ik!"

Ikja duhet kuptuar edhe si një tërheqje strategjike, për të kuruar imazhin e dëmtuar pjesërisht dhe një premisë për të fituar sërish në zgjedhjet e ardhshme. Partia Socialiste dhe vetë Rama vazhdojnë të luajnë fitimtarin dhe të përcmojnë opozitën. Rama vazhdon ta stigmatizojë, ta përqeshë dhe ta qesëndisë nga podiumi i fitimtarit, ndërkohë që sipas Berishës "vend" po shkon drejt një përplasjeje civile".

PS-ja edhe lideri i saj tashmë krijojnë artificialisht një klimë fitoresh, ndërkohë që në parlament kanë mbetur të vetmuar, me ca tradhtarë partish, që pruan të lozin artificialisht rolin e opozitës.

Rama tregon ende të fortin në parlament, ndërkohë që jashtë tij shtohen thirrjet "Rama ik! Rama ik!"

"Është koha për të parë një Edi Rama ndryshe". Ky ishte një shkrim i imi paralajmërues i botuar po në këtë gazetë, gjashtë muaj më parë. Lëvizja ndryshe, siç e parashikoja unë, tashmë ka ndodhur me opozitën, por nuk ka ndodhur me Ramën. Ky është edhe shkaku që unë shkruaj sërish në këtë gazetë, duke dashur të argumentoj se largimi përkohësisht nga posti i kryeministrit do t'i bënte nder situatës, PS-e dhe vetë Edi Ramës.

Tërheqja duhet kuptuar dhe si strategji e detyrueshme, për një fitore të mundshme... Shembuj të shumtë nga historia na kanë treguar se ka raste që tërheqja shpeshherë është konsideruar si një taktikë fitoreje. A nuk ka pasur raste të tilla Aleksandri i Madh, Çezari, Napoloni... e gjer te Gjergji ynë? Kinezët kanë një shprehje: "Gjëja që zgjatet, bëhet gjarpër". Histori na ka treguar me fakte të shumta se shpeshherë qëndrimet e zgjatura në pushtet



kanë dhënë rezultate negative. Betejat politike kanë baticë-zbaticat e veta, sulm-tërheqje, krahë-marrje, sulme frontale, anësore, tërheqje imagjinare...

Është në natyrën e demokracisë, në rrethana të caktuara siç janë këto që jetojmë, që fjala "të përkohshëm" zëvendësohet me "të parakohshëm". Arsyet janë të shumta. Vetë Rama tregoi të entjën në parlament se "ka 101 arsye për ta lënë pushtetin".

Le të flasim më konkretisht, ndërsa partitë opozitare kanë vënë si kusht dorëheqjen, Edi bën sikur nuk e dëgjon këtë zë opozitar. Është i gatshëm të bëjë bisedime me tradhtarët opozitarë, si bie fjala me Rudina Hajdarin, që nuk e di

pse ka hyrë në parlament, pse shkel mbi gjakun e të atit dhe pse as vëllai i saj nuk e ndjek pas. Parlamentin ynë sot na kujton përrallën e Andersenit. "Rrobat e arta të mbretit", ose

"Mbreti lakuriq".

Ka ardhur koha të shohim një Edi Rama ndryshe, Edin e kapërcimeve pindarike. Pëshpëritet gjithandaj, nën zë, se zgjidhja do të vijë nga vetë Edi... Po si? Po kur? Opozita ka si kusht të panegociueshëm largimin e tij. Ç'do të bëhet nëse Edi nuk do të lëvizë nga karrigia e kryeministrit? Do ta hidhni opozitën dhe popullin opozitar në luftë? Do dalë profecia e Berishës: "Populli të shkojë drejt një përplasjeje civile"? Ky është fundi

që pritet?

Me sa kuptoj unë, Edi Rama ka vendosur të rezistojë... Tërheqja i duket një fyerje që i bëhet personalisht atij.

Çfarë duhet bërë? Si do të zgjidhet kjo krizë e gjatë, jo vetëm parlamentare, por dhe e përgjithshme, e paparë në historinë e këtyre tri dekadave...

Për Ramën, tërheqja është një veprim antiligjor dhe fyerje për partinë fitimtare. Për opozitën ka vetëm një njeri që duhet ta zgjidhë këtë ngërç, me largimin e tij nga posti për t'u dhënë rrugë zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Duhet marrë më shtruar. Duhet parë më në largësi... Edi Rama mendon se ka përpara një opozitë të dobët... Atëherë le të lëvizim. Tërheqja në të tilla rrethana është në favorin e Ramës dhe të PS-së.

Rama është zgjidhja dhe vetëzgjidhja.

Tërheqja e përkohshme nga karrigia e kryeministrit e bën të mundur zgjedhjen e krizës.

Prepotenca dhe arroganca nuk

janë në të njëjtën valë me strategjinë e fitores.

Problemet dhe hallet popullore janë të shumta. Këtë gjë e di PD-ja dhe LSI-ja. Këtë gjë e di edhe më mirë Edi Rama. Fjalimi i tij në parlament tregon që ai e di ku gjendet Shqipëria: "Unë mund t'ju them dhe 101 arsye të tjera, por këtë nuk ua them dot unë. Këtë gjë duhet ta gjeni ju vetë". Me "ju vetë" ai kishite parasysh opozitën.

Tensioni nga dita në ditë rritet... Populli jeton në ankth. Kohët e fundit po shtohen zërat për një devijim, që i është bërë Partisë Socialiste nga Rilindja juaj.

Zërat për një tërheqje janë shtuar brenda dhe jashtë partisë suaj.

"Le të japë dorëheqjen - thonë, nën zë. - Nuk u bë hataja... Ja Nanua e dha dorëheqjen. Jo një herë, por pesë herë... Nuk humbi asgjë... F'toi respektin si një udhëheqës liberal. Nuk bëhet hataja nëse Rama vendos ta lërë karrigen e kryeministrit..."

Është tamam koha për t'i treguar elektoratit strategjinë e tërheqjes në raste të veçanta.

Nuk qëndron dot në këmbë me sloganin "Kjo nuk është ligjore" dhe "Populli na ka besuar pushtetin".

Është tamam koha, taktiku i orës numëron ditët, orët, minutat... Është pikërisht koha.

Problemet janë grumbulluar. Presin një zgjidhje të ngutshme... Varfëria, emigracioni, vrasjet, grabitjet, tenderat e majme, ligji i zgjedhjeve, gjykatat në reformim, opozita që ka braktisur parlamentin, futja në Bashkimin Europian, rritja e çmimeve të produkteve dhe rritja e taksave...


Ngërç qëndron te një njeri. Ai është kryeministri, për të cilin ende ruaj një simpati të veçantë, pasi e di, në çastet e fundit do të shohim tek ai një Ramë ndryshe, për ta nxjerrë vend nga qorrsoakaku dhe për t'i rritur kuotat e rena të besimit popullor.

Edi Ramës i duhet ta rikuperojë performancën...

Është koha për vendime të shpejta. Te tragjedia "Hamlet" jepet një shembull sinjifikativ. Hamleti këshillon mëkëmbësin e vet, Horatin, ta lërë për ca kohë pushtetin dhe të zbrësë në popull.

Nga 101 arsyet që përmend Rama, dua t'i përmend edhe një: "Opozita është fyer, qesëndisur dhe poshtuar shumë". Janë nxjerrë nga puna dhe janë lënë në rrugë familje të tëra. Janë fyer dhe qesëndisur mediat, studentët, fshatarët dhe qytetarët... Është fyer dhe mashtruar populli, që priste nga ju parasën. Fjalimi i parë i paskthimit në parlament duhet të përmbajë edhe një falje publike për të gjithë të fyerit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. O Toole aktor
5. Si vizuale.
11. Në fund të lutjes.
13. Janë popullsi e qytetit
14. Një pije freskuese.
17. Eshhtë enjite.
18. Teke prize.
20. Janë mallkime shkishëruese.
22. Një aftësi paranormale.
25. Janë fakultetet më me leverdi.
27. Gjëja e romakëve.
29. Thahen me bonifikim.
30. Zemeckis regjisor
33. Janë në temë
34. Inicialet e Harris aktor.
36. Eshhtë figurë gjeometrike.
37. Një markë makine qepëse.

41. Kush ka... ka zët.
42. Mbyllin komentin.
43. I bëhen të gjitha mikut.
45. Një version i dikurshëm i FIAT.
46. Fillojnë shkurt.
47. Një pikë në ligji.
48. Inicialet e Morricone-s.
49. Të fundit në manastir.
50. I ka kërcyer të xhindosurit.
51. Janë pjesë të dramës

VERTIKAL

1. Fillojnë panikun.
2. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
3. Në krye të tenorëve.
4. Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
5. Inicialet e Anka këngëtar.
6. Kush ka... ka nevojë për gjak
7. Ndiqet ajo e fundit
8. Duken të gjata në pritje.
9. Një fazë gjumi.
10. Shteti i francezëve
12. Një art i shtatë.
13. Eshhtë pellgu.
15. Shkroi Pa familje
16. Janë dokumente shtëpie.
18. Eshhtë filmi që mallëngjen.
19. Një koleg anglez.
21. Janë baballarët.
23. Mund të jetë elektrike.
24. Eshhtë hidrofobi.
26. Ajo e forcës është për të çmendur.
27. Kremi pa ekstreme.
28. Si sezonale.
31. Mund të jenë unike
32. Mund të jenë periodeke të tilla.
35. Eshhtë bishë që zgërdhinet.
38. Fillojnë nazet
39. Inicialet e Diamantori aktor.
40. Eshhtë moshë më e bukur.
44. Fillojnë temën.
46. Kufizojnë një send.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një film publicitar
5. Në krye të bashkisë
7. Me Romeo në makinë
10. Në fund majtas
11. Janë kompozime si Vejusha gazmore
15. Janë në masë.
16. Janë melodrama.
17. Fillojnë dobët.
18. Në hyrje të radios.
19. Një pjesë e lipotimisë.
21. Eshhtë gjendje të fikti.
24. Eshhtë vërtet i mërzitshëm.
25. Maiden që këndojnë
26. Hurley aktore.
27. Pak torturuese.
28. Ekstreme në tunel.
29. Ndezur në aparaturë.
30. Ai i shenjtë është papa.
31. Merrte fuqi nga toka.

VERTIKAL

32. Pak enigmatike.
33. Ngryset në mbrëmje.
35. Kufij itinerari.
36. Ai i harrësës ishte Leti.
39. Eshhtë porosia e fundit.
41. Janë bimë uji.
42. Opera e Mascagni-t.
44. Magritte piktur.
46. Eshhtë ndenjëse zbukurimi.
48. Ndiqen me ilaçe.
50. Në krye të armiqeve.
51. Një godinë në miniaturë
52. Eshhtë muzika... më e kollajtë.


VERTIKAL

1. Qe mbreti i parë i Izraelit.
2. Post scriptum




3. Një sferë... për model.
4. Eshhtë infeksion në bark
5. Një mund të jetë arme.
6. Në krye të atletëve.
7. Eshhtë grimcë me bërthamë.
8. Ishte sundimtar si Tutankamon
9. Masat pa kufij
12. Një sport baskësh
13. Janë marrëdhënie.
14. Padia pa kufij.
16. Eshhtë në minorancë.
20. I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
22. Kështu janë lojtarë te formaconit
23. Janë të holla dhe therëse.
26. Makinë ruse.
32. Eshhtë dita e dytë
34. Bisha aktore.
37. Në mes të rrugës.
38. Një trup pa kënde.
40. Sate kompozitor.
43. I ka të ndryshme një sakat.
45. King Cole i muzikës.
46. Inicialet e Penn aktor.
47. Në mes të dhomës.
49. Të fundit në spital.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2	5							7	
6				7				8	3
				3					
				6		1	2		
1	4	2						6	
4								2	1
		2							
8					5	7		6	
						3			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	4	6	5	8	2	7	3
2	5	7	4	3	9	6	1	8
3	8	6	2	1	7	5	4	9
4	1	2	5	8	3	7	9	6
7	3	9	1	2	6	8	5	4
5	6	8	7	9	4	3	2	1
9	2	5	3	6	1	4	8	7
6	4	1	8	7	5	9	3	2
8	7	3	9	4	2	1	6	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Nuk është e mundur të jesh i lumtur pa qenë i mençur, i ndershëm dhe i drejtë. As të jesh i mençur, i ndershëm dhe i drejtë, pa qenë i lumtur.

- Ndershmëria është kapitulli i parë në librin e mençurisë.

- Kush duket i mençur midis budallenjve, duket budalla midis të mençurve.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

15	D	1	7	2	3	1	4	2		17	6	2	4	A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T	
6	O		2	3	10		11			17	4	9	3	2	D	I	A	B	E	T		D	E	T	
17	B	7		8	6	9	6	13	4	6			17	7	R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T
7	I		11	7	2	6	1	4	2			2	4	8	F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	
		8	6	12	4	13	2	4	2			4	9	4	F		E	K	O	N	O	M	I	A	D
18	3	1	4	12		4	1	4				1	5	2	R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E
2	3	12	2	3	12		3					16	1	3	A	N	T	E	N	A	A	T	A	A	B
		16	3			4	15					16	2	7	N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A
15		2	4	8	16	2				12	7	2	4	2	K	N	E		I	I	L	I	R	E	T
4	18		1	1	7			8	7	9	6	13	7		I	B	A	N	A	K	A	E	T		
12	7	1	7	3	12			9	1	4	1	2	2		B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
7	2	3		10	7	3				3	2	7		6	E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

PËRÇYQIET E FJALËKRYQIJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

D	A	V	I	D	R	O	C	K	L	E	K	R
E	N	E	R	K	E	A	S	E	A	N		
M	A	L	O	T	K	E	N	E	T	A	T	
I	N	N	I	M	R	O	M	A	N	E	T	
R	R	P	A	S	I	V	E	T	E	M		
M	O	K	A	S	I	N	A	T	I	D	E	M
E	M	I	R	A	T	I	A	V	A	T	I	
S	T	A	N	E	A	T	O	M	I	K	N	
A	R	S	T	R	E	T	E	O	D			
R	A	S	E	M	I	K	O	R	E			
A	L	A	T	A	K	A	T	I	D	A	R	I
H	S	T	A	R	S	I	R	T	A	R	I	

FJALËKRYQI (1)

B	A	L	E	N	A	A	M	O	T	I
E	N	K	A	G	A	T	V	M	A	
K	T	M	I	K	L	K	A	R	A	T
T	T	P	A	L	E	T	L	I	R	I
M	A	T	P	A	L	E	T	L	I	R
I	K	A	L	K	U	L	I	M	E	T
M	U	L	E	R	M	E	T	A	L	E
A	N	B	E	T	A	I	R	E	P	O
N	A	I	F	P	I	R	E	O	R	E
E	T	I	E	M	I	N	A	T	O	R
T	I	T	R	E	N	I	A	F	A	T

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Eshhtë më lehtë t'i bësh keq një njeriu të mirë, se sa t'i bësh mirë një njeriu të keq.
- Statistikat janë si minifundet. Ato tregojnë shumë, por fshehin thelbin.
- Askush nuk është aq i pasur që të mos ketë nevojë për një buzëqeshje.
- Dhe askush nuk është aq i varfër që të mos mund ta jap!

